

## **DIREKTIVË 2014/23/BE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, datë 26 shkurt 2014, “Për dhënien e kontratave të koncesionit”**

**(Tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)**

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Funksonimin e Bashkimit Evropian dhe, në veçanti, nenin 53, paragrafi 1 dhe nenin 62 dhe 114,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit Evropian,

Pas transmetimit të projekt aktit legjislativ në parlamentet kombëtare,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian <sup>(1)</sup>,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit të Rajoneve <sup>(2)</sup>,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e zakonshme legjislative <sup>(3)</sup>,

Meqë:

1. Mungesa, në nivel Bashkimi Evropian, e rregullave të qarta që rregullojnë dhënien e kontratave të koncesionit çon në pasiguri juridike dhe në pengesa për lirinë në ofrimin e shërbimeve dhe shkakton çrregullime në funksionimin e tregut të brendshëm. Si rezultat, operatorët ekonomikë, në veçanti ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME), po privohen nga të drejtat e tyre brenda tregut të brendshëm dhe po humbasin mundësi të rëndësishme biznesi, ndërkohë që autoritetet publike mund të mos gjejnë mënyrën më të mirë për të përdorur paratë publike, që qytetarët e Bashkimit Evropian të përfitojnë shërbime cilësore me çmimet më të mira. Një kuadër ligjor i përshtatshëm, i ekuilibruar dhe fleksibël për dhënien e kontratave të koncesionit do të garantonte hyrjen efikase dhe jodiskriminuese në treg për të gjithë operatorët ekonomikë në Bashkimin Evropian dhe siguri juridike, duke favorizuar investimet publike në infrastrukturë dhe shërbime strategjike për qytetarët. Një kuadër ligjor i tillë do të ofronte gjithashtu siguri më të madhe juridike për operatorët ekonomikë dhe do të shërbente si bazë dhe mënyrë për të hapur më tej tregjet ndërkombëtare të prokurimit publik dhe për të nxitur tregtinë botërore. Rëndësi e veçantë duhet t'i kushtohet përmirësimit të mundësive të SME-ve për të hyrë në tregjet e koncesionit nëpër Bashkimin Evropian.
2. Rregullat e kuadrit legjislativ që zbatohen për dhënien e koncesioneve duhet të jenë të qarta dhe të thjeshta. Ato duhet të pasqyrojnë siç duhet specifikën e koncesioneve krahasuar me kontratat publike dhe nuk duhet të krijojnë burokraci të tepërta.
3. Prokurimi publik luan një rol kyç në strategjinë Evropa 2020, e cila parashtrohet në Komunikimin e Komisionit të 3 marsit 2010 e titulluar "Evropa 2020, një strategji për rritje inteligjente, të qëndrueshme dhe përfshirëse" ("Strategjia Evropa 2020"), si një nga instrumentet e bazuara në treg që duhet të përdoret për të arritur një rritje inteligjente, të qëndrueshme dhe përfshirëse ndërkohë që garanton përdorimin më efikas të fondeve publike. Në këtë kontekst, kontratat e koncesionit përfaqësojnë instrumente të rëndësishme në

zhvillimin strukturor afatgjatë të infrastrukturës dhe shërbimeve strategjike, duke kontribuar në zhvillimin e konkurrencës në tregun e brendshëm, duke mundësuar përfitimin nga ekspertiza e sektorit privat dhe duke ndihmuar në arritjen e efikasitetit dhe novacionit.

4. Dhënia e koncesioneve të punëve publike aktualisht i nënshtrohet rregullave bazë të Direktivës 2004/18/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(4)</sup>; ndërsa dhënia e koncesioneve të shërbimeve me interes ndërkufitar i nënshtrohet parimeve të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) dhe në veçanti parimeve të lëvizjes së lirë të mallrave, lirisë së vendosjes dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve, si edhe parimeve që rrjedhin prej tyre, siç janë parimi i trajtimit të barabartë, i mosdiskriminimit, i njohjes së ndërsjellë, i proporcionalitetit dhe i transparencës. Ekziston rreziku i pasigurisë juridike që lidhet me interpretime të ndryshme të parimeve të traktatit nga ligjvënës kombëtar dhe i mospërputhjeve të mëdha ndërmjet legjislacioneve të shteteve anëtare të ndryshme. Ky rrezik është konfirmuar nga praktika e gjerë gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, e cila, gjithsesi, ka trajtuar vetëm pjesërisht disa aspekte të caktuara të dhënies së kontratave të koncesionit.

Nevojitet zbatim i njëtrajtshëm i parimeve të TFBE-së në të gjitha shtetet anëtare dhe eliminimi i mospërputhjeve në kuptimin e këtyre parimeve në nivel Bashkimi Evropian, për të eliminuar çrregullimet e vazhdueshme të tregut të brendshëm. Kjo gjithashtu do të favorizonte efikasitetin e shpenzimeve publike, do të lehtësonte aksesimin e barabartë dhe pjesëmarrjen e ndershme të SME-ve në dhënien e kontratave të koncesionit, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel Bashkimi Evropian, dhe do të mbështeste arritjen e objektivave për politika publike të qëndrueshme.

5. Kjo direktivë njeh dhe rikonfirmon të drejtën e shteteve anëtare dhe autoriteteve publike për të vendosur për mënyrat e administrimit që ato i gjykojnë si më të përshtatshmet, për të kryer punët dhe për të ofruar shërbimet. Në veçanti, kjo direktivë në asnjë mënyrë nuk duhet të ndikojë në lirinë e shteteve anëtare dhe autoriteteve publike për të kryer punë ose për të ofruar shërbime direkt për publiku apo për ta deleguar kryerjen e tyre te palë të treta. Shtetet anëtare ose autoritetet publike duhet të vazhdojnë të jenë të lira për të përcaktuar dhe specifikuar karakteristikat e shërbimeve që do të ofrohen, duke përfshirë çdo kusht që lidhet me cilësinë ose çmimin e shërbimeve, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, për të arritur objektivat e tyre të politikave publike.
6. Duhet të theksohet se shtetet anëtare janë të lira që të vendosin në pajtim me parimet e TFBE-së për trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, transparencën dhe lëvizjen e lirë të personave për të organizuar ofrimin e shërbimeve, qoftë si shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm apo si shërbime joekonomike me interes të përgjithshëm, ose si një përzierje e këtyre të dyjave. Gjithashtu, duhet të theksohet se kjo direktivë nuk cenon lirinë e autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale për të përcaktuar, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, shërbimet me interes ekonomik të përgjithshëm, objektin dhe karakteristikat e shërbimeve që do të ofrohen, duke përfshirë çdo kusht që lidhet me cilësinë e shërbimit, me qëllim ndjekjen e objektivave të politikave të tyre publike. Ajo gjithashtu nuk duhet të cenojë kompetencën e

autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale për të ofruar, kontraktuar dhe financuar shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm, në përputhje me nenin 14 të TFBE-së dhe me Protokollin nr. 26 bashkëlidhur TFBE-së dhe me Traktatin e Bashkimit Evropian (TBE). Gjithashtu, kjo direktivë nuk trajton financimin e shërbimeve me interes ekonomik të përgjithshëm dhe as sistemet e ndihmës së dhënë nga shtetet anëtare, në veçanti në fushën sociale, në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian për konkurrencën. Është me vend që të sqarohet se shërbimet joekonomike me interes të përgjithshëm nuk duhet të përfshihen në fushën e zbatimit të kësaj direktive.

7. Është gjithashtu me vend të theksohet se kjo direktivë nuk duhet të ndikojë në legjislacionin e shteteve anëtare për sigurimet shoqërore. As të përfshijë liberalizimin e shërbimeve me interes ekonomik të përgjithshëm që i rezervohet subjekteve publike ose private apo privatizimin e subjekteve publike që ofrojnë shërbime.
8. Për koncesionet që janë të barabarta me ose që tejkalojnë një vlerë të caktuar, është e përshtatshme që të parashikohet një bashkërendim minimal i procedurave kombëtare për dhënien e këtyre kontratave, bazuar në parimet e TFBE-së për të garantuar konkurrencën e hapur për koncesionet dhe siguri juridike të përshtatshme. Këto dispozita bashkërenduese nuk duhet të tejkalojnë atë çka nevojitet për të arritur objektivat e lartpërmendur dhe për të garantuar një shkallë të caktuar fleksibiliteti. Shteteve anëtare duhet t'u lejohet që t'i plotësojnë dhe t'i zhvillojnë më tej këto dispozita, nëse u duket e përshtatshme, sidomos për të garantuar më mirë pajtueshmërinë me parimet e përcaktuara më lart.
9. Duhet sqaruar se grupe të operatorëve ekonomikë, duke përfshirë rastet kur ata janë bashkuar në formën e një shoqërie të përkohshme, mund të marrin pjesë në procedurat e prokurimit pa qenë nevoja që ata të kenë një formë ligjore specifike. Kur është e nevojshme, për shembull kur kërkohet përgjegjësi e përbashkët ose individuale, mund të kërkohet që grupet, të cilave u jepet koncesioni, të kenë një formë specifike. Gjithashtu duhet të sqarohet se autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë qartë mënyrën se si grupet e operatorëve ekonomikë duhet të plotësojnë kërkesat që lidhen me gjendjen e tyre ekonomike dhe financiare ose kriteret që lidhen me aftësinë teknike dhe profesionale, që kërkohet nga operatorët ekonomikë që marrin pjesë individualisht. Për realizimin e kontratave të koncesionit nga grupe të operatorëve ekonomikë mund të nevojitet përcaktimi i kushteve që nuk u vendosen pjesëmarrësve individualë. Këto kushte, të cilat duhet të justifikohen me arsye objektive dhe të jenë proporcionale, mund të përfshijnë, për shembull, kërkesën për emërimin e një përfaqësie të përbashkët ose një partneri kryesues për qëllimet e procedurës për dhënien e koncesionit ose kërkesën për informacion për përbërjen e tyre.
10. Gjithashtu duhet të futen në përdorim disa dispozita bashkërenduese për dhënien e koncesioneve të punëve dhe shërbimeve në sektorët e energjisë, transportit dhe shërbimeve postare, duke qenë se autoritetet kombëtare mund të ndikojnë në sjelljen e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në këta sektorë, dhe duke marrë në konsideratë natyrën e mbyllur të

tregjeve në të cilat ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre, për shkak të ekzistencës së të drejtave të veçanta ose ekskluzive të dhëna nga shtetet anëtare në lidhje me furnizimin, ofrimin ose përdorimin e rrjeteve për të ofruar shërbimet në fjalë.

11. Koncesionet janë kontrata me interes financiar, me anë të të cilave një ose më shumë autoritete kontraktore ose subjekte kontraktore i besojnë zbatimin e punëve ose ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve një ose më shumë operatorëve ekonomikë. Objekti i këtyre kontratave është prokurimi i punëve ose shërbimeve me anë të një koncesioni, shpërblimi për të cilat përbëhet nga e drejta për të shfrytëzuar punët ose shërbimet ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën. Këto kontrata mund të përfshijnë, por jo domosdoshmërisht, një transferim të pronësisë drejt autoriteteve kontraktore ose subjekteve kontraktore, por autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore gjithmonë marrin përfitimet nga punët ose shërbimet në fjalë.
12. Për qëllimin e kësaj direktive duhet të sqarohet se financimi i një aktiviteti, sidomos nëpërmjet granteve, që shpesh lidhet me detyrimin për të rimbursuar shumat e marra kur ato nuk përdoren për qëllimet e parashikuara, nuk përfshihet në fushën e zbatimit të kësaj direktive.
13. Gjithashtu, mekanizmat ku të gjithë operatorët që përmbushin disa kushte të caktuara kanë të drejtë të kryejnë një detyrë të caktuar, pa asnjë përzgjedhje, si p.sh. sistemet që bazohen në zgjedhjen e klientit ose sistemet e kuponëve të shërbimit, nuk duhet të kategorizohen si koncesione, duke përfshirë ato që bazohen në marrëveshje ligjore ndërmjet autoritetit publik dhe operatorëve ekonomikë. Këto sisteme bazohen përgjithësisht në një vendim të një autoriteti publik, ku përcaktohen kushte transparente dhe jodiskriminuese për aksesimin e vazhdueshëm të operatorëve ekonomikë në ofrimin e shërbimeve specifike, siç janë shërbimet sociale, duke u lejuar klientëve të zgjedhin ndërmjet këtyre operatorëve.
14. Gjithashtu, disa akte të shtetit anëtar, si autorizimet ose licencat, me anë të të cilëve shteti anëtar ose një autoritet publik i tij përcakton kushtet për ushtrimin e një aktiviteti ekonomik, duke përfshirë kushtin për të kryer një veprimtari të caktuar, që normalisht jepen me kërkesë të operatorit ekonomik dhe jo me iniciativën e autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor dhe kur operatori ekonomik është i lirë të tërhiqet nga ofrimi i punëve publike ose shërbimeve, nuk duhet të kategorizohet si koncesion. Në rastin e këtyre akteve të shtetit anëtar, zbatohen dispozita specifike të Direktivës 2006/123/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(5)</sup>. Ndryshe nga këto akte të shtetit anëtar, kontratat e koncesionit parashikojnë detyrime të ndërsjella kur zbatimi i punëve publike ose shërbimeve i nënshtrohet kërkesave specifike që përcaktohen nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor, të cilat kanë fuqi zbatuese.
15. Gjithashtu, disa marrëveshje që kanë si objekt të tyre të drejtën e një operatori ekonomik për të shfrytëzuar disa të mira ose burime të sektorit publik në zbatim të së drejtës private ose publike, si p.sh. tokë ose ndonjë pronë publike, në veçanti në sektorin e porteve detare,

porteve të brendshme ose të aeroporteve, me anë të së cilave shteti ose autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor përcakton vetëm kushtet e përgjithshme për përdorimin e tyre pa prokuruar punë ose shërbime specifike, nuk duhet të kategorizohen si koncesione sipas kuptimit të kësaj direktive. Kjo ndodh përgjithësisht me kontratat e qirasë për të mirat publike ose tokën publike, që zakonisht përmbajnë kushtet që rregullojnë marrjen në pronësi nga qiramarrësi, qëllimin për të cilin do të përdoret toka, detyrimet e pronarit dhe qiramarrësit në lidhje me mirëmbajtjen e pronës, kohëzgjatjen e kontratës së qirasë dhe dorëzimin e pronësisë te pronari, qiranë dhe tarifatat shtesë që duhet të paguhet nga qiramarrësi.

16. Gjithashtu, nuk duhet të konsiderohen si koncesione sipas kuptimit të kësaj direktive as marrëveshjet që japin të drejtat e kalimit që mbulojnë shfrytëzimin e pasurisë së paluajtshme publike për ofrimin ose shfrytëzimin e linjave fikse ose rrjeteve që synojnë të ofrojnë një shërbim për publikun, për sa kohë që këto marrëveshje as nuk vendosin një detyrim për furnizim as nuk përfshijnë ndonjë blerje shërbimesh nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor për veten ose për përdoruesit e tij fundor.
17. Kontratat që nuk përfshijnë pagesa për kontraktorin dhe kur kontraktori shpërblehet mbi bazën e tarifave të rregulluara, të llogaritura në mënyrë të tillë që të mbulojnë të gjitha kostot dhe investimet e kryera nga kontraktori për ofrimin e shërbimit, nuk duhet të mbulohen nga kjo direktivë.
18. Vështirësitë që lidhen me interpretimin e koncepteve të koncesionit dhe kontratave publike kanë çuar në pasiguri juridike të vazhdueshme ndërmjet palëve të interesuara dhe kanë qenë objekt i vendimeve të shumta të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Për këtë arsye duhet të sqarohet përkufizimi i koncesionit, në veçanti duke iu referuar konceptit të rrezikut operacional. Tipari kryesor i një koncesioni, e drejta për të shfrytëzuar punët ose shërbimet, gjithmonë nënkupton transferimin e rrezikut operacional me natyrë ekonomike te koncesionari, gjë që përfshin mundësinë për mosrealizimin e kthimit të investimit dhe mbulimin e kostove që rezultojnë nga kryerja e punëve ose shërbimeve të dhëna në zbatim të kushteve operationale normale, edhe pse një pjesë e rrezikut i mbetet autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor. Zbatimi i rregullave specifike që rregullojnë dhënien e koncesioneve nuk do të justifikohet nëse autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor do ta çlironin operatorin ekonomik nga çdo humbjet e mundshme, duke i garantuar atij të ardhura minimale të barabarta ose më të larta se investimet e bëra dhe kostot që ka shpenzuar operatori ekonomik për zbatimin e kontratës. Në të njëjtën kohë duhet të sqarohet se disa marrëveshje që shpërblehen në mënyrë ekskluzive nga një autoritet kontraktor ose një subjekt kontraktor duhet të kategorizohen si koncesione kur kthimi i investimit dhe mbulimi i kostove të shpenzuara nga operatori për zbatimin e punës ose ofrimin e shërbimit varet nga kërkesa reale ose nga sigurimi i shërbimit ose asetit.
19. Kur një rregullore specifike për sektorin eliminon rrezikun, duke parashikuar një garanci për koncesionarin, kthimin e investimit dhe mbulimin e kostove që rezultojnë nga zbatimi i

kontratës, kjo kontratë nuk duhet të kategorizohet si koncesion sipas kuptimit të kësaj direktive. Fakti që rreziku është i kufizuar që në fillim nuk duhet të përjashtojë kategorizimin e kontratës si koncesion. Kjo mund të ndodhë për shembull në sektorët me tarifa të rregulluara ose kur rreziku operacional është kufizuar nëpërmjet rregullimeve kontraktuale që ofrojnë kompensim të pjesshëm duke përfshirë kompensimin në rast ndërprerjeje të parakohshme të kontratës së koncesionit për arsye që i atribuohen autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor ose për arsye të forcave madhore.

20. Rreziku operacional duhet të vijë si pasojë e faktorëve që janë jashtë kontrollit të palëve. Rreziqe të tilla si ato që lidhen me keqmenaxhimin, mangësitë kontraktuale nga ana e operatorit ekonomik ose me ngjarje të forcave madhore nuk janë vendimtare për qëllimin e klasifikimit si një koncesion, meqë këto rreziqe janë të pranishme në çdo kontratë, qoftë për një kontratë të prokurimit publik ose për një kontratë koncesioni. Rreziku operacional duhet të kuptohet si rreziku i ekspozimit ndaj luhatjeve të tregut, që mund të vijë si pasojë e rrezikut për kërkesën ose rrezikut për ofertën, ose për kërkesën dhe ofertën së bashku. Rreziku për kërkesën duhet të kuptohet si rreziku për kërkesën reale për punët ose shërbimet që janë objekt i kontratës. Rreziku për ofertën duhet të kuptohet si rreziku për ofrimin e punëve ose shërbimeve që janë objekt i kontratës, në veçanti rreziku që ofrimi i shërbimeve të mos përkojë me kërkesën. Për qëllimet e vlerësimit të rrezikut operacional duhet të merret në konsideratë, në mënyrë të qëndrueshme dhe të njëtrajtshme, vlera neto aktuale e të gjithë investimit, kostove dhe të ardhurave të koncesionarit.
21. Nocioni i "organeve të rregulluara nga e drejta publike" është shqyrtuar vazhdimisht në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Është shumë e rëndësishme që të bëhen një sërë sqarimesh për ta kuptuar plotësisht këtë koncept. Për këtë arsye duhet të sqarohet se një organ i cili operon në kushte normale të tregut, ka si qëllim të gjenerojë fitime dhe mbulon humbjet që rezultojnë nga ushtrimi i aktivitetit të tij, nuk duhet të konsiderohet si një "organ që rregullohet nga e drejta publike" duke qenë se ai është krijuar me qëllimin ose është ngarkuar me detyrën që të plotësojë nevojat me interes të përgjithshëm, të cilat mund të konsiderohen se kanë karakter industrial ose tregtar. Në të njëjtën kohë gjykata ka shqyrtuar gjithashtu kushtin që lidhet me origjinën e financimit të organit në fjalë, duke sqaruar se me "financim të shumicës" nënkuptohet më shumë se gjysma dhe se ky financim mund të përfshijë pagesa nga ana e përdoruesve të cilat vendosen, llogariten dhe mbledhen në përputhje me rregullat e së drejtës publike.
22. Është me vend që të përkufizohen "të drejtat ekskluzive" dhe "të drejtat e veçanta", duke qenë se këto nocione janë thelbësore për fushën e zbatimit të kësaj direktive, si dhe nocioni i subjekteve kontraktore. Duhet të sqarohet se subjektet që nuk janë as subjekte kontraktore sipas germës a të nenit 7, paragrafi 1 dhe as sipërmarrje publike, i nënshtrohen dispozitave të kësaj direktive vetëm nëse ushtrojnë një nga veprimtaritë që mbulohen në bazë të këtyre të drejtave. Megjithatë, ata nuk do të konsiderohen si subjekte kontraktore nëse këto të drejta janë dhënë nëpërmjet një procedure të bazuar mbi kritere objektive, në veçanti në zbatim të

legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe për të cilat është garantuar një publicitet i përshtatshëm. Ky legjislacion duhet të përfshijë Direktivën 2009/73/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(6)</sup>, Direktivën 2009/72/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(7)</sup>, Direktivën 97/67/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(8)</sup>, Direktivën 94/22/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(9)</sup> dhe Rregulloren (KE) nr. 1370/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(10)</sup>. Gjithashtu duhet të sqarohet se lista e legjislacionit nuk është gjithëpërfshirëse dhe se të drejtat e çdo forme të cilat janë dhënë nëpërmjet procedurave të tjera që bazohen në kritere objektive dhe për të cilat është garantuar publicitet i përshtatshëm nuk janë relevante për qëllimet e përcaktimit të subjekteve kontraktore që mbulohen nga kjo direktivë.

23. Kjo direktivë duhet të zbatohet vetëm për kontratat e koncesionit, vlera e të cilave është e barabartë me ose tejkalon një kufi monetar të caktuar, të cilat duhet të reflektojnë qartë interesin ndërkufitar që ngjallin koncesionet te operatorët ekonomikë që ndodhen në shtete anëtare të ndryshme nga shteti i autoritetit kontraktor ose i subjektit kontraktor. Rrjedhimisht, duhet të përcaktohet metoda për përlllogaritjen e vlerës së parashikuar të koncesionit, e cila duhet të jetë identike për koncesionet e punëve publike dhe shërbimeve duke qenë se të dyja kontratat shpesh mbulojnë elemente të punëve dhe shërbimeve. Llogaritja duhet t'i referohet xhiros totale, pa TVSH, të koncesionarit në lidhje me punët dhe shërbimet që janë objekt i koncesionit, siç parashikohet nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor, përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.
24. Për të garantuar një treg realisht të hapur dhe një ekuilibër të ndershëm në zbatimin e rregullave për dhënien e koncesionit në sektorët e energjisë, transportit dhe shërbimeve postare, është e nevojshme që subjektet e mbuluara të identifikohen mbi bazën e faktorëve të ndryshëm nga statusi i tyre ligjor. Ndaj duhet të garantohet që të mos vihet në rrezik trajtimi i barabartë i subjekteve kontraktore që operojnë në sektorin publik dhe atyre që operojnë në sektorin privat. Gjithashtu, është e nevojshme që të garantohet se, në përputhje me nenin 345 të TFBE-së, nuk cenohen rregullat që rregullojnë sistemin e pronësisë në shtetet anëtare. Për këtë arsye, duhet të zbatohen rregulla specifike dhe të njëtrajtshme për koncesionet që jepen nga subjekte që ushtrojnë një nga veprimtaritë e lartpërmendura për qëllimet e kryerjes së këtyre veprimtarive, pavarësisht faktit nëse ato janë autoritete shtetërore, lokale ose rajonale, organe që rregullohen nga e drejta publike, ndërmarrje publike ose subjekte të tjera që gëzojnë të drejta të veçanta ose ekskluzive. Duhet të supozohet se këto aktivitete ushtrohen nga subjekte që janë përgjegjëse, në zbatim të legjislacionit të brendshëm, për ofrimin e shërbimeve që lidhen me një nga veprimtaritë e përmendura në shtojcën II.
25. Duhet të sqarohet se veprimtaria përkatëse në sektorin aeroportual mbulon edhe shërbimet që u ofrohen pasagjerëve, të cilat kontribuojnë në mirëfunksionimin e mjediseve të aeroportit dhe që pritet të ofrohen nga një aeroport bashkëkohor dhe që funksionon siç duhet, siç janë shitjet me pakicë, shërbimi catering dhe parkimi i makinave.

26. Disa subjekte janë aktive në fushën e prodhimit, transmetimit ose shpërndarjes së ngrohjes dhe të ftohjes. Mund të ketë disa pasiguri në lidhje me rregullat që zbatohen për veprimtaritë e ngrohjes dhe të ftohjes, përkatësisht. Ndaj duhet të sqarohet se transmetimi dhe/ose shpërndarja e ngrohjes është një veprimtari që mbulohet nga shtojca II dhe për këtë arsye subjektet që janë aktivë në sektorin e ngrohjes i nënshtrohen rregullave të kësaj direktive, që zbatohen për subjektet kontraktore të kualifikuara si të tilla. Nga ana tjetër, subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën e ftohjes i nënshtrohen rregullave të kësaj direktive, që zbatohen për autoritetet kontraktore të kualifikuara si të tilla. Së fundmi, duhet të sqarohet se koncesionet e dhëna për realizimin e kontratave për ngrohje dhe ftohje duhet të shqyrtohen sipas dispozitave për kontratat për kryerjen e një sërë veprimtarive, për të përcaktuar se cilat rregulla të prokurimit, nëse ka, do të rregullojnë dhënien e tyre.
27. Përpara se të parashikohet ndonjë ndryshim në fushën e zbatimit të kësaj direktive për sektorin e ftohjes, duhet të shqyrtohet gjendja e këtij sektori për të marrë informacione të mjaftueshme, në veçanti në lidhje me situatën konkurruese, shkallën e prokurimit ndërkufitar dhe pikëpamjet e grupeve të interesit. Duke qenë se zbatimi i kësaj direktive në këtë sektor mund të ketë një ndikim domethënës për sa i përket hapjes së tregut, ky shqyrtim duhet të kryhet gjatë kohës që vlerësohet ndikimi i kësaj direktive.
28. Duhet të sqarohet se për qëllimet e paragrafit 1 dhe 2 të shtojcës II "furnizim" përfshin gjenerimin/prodhimin, shitjen me shumicë dhe shitjen me pakicë. Megjithatë, prodhimi i gazit përmes nxjerrjes së tij, përfshihet në fushën e zbatimit të paragrafit 6 të asaj shtojce.
29. Në rastin e kontratave të përziera, rregullat e zbatueshme duhet të përcaktohen në lidhje me objektin kryesor të kontratës, nëse pjesë të ndryshme përbërëse të kontratës janë objektiviisht të pandashme. Për këtë arsye, duhet të sqarohet se si autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore duhet të përcaktojnë nëse pjesë të ndryshme janë të ndashme ose jo. Ky sqarim duhet të bazohet në praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Përcaktimi duhet të bëhet rast pas rasti, ku qëllimi i shprehur ose i prezumuar i autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor për të konsideruar si të pandashme aspektet e ndryshme që përbëjnë një kontratë të përzier nuk duhet të jetë i mjaftueshëm, por duhet të mbështetet nga prova objektive të cilat mund t'i justifikojnë ato dhe mund të përcaktojnë nevojën për të lidhur një kontratë të vetme. Kjo nevojë, e justifikuar, për lidhjen e një kontratë të vetme mund të lindë, për shembull, në rastin e ndërtimit të një ndërtese të vetme, një pjesë e së cilës do të përdoret nga vetë autoriteti kontraktor në fjalë dhe pjesa tjetër do të jepet me koncesion, për shembull, për të ofruar hapësira parkimi për publikun. Duhet të sqarohet se nevoja për të lidhur një kontratë të vetme mund të lindë për arsye të natyrës teknike dhe asaj ekonomike.
30. Në rastin e kontratave të përziera që mund të ndahen, autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore janë gjithmonë të lira që të japin kontrata të ndara për pjesë të ndara të kontratës së përzier, rast në të cilin dispozitat e zbatueshme të secilës pjesë të ndarë duhet të



përcaktohen ekskluzivisht në lidhje me karakteristikat e asaj kontrate specifike. Nga ana tjetër, kur autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë e cila përfshin si elementet e një koncesioni ashtu edhe elementë të tjerë, pavarësisht vlerës së tyre dhe regjimit juridik të cilit këto elemente do t'i nënshtroheshin në kushte të tjera, duhet të cilësohen rregullat e zbatueshme për këto raste. Duhet të parashikohet një dispozitë e veçantë për kontratat e përziera që përfshijnë aspekte të mbrojtjes ose sigurisë, ose pjesë të caktuara që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të TFBE-së.

31. Mundet që subjektet kontraktore të japin koncesione me qëllim plotësimin e kërkesave të disa aktiviteteve, që mund t'u nënshtrohen regjimeve të ndryshme juridike. Duhet të sqarohet se regjimi juridik që zbatohet për një koncesion të vetëm që parashikohet të mbulojë disa veprimtari duhet t'i nënshtrohet rregullave të zbatueshme për veprimtarinë për të cilën ai është synuar kryesisht. Përcaktimi i veprimtarisë për të cilën koncesioni është synuar kryesisht, mund të bazohet mbi një analizë të kërkesave që koncesioni specifik duhet të përmbushë, e cila mund të kryhet nga subjekti kontraktor me qëllim parashikimin e vlerës së koncesionit dhe hartimin e dokumenteve për dhënien e koncesionit. Në disa raste mund të jetë objektivisht e pamundur që të përcaktohet se për cilën veprimtari është synuar kryesisht koncesioni. Duhet të specifikohen rregullat që zbatohen për raste të tilla.
32. Në disa raste, një autoritet kontraktor ose subjekt kontraktor i caktuar, që mund të jetë një shtet, një autoritet rajonal ose vendor ose një organ që rregullohet nga e drejta publike ose një organizatë e këtyre të fundit, mund të jetë burimi i vetëm për një shërbim të caktuar, për ofrimin e të cilit ai gëzon një të drejtë ekskluzive në zbatim të ligjeve të brendshme, rregulloreve të brendshme ose dispozitave administrative të publikuara, të cilat janë në pajtim me TFBE-në. Duhet të sqarohet se në situata të tilla, një autoritet kontraktor ose subjekt kontraktor, siç përmendet në këtë deklaramim, ose një organizatë e tyre mund t'u japë koncesione këtyre organeve pa zbatuar këtë direktivë.
33. Gjithashtu është e përshtatshme që të përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive disa koncesione shërbimesh që u jepen operatorëve ekonomikë, nëse jepen mbi bazën e një të drejte ekskluzive që ai operator gëzon në zbatim të legjislacioneve të brendshme, rregulloreve të brendshme ose dispozitave administrative të publikuara dhe në përputhje me TFBE-në dhe aktet e Bashkimit Evropian që përcaktojnë rregullat e përbashkëta për hyrjen në treg, të zbatueshme për veprimtaritë e përmendura në shtojcën II, duke qenë se kjo e drejtë ekskluzive e bën të pamundur ndjekjen e një procedure konkurruese për dhënien e koncesionit. Përmes derogimit dhe pa cenuar pasojat juridike të përjashtimit të përgjithshëm nga fusha e zbatimit të kësaj direktive, koncesionet e përmendura në nënparagrafin e dytë të nenit 10, paragrafi 1, duhet t'i nënshtrohen detyrimit të shpalljes së njoftimit për shpalljen e fituesit të kontratës së koncesionit me qëllim garantimin e transparencës bazë, me përjashtim të rasteve kur kushtet për këtë transparencë janë parashikuar në legjislacionin sektorial. Për të forcuar transparencën, një shtet anëtar duhet të njoftojë Komisionin, kur i jep të drejtën

ekskluzive një operatori ekonomik për të ushtruar një nga veprimtaritë e përmendura në shtojcën II.

34. Për qëllimet e kësaj direktive, konceptet "interes thelbësor për sigurinë", "pajisje ushtarake", "pajisje delikate", "punë delikate" dhe "shërbime delikate" kanë kuptimin që u jepet në Direktivën 2009/81/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(11)</sup>.
35. Kjo direktivë nuk duhet të ndikojë në lirinë e shteteve anëtare për të zgjedhur metodat për organizimin dhe kontrollin e veprimtarive të lojërave të fatit dhe basteve, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe nëpërmjet autorizimeve. Është me vend të përjashtohen nga fusha e zbatimit të kësaj direktive, koncesionet që lidhen me veprimtarinë e lotarive, të cilat një shtet anëtar ia jep një operatori ekonomik mbi bazën e një të drejte ekskluzive të dhënë nëpërmjet një procedure pa shpallje, sipas legjislacioneve të brendshme, rregulloreve të brendshme ose dispozitave administrative të publikuara në përputhje me TFBE-në. Ky përjashtim justifikohet nga dhënia e të drejtës ekskluzive një operatori ekonomik, duke e bërë kështu procedurën konkurruese të pazbatueshme, si edhe nga nevoja që shtetet anëtare të kenë mundësinë të rregullojnë sektorin e lojërave të fatit në nivel kombëtar, duke marrë në konsideratë detyrimet e tyre për mbrojtjen e rendit publik dhe social.
36. Kjo direktivë nuk duhet të gjejë zbatim për shërbime të caktuara emergjence kur ato kryhen nga organizata ose shoqata jofitimprurëse, duke qenë se do të ishte e vështirë të ruhej natyra e veçantë e këtyre organizatave nëse ofruesit e shërbimit do të zgjidheshin në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë direktivë. Megjithatë, përjashtimi nuk duhet të shkojë përtej asaj çka është e domosdoshme. Prandaj duhet të përcaktohet shprehimisht se nuk duhet të përjashtohen shërbimet e transportit të pacientit me ambulancë. Në këtë kontekst, përveç të tjerash, është e nevojshme të sqarohet se grupi 601 i FPP-së "Shërbimet e transportit rrugor" nuk mbulon shërbimet e ambulancës, të cilat gjenden në klasën 8514 të FPP-së. Ndaj duhet të sqarohet se shërbimet që mbulohen nga kodi 85143000-3 i FPP-së, që përbëhen ekskluzivisht nga shërbimet e transportit të pacientit me ambulancë duhet t'i nënshtrohen regjimit të veçantë që është përcaktuar për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike ("regjimi i lehtë"). Rrjedhimisht, kontratat e përziera të koncesionit për ofrimin e shërbimeve të ambulancës në përgjithësi do t'i nënshtroheshin edhe regjimit të lehtë, nëse vlera e shërbimeve të transportit të pacientit me ambulancë do të ishte më e madhe sesa vlera e shërbimeve të tjera të ambulancës.
37. Duhet të risillet në vëmendje se kjo direktivë zbatohet vetëm për autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore të shteteve anëtare. Për pasojë, partitë politike, duke qenë se nuk janë autoritete kontraktore ose subjekte kontraktore, nuk u nënshtrohen këtyre dispozitave. Megjithatë, partitë politike në disa shtete anëtare mund të përfshihen në konceptin e organeve që rregullohen nga e drejta publike. Megjithatë, disa shërbime të caktuara (si prodhimi i filmave propagandues dhe prodhimi i kasetave propaganduese) janë të lidhura aq ngushtë me pikëpamjet politike të ofruesit të shërbimit, kur jepen në kontekstin e një fushate zgjedhore,

sa ofruesit e shërbimit normalisht zgjidhen në një mënyrë që nuk mund të rregullohet nga rregullat e koncesionit. Si përfundim, duhet të risillet në vëmendje se statuti dhe financimi i partive politike evropiane dhe fondacioneve politike evropiane i nënshtrohen rregullave të ndryshme nga ato që përcaktohen në këtë direktivë.

38. Shumë subjekte kontraktore organizohen si një grup ekonomik që mund të përfshijë një sërë sipërmarrjes të ndara; shpesh secila nga këto sipërmarrje ka një rol të specializuar në kontekstin e përgjithshëm të grupit ekonomik. Për këtë arsye është m vend të përjashtohen disa koncesione të caktuara të shërbimeve dhe të punëve që i jepen një sipërmarrjeje të lidhur, që ka si veprimtarinë e saj kryesore ofrimin e këtyre shërbimeve ose punëve për grupin në të cilin ajo bën pjesë dhe jo ofrimin e tyre në treg. Është gjithashtu me vend të përjashtohen disa koncesione të caktuara të shërbimeve dhe të punëve që një subjekt kontraktor i jep një sipërmarrjeje të përbashkët e cila përbëhet nga një sërë subjektsh kontraktore, me qëllim kryerjen e veprimtarive që mbulohen nga kjo direktivë dhe në të cilën ky subjekt bën pjesë. Megjithatë, duhet të garantohet që ky përjashtim të mos çojë në prishjen e konkurrencës në dobi të sipërmarrjeve ose sipërmarrjeve të përbashkëta që janë të lidhura me subjektet kontraktore; duhet të parashikohet një paketë e përshtatshme rregullash, në veçanti në lidhje me afatet kohore maksimale brenda të cilave sipërmarrjet mund të marrin një pjesë të xhiros së tyre nga tregu dhe në tejkalim të së cilave ato do të humbin mundësinë që të marrin koncesione pa thirrje për konkurrim, për përbërjen e sipërmarrjeve të përbashkëta dhe qëndrueshmërinë e lidhjeve ndërmjet këtyre sipërmarrjeve të përbashkëta dhe subjekteve kontraktore që janë pjesë e tyre.
39. Sipërmarrjet konsiderohen se janë të lidhura kur ekziston një ndikim dominues i drejtpërdrejtë ose i tërthortë ndërmjet subjektit kontraktor dhe sipërmarrjes në fjalë ose kur të dyja i nënshtrohen ndikimit dominues të një sipërmarrjeje tjetër; në këtë kontekst, pjesëmarrja private në vetvete duhet të jetë e pazbatueshme. Verifikimi nëse një sipërmarrje është e lidhur me një subjekt kontraktor të caktuar duhet të kryhet sa më lehtësisht të jetë e mundur. Rrjedhimisht, dhe duke qenë se ekzistenca e mundshme e këtij ndikimi dominues të drejtpërdrejtë ose të tërthortë tashmë do duhej të ishte verifikuar për të vendosur nëse llogaritë vjetore të sipërmarrjeve dhe subjekteve në fjalë duhet të konsolidohen, sipërmarrjet duhet të konsiderohen se janë të lidhura kur llogaritë e tyre vjetore janë të konsoliduara. Megjithatë, rregullat e bashkimit evropian për llogaritë e konsoliduara nuk gjejnë zbatim për një sërë rastesh, për shembull për shkak të përmasës së sipërmarrjes përkatëse ose për shkak se disa kushte që lidhen me formën e tyre ligjore nuk janë përmbushur. Në raste të tilla, kur Direktiva 2013/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit <sup>(12)</sup> nuk gjen zbatim, do të jetë e nevojshme që të shqyrtohet nëse është ose jo i pranishëm një ndikim dominues i drejtpërdrejtë ose i tërthortë duke marrë në konsideratë pronësinë, pjesëmarrjen financiare ose rregullat që rregullojnë sipërmarrjet.
40. Koncesionet në sektorin e ujit shpesh i nënshtrohen mekanizmave specifike dhe komplekse që kërkojnë një vëmendje të veçantë, për shkak të rëndësisë që ka uji si një e mirë publike

me vlerë thelbësore për të gjithë qytetarët e Bashkimit Evropian. Tiparet e veçanta të këtyre mekanizmave justifikojnë përjashtimet në fushën e ujit nga fusha e zbatimit të kësaj direktive. Përjashtimi mbulon koncesione për punë dhe shërbime për të ofruar ose shfrytëzuar rrjetet fikse me të cilat synohet të ofrohet një shërbim për publikun që lidhet me prodhimin, transportin ose shpërndarjen e ujit të pijshëm ose me furnizimin e ujit të pijshëm në këto rrjete. Po kështu përjashtohen edhe koncesionet për zhvendosjen ose trajtimin e ujërave të zeza dhe për projekte të inxhinierisë hidraulike, instalime për ujitje ose kullim të tokës (me kusht që vëllimi i ujit, që do të përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm, të përbëjë më shumë se 20% të vëllimit të përgjithshëm të ujit të bërë të disponueshëm nga këto projekte ose nga infrastruktura ujëtare ose drenazhuese), nëse janë të lidhura me një veprimtari të përjashtuar.

41. Kjo direktivë nuk duhet të zbatohet për koncesionet që jepen nga subjektet kontraktore dhe kanë për qëllim të lejojnë kryerjen e një veprimtarie që përmendet në shtojcën II, nëse, në shtetin anëtar ku kryhet kjo veprimtari, ajo ekspozohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj konkurrencës në tregje ku hyrja nuk është e kufizuar, siç përcaktohet nga një procedurë e parashikuar për këtë qëllim në Direktivën 2014/25/BE të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit.<sup>(13)</sup> Ndaj duhet që të ruhet një procedurë e zbatueshme për të gjithë sektorët, ose për një pjesë të tyre, që mbulohen nga kjo direktivë, që do të mundësojë marrjen në konsideratë të efekteve të konkurrencës së hapur tani dhe në të ardhmen. Kjo procedurë duhet të ofrojë siguri juridike për subjektet në fjalë, si edhe një proces të përshtatshëm vendimmarrjeje duke garantuar, brenda afateve të shkurtra kohore, zbatimin e njëtrajtshëm të së drejtës së Bashkimit Evropian në këtë fushë. Për hir të sigurisë juridike duhet të sqarohet se vendimet e miratuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj direktive, të miratuar mbi bazën e nenit 30 të Direktivës 2004/17/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit<sup>(14)</sup>, do të vazhdojnë të zbatohen.
42. Duke qenë se i drejtohet shteteve anëtare, kjo direktivë nuk zbatohet për dhënien e koncesioneve nga organizatat ndërkombëtare në emër të tyre dhe për llogari të tyre. Megjithatë, është e nevojshme të sqarohet se deri në çfarë mase duhet të zbatohet kjo direktivë për dhëniet e koncesioneve që rregullohen nga rregulla ndërkombëtare specifike.
43. Dhënia e koncesioneve për disa shërbime mediatike audiovizive dhe radiofonike nga ofruesit e medias duhet të lejojë marrjen në konsideratë të aspekteve me rëndësi kulturore ose sociale, gjë që e bën të papërshtatshëm zbatimin e rregullave për dhënien e koncesioneve. Për këto arsye, duhet të bëhet një përjashtim për koncesionet e shërbimeve që jepen nga vetë ofruesit e shërbimeve mediatike për blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e programeve standarde, si edhe të shërbimeve të tjera përgatitore, siç janë ato që lidhen me skenarët ose interpretimet artistike të nevojshme për prodhimin e programit. Duhet të sqarohet se përjashtimi duhet të zbatohet po ashtu për shërbimet mediatike për transmetim ose shërbimet sipas kërkesës (shërbime jolineare). Megjithatë, përjashtimi nuk duhet të

zbatohet për furnizimin e pajisjeve teknike të nevojshme për prodhimin, bashkëprodhimin dhe transmetimin e këtyre programeve.

44. Kjo direktivë nuk cenon kompetencën e shteteve anëtare për të garantuar financimin e shërbimit publik të transmetimit, për sa kohë që ky financim u jepet organizatave të transmetimit për të plotësuar sferën e shërbimit publik siç akordohet, përcaktohet dhe organizohet nga çdo shtet anëtar në përputhje me Protokollin nr. 29 për sistemin e transmetimit publik në shtetet anëtare, që i bashkëngjitet TFBE-së dhe TBE-së.
45. Ekziston një pasiguri e madhe juridike për masën në të cilën kontratat që lidhen ndërmjet subjekteve të sektorit publik duhet të mbulohen nga rregullat për koncesionet. Praktika gjyqësore përkatëse e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian interpretohet në mënyra të ndryshme mes shteteve anëtare, madje edhe mes autoriteteve kontraktore ose subjektet kontraktore. Ndaj duhet të sqarohet se në çfarë rastesh kontratat e lidhura brenda sektorit publik nuk i nënshtrohen zbatimit të rregullave që përcaktohen në këtë direktivë. Ky sqarim duhet të bazohet në parimet që përcaktohen në praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Vetëm fakti se të dy palët e një marrëveshjeje janë vetë autoritete publike, nuk përjashton në vetvete zbatimin e rregullave të përcaktuara në këtë direktivë. Megjithatë, zbatimi i rregullave që përcaktohen në këtë direktivë nuk duhet të cenojë lirinë e autoriteteve publike për të kryer detyra të shërbimit publik, që u janë akorduar atyre duke përdorur burimet e veta, gjë që përfshin mundësinë e bashkëpunimit me autoritete të tjera publike. Duhet të garantohet që asnjë bashkëpunim publik-publik i përjashtuar të mos çojë në shtrembërimin e konkurrencës në lidhje me operatorët ekonomikë privatë, deri në atë masë sa ta vendosë një ofrues shërbimesh privat në një pozicion të favorshëm kundrejt konkurrentëve të tij.
46. Koncesionet që u jepen personave juridikë të kontrolluar nuk duhet t'i nënshtrohen zbatimit të procedurave të parashikuara në këtë direktivë, kur autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor, siç përmendet në germën a të nenit 7, paragrafi 1, ushtron një kontroll mbi personin juridik në fjalë që është i ngjashëm me kontrollin që ai ushtron mbi departamentet e tij nëse personi juridik i kontrolluar ushtron më shumë se 80% të veprimtarive të tij në përmbushje të detyrave që i janë besuar nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor kontrollues ose nga persona juridikë të tjerë që kontrollohen nga ai autoritet kontraktor ose subjekti kontraktor, pavarësisht palës që përfiton nga zbatimi i kontratës. Përjashtimi nuk duhet të përfshijë situata në të cilat një operator ekonomik privat ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në kapitalin e personit juridik të kontrolluar, duke qenë se dhënia e koncesionit pa një procedurë konkurrimi, në rrethana të tilla, do t'i siguronte operatorit ekonomik privat, që ka pjesëmarrje në kapitalin e personit juridik të kontrolluar, një avantazh të padrejtë kundrejt konkurruesve të tij. Megjithatë, duke pasur parasysh karakteristikat e veçanta të organeve publike me anëtarësi të detyrueshme, si p.sh. organizatat përgjegjëse për menaxhimin ose ushtrimin e disa shërbimeve publike, kjo nuk duhet të zbatohet në rastet kur pjesëmarrja e një operatori ekonomik privat në kapitalin e personit juridik të kontrolluar është

e detyrueshme nga një dispozitë ligjore e legjislacionit të brendshëm, në pajtim me traktatet, me kusht që kjo pjesëmarrje të mos jetë kontrolluese dhe bllokuese dhe të mos ketë ndikim vendimtar në vendimet e personit juridik të kontrolluar. Duhet të sqarohet më tej se element dominues është vetëm pjesëmarrja private e drejtpërdrejtë në personin juridik të kontrolluar.

Rrjedhimisht, kur ka pjesëmarrje me kapital privat në autoritetin kontraktor ose subjektin kontraktor kontrollues ose në autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore kontrolluese, kjo nuk pengon dhënien e kontratave publike personit juridik të kontrolluar, pa zbatuar procedurat e parashikuara në këtë direktivë, sepse këto pjesëmarrje nuk ndikojnë negativisht në konkurrimin ndërmjet operatorëve ekonomikë privatë. Duhet gjithashtu që të sqarohet se autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore, si p.sh. organet që rregullohen nga e drejta publike, që mund të kenë pjesëmarrje me kapital privat, duhet të jenë në gjendje të bëhen pjesë e përjashtimit për bashkëpunim horizontal. Rrjedhimisht, kur përmbushen të gjitha kushtet e tjera që lidhen me bashkëpunimin horizontal, përjashtimet për bashkëpunim horizontal duhet të përfshijnë edhe këto autoritete kontraktore ose subjekte kontraktore kur kontrata lidhet ekskluzivisht ndërmjet autoriteteve kontraktore ose subjekteve kontraktore.

47. Autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore që përmenden në germën a të nenit 7, paragrafi 1, duhet të kenë të drejtën e zgjedhjes së ofrimit të shërbimeve të tyre publike në bashkëpunim, pa qenë të detyruar të përdorin ndonjë formë ligjore të caktuar. Një bashkëpunim i tillë mund të mbulojë të gjitha llojet e veprimtarive, që lidhen me kryerjen e shërbimeve dhe përmbushjen e përgjegjësive që u caktohen autoriteteve pjesëmarrëse, ose që merren përsipër prej tyre, siç janë detyrat e detyrueshme ose vullnetare të autoriteteve lokale ose rajonale ose shërbimet që u caktohen organeve specifike përmes të drejtës publike. Nuk është e domosdoshme që shërbimet që ofrohen nga autoritete ose subjekte të ndryshme pjesëmarrëse të jenë identike; ato mund të jenë edhe plotësuese. Kontratat për ofrimin e përbashkët të shërbimeve publike nuk duhet t'i nënshtrohen kësaj direktive, me kusht që ato të jenë lidhur ekskluzivisht ndërmjet autoriteteve kontraktore ose subjekteve kontraktore, që zbatimi i këtij bashkëpunimi të jetë rregulluar vetëm nga faktorë që lidhen me interesin publik dhe që asnjë ofrues privat i shërbimit të mos ketë avantazhe mbi konkurrentët e tij.

Me qëllim që të përmbushë këto kushte, bashkëpunimi duhet të bazohet në një koncept bashkëpunues. Ky bashkëpunim nuk kërkon që të gjithë autoritetet pjesëmarrëse të marrin përsipër zbatimin e detyrave kontraktuale kryesore, nëse ka angazhime për të kontribuar për zbatimin në bashkëpunim të shërbimeve publike në fjalë. Gjithashtu, zbatimi i bashkëpunimit, duke përfshirë çdo transfertë financiare ndërmjet autoriteteve kontraktore pjesëmarrëse, duhet të drejtohet vetëm nga faktorë që lidhen me interesin publik.

48. Ka edhe raste kur një subjekt juridik vepron, në zbatim të dispozitave përkatëse të legjislacionit të brendshëm, si një instrument ose shërbim teknik për autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore të përcaktuara dhe është i detyruar t'u bindet urdhrave që i jepen nga autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore dhe nuk ndikon në shpërblimin për performancën e tij. Duke marrë parasysh natyrën e saj jokontraktuale, një marrëdhënie kaq

administrative nuk duhet të përfshihet në fushën e zbatimit të procedurave për dhënie koncesioni.

49. Duhet të sqarohet se koncepti i "operatorëve ekonomikë" duhet të përfshijë të gjithë personat dhe/ose subjektet që ofrojnë realizimin e punëve, furnizimin e produkteve ose ofrimin e shërbimeve në treg, pavarësisht nga forma ligjore sipas të cilës ata kanë zgjedhur të ushtrojnë veprimtarinë. Rrjedhimisht, firmat, degët, filialet, partneritetet, shoqëritë kooperative, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara, universitetet, publike ose private, dhe forma të tjera subjektsh duhet të përfshihen të gjitha në konceptin e operatorit ekonomik, pavarësisht nëse janë ose jo "persona juridikë" në të gjitha rrethanat.
50. Për të garantuar publikimin e përshtatshëm të koncesioneve të punëve dhe të shërbimeve, me vlerë të barabartë me ose më të lartë se një kufi i caktuar, që jepen nga subjektet kontraktore dhe nga autoritetet kontraktore, dhënia e këtyre koncesioneve duhet të paraprihet nga shpallja e detyrueshme e njoftimit të kontratës së koncesionit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.
51. Duke pasur parasysh efektet e dëmshme për konkurrencën, dhënia e koncesioneve pa shpallje paraprake duhet të lejohet vetëm në rrethana shumë të veçanta. Ky përjashtim duhet të kufizohet me rastet kur është e qartë që në fillim se shpallja nuk do të nxisë konkurrencë më të madhe, sidomos aty ku, objektivisht, ka vetëm një operator ekonomik që mund ta zbatojë koncesionin. Pamundësia për t'ia dhënë koncesionin ndonjë operatori tjetër ekonomik, nuk duhet të jetë krijuar nga vetë autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor në kuadër të procedurës së koncesionit në të ardhmen. Gjithashtu duhet të shqyrtohet me imtësi disponueshmëria e zëvendësuesve të përshtatshëm.
52. Kohëzgjatja e koncesionit duhet të jetë e kufizuar, me qëllim që të shmangen pengesat për të hyrë në treg dhe kufizimi i konkurrencës. Gjithashtu, koncesionet me afat shumë të gjatë kanë gjasa që të çojnë në një mbyllje të tregut dhe në këtë mënyrë mund të pengojnë lëvizjen e lirë të shërbimeve dhe lirinë e vendosjes. Megjithatë, kjo kohëzgjatje mund të jetë e justifikuar nëse është e domosdoshme për t'i mundësuar koncesionarit kthimin e investimit të planifikuar për të kryer koncesionin, si edhe kthimin e kapitalit të investuar. Kështu, për koncesionet me kohëzgjatje mbi pesë vjet, kohëzgjatja duhet të kufizohet me periudhën gjatë së cilës koncesionari pritët, në mënyrë të arsyeshme, të realizojë kthimin e investimit që ka kryer për zbatimin e punëve dhe shërbimeve, së bashku me kthimin e kapitalit të investuar në kushte normale operimi, duke marrë në konsideratë objektivat kontraktuale specifike të marra përsipër nga koncesionari për të plotësuar kërkesat që lidhen, për shembull, me cilësinë ose çmimin për përdoruesit. Vlerësimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e dhënies së koncesionit. Duhet të ekzistojë mundësia e përfshirjes së investimeve fillestare dhe atyre të mëtejshme që konsiderohen të nevojshme për realizimin e koncesionit, në veçanti shpenzimet për infrastrukturë, të drejtat e autorit, patentat, pajisjet, logjistikën, marrjen në punë, trajnimin e personelit dhe shpenzimet fillestare. Kohëzgjatja maksimale e koncesionit duhet të

cilësohet në dokumentet e koncesionit, përveçse kur kohëzgjatja përdoret si një kriter për dhënien e kontratës. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore duhet të jenë gjithnjë në gjendje të japin një koncesion për një periudhë më të shkurtër sesa koha e nevojshme për kthimin e investimit, me kusht që kompensimi përkatës të mos eliminojë rrezikun operacional.

53. Është me vend që të përjashtohen nga zbatimi i plotë i kësaj direktive vetëm ato shërbime që kanë një dimension ndërkufitar të kufizuar, siç janë disa shërbime sociale, shëndetësore ose arsimore. Këto shërbime ofrohen brenda një konteksti të veçantë, që ndryshon shumë nga njëri shtet anëtar në tjetrin për shkak të traditave të ndryshme kulturore. Ndaj duhet të ngrihet një regjim specifik për koncesionet e këtyre shërbimeve, i cili merr në konsideratë faktin se ato janë rregulluar së fundmi. Detyrimi për shpalljen e një njoftimi paraprak të informacionit dhe një njoftimi për shpalljen e fituesit të kontratës së koncesionit, për çdo koncesion me një vlerë të barabartë me ose më të madhe se kufiri monetar i caktuar në këtë direktivë, është një mënyrë e përshtatshme për të informuar ofertuesit e mundshëm për mundësitë e biznesit, si edhe për të informuar të gjitha palët e interesuara për numrin dhe llojin e kontratave të dhëna. Gjithashtu, shtetet anëtare duhet të zbatojnë masat e përshtatshme që lidhen me dhënien e kontratave të koncesionit për ato shërbime, të cilat kanë si synim të garantojnë pajtueshmëri me parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që u lejojnë autoriteteve kontraktore ose subjekteve kontraktore të marrin në konsideratë specifikat e shërbimeve në fjalë. Shtetet anëtare duhet të garantojnë që autoriteteve kontraktore dhe subjekteve kontraktore t'u lejohet të marrin në konsideratë nevojën për të garantuar novacion dhe cilësi, siguri dhe volitshmëri të lartë, trajtim të barabartë dhe promovimin e qasjes universale dhe të të drejtave të përdoruesve, në përputhje me nenin 14 të TFBE-së dhe Protokollin nr. 26.
54. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e kontekstit kulturor dhe ndjeshmërinë e këtyre shërbimeve, shteteve anëtare duhet t'u jepet liri veprimi për të organizuar zgjedhjen e ofruesve të shërbimeve në mënyrën që ata e konsiderojnë si më të përshtatshmen. Kjo direktivë nuk i pengon shtetet anëtare që të zbatojnë kritere specifike cilësie, për zgjedhjen e ofruesit të shërbimeve, siç janë kriteret që përcaktohen në kuadrin evropian vullnetar për cilësinë e shërbimeve sociale, të përgatitur nga Komiteti i Bashkimit Evropian për Mbrojtjen Sociale. Shtetet anëtare dhe/ose autoritetet publike janë të lira t'i ofrojnë vetë këto shërbime ose t'i organizojnë shërbimet sociale në mënyrë të tillë që të mos përfshijnë dhënien e koncesioneve, për shembull nëpërmjet financimit të këtyre shërbimeve ose nëpërmjet dhënies së licencave ose autorizimeve për të gjithë operatorët ekonomikë që plotësojnë kushtet e vendosura paraprakisht nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor, pa asnjë kufizim ose kuotë, me kusht që këto sisteme të garantojnë publikimin e mjaftueshëm dhe të jenë në pajtim me parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit.
55. Duke synuar integrimin e përshtatshëm të kërkesave mjedisore, sociale dhe atyre të punës në procedurat e dhënies së koncesionit, është shumë e rëndësishme që shtetet anëtare dhe



autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore të marrin masat përkatëse për të garantuar pajtueshmërinë me detyrimet në fushat e legjislacionit mjedisor, social dhe të punës, që zbatohen në vendin ku realizohen punët ose shërbimet e ofruara dhe që rrjedhin nga ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative, në nivel kombëtar ose në nivel të Bashkimit Evropian, si edhe nga kontratat kolektive, me kusht që këto rregulla dhe zbatimi i tyre të jenë në pajtim me të drejtën e Bashkimit Evropian. Po kështu, gjatë zbatimit të koncesionit duhet të zbatohen edhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare që janë ratifikuar nga të gjitha shtetet anëtare dhe që janë renditur në këtë direktivë. Megjithatë, kjo nuk duhet të pengojë në asnjë mënyrë zbatimin e kushteve të punësimit, që janë më të favorshme për punonjësit. Masat përkatëse duhet të zbatohen në përputhje me parimet bazë të së drejtës së Bashkimit Evropian, në veçanti, duke synuar garantimin e trajtimit të barabartë. Këto masa përkatëse duhet të zbatohen në përputhje me Direktivën 96/71/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(15)</sup>, dhe në një mënyrë të tillë që garanton trajtimin e barabartë dhe që nuk diskriminon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë operatorët ekonomikë dhe punonjësit nga shtete anëtare të tjera.

56. Shërbimet duhet të konsiderohen se ofrohen në vendin ku zbatohen detyrat që i karakterizojnë. Kur shërbimet ofrohen në distancë, si për shembull shërbimet që ofrohen nga qendrat e thirrjeve (call centre), këto shërbime duhet të konsiderohen se ofrohen në vendin ku ato realizohen, pavarësisht vendeve dhe shteteve anëtare të cilëve u drejtohen.
57. Detyrimet përkatëse mund të pasqyrohen në klauzolat e koncesionit. Duhet të jetë e mundur që të përfshihen edhe klauzolat që garantojnë pajtueshmërinë me kontratat kolektive, në pajtim me të drejtën e Bashkimit Evropian për koncesionet. Mospërputhja me detyrimet përkatëse mund të konsiderohet si shkelje e rëndë nga ana e operatorit ekonomik në fjalë dhe mund të shërbejë për ta përjashtuar këtë operator ekonomik nga procedura për dhënien e një koncesionit.
58. Gjatë zbatimit të parimeve të përgjithshme, që rregullojnë zgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave, dhe gjatë zbatimit të kritereve të përjashtimit, kontrolli për respektimin e dispozitave të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës duhet të kryhet në fazat përkatëse të procedurës për dhënien e koncesionit.
59. Asgjë në këtë direktivë nuk duhet të pengojë vendosjen ose zbatimin e masave që nevojiten për të mbrojtur politikat publike, moralin publik, sigurinë publike, shëndetin, jetën e njerëzve dhe të kafshëve, ruajtjen e bimëve ose masa të tjera mjedisore, në veçanti në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm, me kusht që këto masa të jenë në përputhje me TFBE-në.
60. Për të garantuar konfidencialitetin gjatë procedurës, autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore, si edhe operatorët ekonomikë nuk duhet të bëjnë publik informacionin që është cilësuar si konfidencial. Mospërputhja me këtë detyrim duhet të çojë në zbatimin e

sanksioneve të përshtatshme, në mënyrën dhe në rastet e parashikuara nga e drejta civile ose administrative e shteteve anëtare.

61. Për të luftuar mashtrimin, favorizimin dhe korrupsionin dhe për të parandaluar konfliktet e interesit, shtetet anëtare duhet të marrin masat e përshtatshme për të garantuar transparencën e procedurës së dhënies së koncesionit dhe trajtimin e barabartë të të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Këto masa në veçanti duhet të synojnë eliminimin e konflikteve të interesit dhe parregullsi të tjera të serioze.
62. Për t'u mundësuar të gjithë operatorëve të synuar që të dorëzojnë aplikimet dhe ofertat, autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore duhet të jenë të detyruar të respektojnë afatet kohore minimale për pranimin e këtyre aplikimeve dhe ofertave.
63. Zgjedhja e kriterëve për përzgjedhje proporcionale, jodiskriminuese dhe të drejtë, si dhe zbatimi i tyre për operatorët ekonomikë është thelbësore për t'i mundësuar operatorëve një qasje efikase në mundësitë ekonomike që lidhen me koncesionet. Mundësia që i jepet një kandidati për t'u mbështetur në kapacitetet e subjekteve të tjera, në veçanti, mund të jetë vendimtare për të mundësuar pjesëmarrjen e SME-ve. Si rezultat, është me vend të parashikohet që kriteret e përzgjedhjes të bazohen ekskluzivisht në aftësinë profesionale dhe teknike dhe gjendjen financiare dhe ekonomike të operatorëve dhe të jenë të lidhura me objektin e kontratës, të shpallen në njoftimin e kontratës së koncesionit dhe të mos e pengojnë një operator ekonomi, përveçse në rrethana të veçanta, që të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve të tij me ato subjekte, nëse këto të fundit i vërtetojnë autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor se ai do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
64. Gjithashtu, duke synuar integrimin më të mirë të faktorëve social dhe mjedisor në procedurat e dhënies së koncesionit, autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore duhet të lejohen që të përdorin kriteret për dhënien e koncesionit ose kushte për zbatimin e koncesionit që lidhen me punët ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të kontratës së koncesionit në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor nga nxjerrja e lëndëve të para për produktin deri në fazën e asgjësimit të produktit, duke përfshirë faktorët që lidhen me procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve ose shërbimeve ose një proces specifik gjatë një faze të mëvonshme të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këto faktorë nuk janë pjesë e përmbajtjes së tyre thelbësore. Kriteret dhe kushtet që lidhen me një proces të tillë prodhimi ose ofrimi janë, për shembull, që shërbimet që janë objekt i koncesionit të ofrohen duke përdorur makineri që kursejnë energji. Në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian këtu përfshihen edhe kriteret për dhënien e koncesionit ose kushtet për zbatimin e koncesionit, që lidhen me përdorimin e produkteve të tregtuara sipas rregullave gjatë zbatimit të koncesionit që jepet. Kriteret dhe kushtet që lidhen me tregtimin dhe kushtet e tij mund t'i referohen, për shembull, kërkesës për t'u paguar nënkontraktorëve një çmim minimal ose çmimin relativ. Kushtet për zbatimin e koncesionit, që lidhen me

faktorët mjedisor mund të përfshijnë, për shembull, minimizimin e mbetjeve ose efijencën e burimeve.

65. Kriteret për dhënien e koncesionit ose kushtet për zbatimin e koncesionit, që lidhen me aspektet sociale të procesit të prodhimit duhet të zbatohen në përputhje me Direktivën 96/71/KE, siç interpretohen nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian dhe nuk duhet të zgjidhen ose të zbatohen në mënyrë të tillë që të diskriminohen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi operatorët ekonomikë nga shtete anëtare të tjera ose nga vende të treta, që janë palë e Marrëveshjes së Organizatës Botërore të Tregtisë për Prokurimet Qeveritare (GPA) ose të marrëveshjeve të tregtisë së lirë, në të cilat Bashkimi Evropian është palë. Kështu, kërkesat që lidhen me kushtet bazë të punës, që rregullohen nga Direktiva 96/71/KE, siç janë nivelet minimale të pagesës, duhet të ruhen në nivelin e përcaktuar nga legjislacioni i brendshëm ose nga kontratat kolektive, që zbatohen në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian në kontekstin e asaj direktive. Kushtet për zbatimin e koncesionit, mund të parashikohen edhe për të favorizuar zbatimin e masave për nxitjen e barazisë së grave dhe burrave në punë, rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe ekuilibrimin e punës dhe jetës private, mbrojtjen e mjedisit ose të mirëqenies së kafshëve dhe për të qenë në pajtim në thelb me konventat kryesore të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) dhe për të punësuar më shumë persona në nevojë nga sa kërkohet në zbatim të legjislacionit të brendshëm.
66. Masa që synojnë mbrojtjen e shëndetit të stafit të përfshirë në zbatimin e koncesionit, favorizimi i përfshirjes sociale të personave në nevojë ose anëtarëve të grupeve vulnerabël në radhët e personave të emëruar për zbatimin e koncesionit ose trajnimi për aftësitë që nevojiten për koncesionin në fjalë, gjithashtu mund të jenë objekt i kriterëve për dhënien e koncesionit ose kushteve për zbatimin e koncesionit, me kusht që ato të kenë lidhje me punët ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të koncesionit. Për shembull, këto kritere ose kushte mund t'i referohen, ndër të tjera, punësimit të punëkërkuësve afatgjatë, zbatimit të masave për trajnimin e personave të papunë ose të rinjve, gjatë zbatimit të koncesionit që do të jepet. Autoritetet kontraktore mund të parashikojnë, në specifikimet teknike, kërkesa sociale që karakterizojnë drejtpërsëdrejti produktin ose shërbimin në fjalë, si aksesueshmëria për personat me aftësi të kufizuar ose projektimi i përshtatshëm për të gjithë përdoruesit.
67. Kërkesat teknike dhe funksionale që hartohen nga autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore duhet të lejojnë konkurrencën e hapur për dhënien e koncesionit. Këto kërkesa duhet të përcaktojnë karakteristikat që kërkohen për punët dhe/ose shërbimet që mbulohen nga koncesioni dhe mund t'i referohen procesit specifik të prodhimit ose ofrimit të punëve ose shërbimeve të kërkuara, me kusht që ato të kenë lidhje me objektin e koncesionit dhe të jenë proporcionale me vlerën dhe objektivat e tij. Procesi specifik i prodhimit mund të përfshijë kërkesa që lidhen me aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar ose me nivelet e performancës mjedisore. Këto kërkesa teknike dhe funksionale duhet të përfshihen në dokumentet e koncesionit dhe duhet të jenë në përputhje me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës. Ato duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të shmangin ngushtimin

artificial të konkurrencës, në veçanti nëpërmjet kërkesave që favorizojnë një operator ekonomik specifik, duke pasqyruar karakteristika kyçe të furnizimeve, shërbimeve ose punëve që ofrohen zakonisht nga ai operator ekonomik. Për çdo rast, ofertat që përfshijnë punë dhe/ose shërbime, duke përfshirë furnizimet që janë plotësuese për këto punë dhe shërbime, të cilat përputhen në mënyrë të barasvlershme me karakteristikat e kërkuara duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore.

68. Koncesionet zakonisht janë marrëveshje afatgjata të ndërlikuara, ku koncesionari merr përsipër përgjegjësi dhe rreziqet, që tradicionalisht mbulohen nga autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore dhe që normalisht përfshihen në sferën e kompetencave së tyre. Për këtë arsye, në pajtim me këtë direktivë dhe parimet e transparencës dhe trajtimit të barabartë, autoriteteve kontraktore dhe subjekteve kontraktore duhet t'u lejohet fleksibilitet i konsiderueshëm për të përcaktuar dhe për të organizuar procedurat për zgjedhjen e koncesionarit. Megjithatë, për të garantuar trajtim të barabartë dhe transparencë gjatë gjithë procesit të prokurimit, duhet të parashikohen garancitë bazë në lidhje me procesin e prokurimit, duke përfshirë informacione për natyrën dhe objektin e koncesionit, kufizimet për numrin e kandidatëve, shpërndarjen e informacionit të kandidatët dhe ofertuesit dhe disponueshmërinë e të dhënave të përshtatshme. Gjithashtu, është e nevojshme që të garantohet se nuk do të ketë devijime nga kushtet fillestare të njoftimit të kontratës së koncesionit, me qëllim për të parandaluar trajtimin e padrejtë të ndonjë kandidati të mundshëm.
69. Koncesionet nuk duhet t'u jepen operatorëve ekonomikë që kanë marrë pjesë në organizata kriminale ose janë shpallur fajtorë për korrupsion ose mashtrim në dëm të interesave financiare të Bashkimit Evropian, për vepra me qëllime terroriste, pastrim parash, financim të terrorizmit ose trafikim të qenieve njerëzore. Megjithatë, shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të parashikojnë një shmangie nga këto përjashtime detyruese për situata të veçanta, kur kërkesat parësore në interes të përgjithshëm e bëjnë të domosdoshme dhënien e kontratës. Mospagimi i taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore duhet të sanksionohet me anë të përjashtimit të detyrueshëm në nivel Bashkimi Evropian.
70. Gjithashtu, autoriteteve kontraktore dhe subjekteve kontraktore duhet t'u jepet mundësia që të përjashtojnë operatorët ekonomikë që kanë vërtetuar se janë të dyshimtë, për shembull, për shkak të shkeljeve të rënda ose të përsëritura të detyrimeve mjedisore ose sociale, duke përfshirë rregullat për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuar ose forma të tjera të shkeljes së rëndë profesionale, siç është shkelja e rregullave të konkurrencës ose e të drejtave të pronësisë intelektuale. Duhet të sqarohet se shkelja e rëndë profesionale mund të vërë në pikëpyetje integritetin e një operatori ekonomik duke e bërë atë të papërshtatshëm për të marrë një kontratë koncesioni, pavarësisht nëse operatori ekonomik do të kishte kapacitetin teknik dhe ekonomik për të zbatuar kontratën. Duke pasur parasysh se autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor është përgjegjës për pasojat e vendimeve të mundshme të gabuara, autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore gjithashtu duhet të jenë të lira të

marrin në konsideratë se ka ndodhur një shkelje e rëndë profesionale kur, përpara se të jetë dhënë një vendim i formës së prerë për praninë e arsyeve të detyrueshme përjashtuese ata mund të provojnë me çdo mënyrë të përshtatshme se operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij, duke përfshirë detyrimet që lidhen me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në legjislacionin e brendshëm. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore gjithashtu duhet të jenë në gjendje të përjashtojnë kandidatët ose ofertuesit, të cilët gjatë zbatimit të koncesioneve ose kontratave të tjera të mëparshme me autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore kanë shfaqur mangësi madhore në lidhje me kërkesat kryesore, për shembull, paaftësi në dorëzim ose zbatim, mangësi të konsiderueshme të produktit ose shërbimit të furnizuar, që e bëjnë atë të papërdorshëm për qëllimin e synuar, ose shkelje që hedh dyshime të rënda për besueshmërinë e operatorit ekonomik. Legjislacioni i brendshëm duhet të parashikojë kohëzgjatjen maksimale për këto përjashtime.

71. Megjithatë, duhet të lejohet mundësia që një operator ekonomik të zbatojë masat e pajtueshmërisë, që synojnë të korrigjojnë pasojat e ndonjë vepre penale ose shkeljeje dhe të parandalojnë me efikasitet raste të tjera shkeljeje. Këto masa mund të konsistojnë në veçanti në masa organizative ose masa lidhur me personelin, siç është shkëputja e të gjitha lidhjeve me personat ose organizatat e përfshira në shkelje, masa të përshtatshme për riorganizimin e stafit, zbatimin e sistemeve të raportimit dhe të kontrollit, krijimin e një strukture për kontroll të brendshëm për të monitoruar pajtueshmërinë dhe miratimin e rregullave brendshme për detyrimin dhe kompensimin. Kur këto masa ofrojnë garanci të mjaftueshme, operatori ekonomik në fjalë nuk duhet të përjashtohet më vetëm për këto arsye. Operatorët ekonomikë duhet të kenë mundësi që të kërkojnë shqyrtimin e masave të pajtueshmërisë që janë marrë duke pasur parasysh pranimin e mundshëm në procedurën e dhënies së koncesionit. Megjithatë, duhet t'u lihet në dorë shteteve anëtare që të përcaktojnë kushtet procedurale dhe funksionale që zbatohen në raste të tilla. Në veçanti, ata duhet të jenë të lirë të vendosin nëse do t'u lejojnë autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore individuale që të kryejnë shqyrtimet përkatëse apo t'ia besojnë këtë detyrë autoriteteve të tjera në nivel qendror ose të decentralizuar.
72. Është e rëndësishme që respektimi nga ana e nënkontraktorëve i detyrimeve të zbatueshme në fushat e legjislacionit mjedisor, social dhe atij të punës, të përcaktuara nga e drejta e Bashkimit Evropian, legjislacioni i brendshëm, kontratat kolektive ose nga dispozitat e legjislacionit ndërkombëtar mjedisor, social dhe të punës, të renditura në këtë direktivë, me kusht që këto rregulla dhe zbatimi i tyre të jetë në pajtim me të drejtën e Bashkimit Evropian, të garantohen nëpërmjet veprimeve të përshtatshme nga autoritetet kombëtare kompetente brenda fushës së përgjegjësive dhe kompetencave të tyre, siç janë agjencitë për inspektimin e punës ose agjencitë për mbrojtjen e mjedisit. Është gjithashtu e nevojshme të garantohet një nivel transparence në zinxhirin e nënkontraktimit, pasi në këtë mënyrë autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore marrin informacion se kush është i pranishëm në

kantieret e ndërtimit ku po kryhen punët ose ku sipërmarrjet po ofrojnë shërbimet në ndërtesa, infrastruktura ose zona, siç janë bashkitë, shkollat e qytetit, mjediset sportive, portet ose autostradat, për të cilat subjektet kontraktore janë përgjegjëse ose i kanë nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë. Duhet të sqarohet se detyrimi për të dhënë informacionin e kërkuar i takon koncesionarit, qoftë në bazë të klauzolave specifike, që çdo autoritet kontraktor ose subjekt kontraktor duhet të përfshijë në të gjitha procedurat e prokurimit ose mbi bazën e detyrimeve që shtetet anëtare duhet të vendosin për koncesionarin me anë të dispozitave të përgjithshme të zbatueshme.

Gjithashtu, duhet të sqarohet se kushtet për respektimin e detyrimeve të zbatueshme në fushat e legjislacionit mjedisor, social dhe atij të punës, të përcaktuara nga e drejta e Bashkimit Evropian, legjislacioni i brendshëm, kontratat kolektive ose me anë të dispozitave të së drejtës ndërkombëtare mjedisore, sociale dhe të punës, të radhitura në këtë direktivë, me kusht që këto rregulla dhe zbatimi i tyre të jenë në pajtim me të drejtën e Bashkimit Evropian, duhet të zbatohen sa herë që legjislacioni i brendshëm i një shteti anëtar parashikon një mekanizëm të përgjegjësisë së përbashkët ndërmjet nënkontraktorëve dhe koncesionarit. Gjithashtu, duhet të parashikohet shprehimisht se shtetet anëtare mund të shkojnë edhe më tej, për shembull duke shtuar detyrimet për transparencë ose duke lejuar autoritetet kontraktore ose subjekteve kontraktore ose duke u kërkuar atyre të verifikojnë që nënkontraktorët nuk gjenden në kushte të tilla ku përjashtimi i operatorëve ekonomikë do të ishte i garantuar. Kur këto masa zbatohen për nënkontraktorët, duhet të sigurohet edhe një lidhje logjike me dispozitat e zbatueshme për koncesionerin, në mënyrë që kur të ekzistojnë arsye të detyrueshme për përjashtimin e nënkontraktorit, të ekzistojë edhe kërkesa për zëvendësimin e këtij nënkontraktori me koncesionerin. Nëse nga ky verifikim rezulton se ka arsye jo-detyruese për përjashtimin, duhet të bëhet e qartë që autoriteteve kontraktore ose subjekteve kontraktore u lejohet të kërkojnë zëvendësimin. Megjithatë, duhet të përcaktohet qartë që autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore mund të jenë të detyruar të kërkojnë zëvendësimin e nënkontraktorit në fjalë, kur përjashtimi i koncesionarit do të ishte i detyrueshëm në këto raste. Gjithashtu, duhet të përcaktohet qartë se shtetet anëtare janë të lira të parashikojnë rregulla më të rrepta për detyrimet, në legjislacionin e tyre të brendshëm.

73. Autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore duhet t'i vlerësojnë ofertuesit mbi bazën e një ose disa kriterëve për dhënien e koncesionit. Me qëllim për të garantuar transparencën dhe trajtim të barabartë kriteret për dhënien e koncesioneve duhet të jenë gjithmonë në pajtim me disa standarde të përgjithshme. Këto standarde mund t'u referohen faktorëve që nuk janë vetëm ekonomikë, por që ndikojnë në vlerën e një oferte nga këndvështrimi i autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor dhe i lejojnë atij që të identifikojë një avantazh ekonomik të përgjithshëm për autoritetin kontraktor ose subjektin kontraktor. Kriteret duhet të bëhen publike paraprakisht për të gjithë kandidatët ose ofertuesit e mundshëm, të jenë të lidhur me objektin e kontratës dhe nuk duhet t'i ofrojnë autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ata duhet të lejojnë konkurrencën efikase dhe të shoqërohen nga kërkesa që lejojnë verifikimin efikas të informacionit të dhënë nga ofertuesit. Duhet të

mundësohet që në kriteret për dhënien e koncesionit të përfshihen, ndër të tjera, edhe kriteret mjedisore, sociale ose që lidhen me novacionin. Autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore gjithashtu duhet t'i tregojnë kriteret për dhënien e koncesionit në një rend zbritës për nga rëndësia në mënyrë që të garantohet trajtimi i barabartë i ofertuesve të mundshëm, duke u lejuar atyre që të jenë në dijeni për të gjithë elementet që duhet të marrin në konsideratë gjatë përgatitjes së ofertave të tyre.

Në raste të veçanta, kur autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor merr një ofertë e cila propozon një zgjidhje novatore me një nivel të veçantë zbatimi funksional, që nuk mund të ishte parashikuar nga një autoritet kontraktor ose subjekt kontraktor i vëmendshëm, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor, në veçanti, duhet të jenë në gjendje që të ndryshojnë rendin e kriterëve për dhënien e koncesionit për të marrë në konsideratë mundësitë e reja të prezantuara nga ajo zgjidhje novatore, me kusht që ky modifikim të garantojë trajtimin e barabartë të të gjithë ofertuesve aktualë ose të mundshëm duke shpallur një ftesë të re për ofertë, ose kur është e përshtatshme, duke shpallur një njoftim të ri të kontratës së koncesionit.

74. Mjetet elektronike të komunikimit dhe informacionit mund të thjeshtësojnë shumë shpalljen e koncesioneve dhe të rrisin efikasitetin, shpejtësinë dhe transparencën e proceseve për dhënien e koncesionit. Ato mund të kthehen në mjete standarde komunikimi dhe të shkëmbimi të informacionit gjatë procedurave për dhënien e koncesionit, sepse ato rrisin shumë mundësitë e operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në procedurat për dhënien e koncesionit në të gjithë tregun e brendshëm.
75. Kontratat e koncesionit përgjithësisht përfshijnë mekanizma teknike dhe financiare afatgjata dhe komplekse që shpesh u nënshtrohen ndryshimeve. Ndaj, është e nevojshme që të sqarohen kushtet sipas të cilave modifikimet e një koncesioni gjatë zbatimit të tij kërkojnë një procedurë të re për dhënien e koncesionit, duke marrë në konsideratë praktikën gjyqësore përkatëse të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Në rastin e ndryshimeve të rëndësishme në koncesionin fillestar, në veçanti në objektin dhe përmbajtjen e të drejtave dhe detyrimeve të përbashkëta të palëve, duke përfshirë shpërndarjen e të drejtave për pronësinë intelektuale, kërkohet një procedurë e re koncesioni. Këto ndryshime tregojnë qëllimin e palëve për të rinegociuar kushtet thelbësore të atij koncesioni. Rasti më tipik i kësaj, do të ishte kur kushtet e ndryshuara do të kishin pasur ndikim në gjithë rezultatin e procedurës, nëse do të kishin qenë pjesë e saj që në fillim. Modifikimet e koncesionit që çojnë në ndryshim të vogël të vlerës së kontratës, deri në një nivel të caktuar, mund të bëhen në çdo kohë, pa qenë nevoja për zhvillimin e një procedure të re koncesioni. Për këtë qëllim dhe për të garantuar sigurinë juridike, kjo direktivë duhet të parashikojë kufij monetarë *de minimis* nën të cilët nuk nevojitet një procedurë e re për dhënien e koncesionit. Modifikimet e koncesionit mbi këto kufij monetarë mund të bëhen pa qenë nevoja për të zhvilluar një procedurë të re për dhënien e koncesionit, nëse këto modifikime janë në pajtim me disa kushte të caktuara. Ky mund të jetë, për shembull, rasti i modifikimeve që duhen bërë pas

nevojës për të plotësuar kërkesat nga autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore, lidhur me kërkesat e sigurisë dhe duke marrë në konsideratë specifikat e këtyre veprimtarive, si për shembull, shfrytëzimi i objekteve turistike dhe sportive malore, ku legjislati mund të kërkojë trajtimin e rreziqeve që lidhen me to, nëse këto modifikime janë në përputhje me kushtet përkatëse të parashikuara në këtë direktivë.

76. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore mund të përballen me rrethana të jashtme, të cilat ata nuk mund t'i parashikojnë gjatë dhënies së koncesionit dhe sidomos kur koncesioni është me afat të gjatë. Në këto raste, nevojitet një shkallë e caktuar fleksibiliteti për ta përshtatur koncesionin me këto rrethana, pa kryer një procedurë të re koncesioni. Koncepti i rrethanave të parashikuara i referohet rrethanave që nuk mund të parashikoheshin, pavarësisht përgatitjes së kujdesshme të prokurimit fillestar nga ana e autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor, duke marrë në konsideratë mjetet që ai ka në dispozicion, natyrën dhe karakteristikat e projektit specifik, praktikën e mirë në fushën në fjalë dhe nevojën për të garantuar një marrëdhënie të përshtatshme ndërmjet burimeve të shpenzuara gjatë përgatitjes së prokurimit dhe vlerës së tij të parashikueshme. Megjithatë, kjo nuk mund të zbatohet në rastet kur një modifikim çon në një ndryshim të natyrës së gjithë koncesionit, për shembull duke zëvendësuar punët që do të kryhen ose shërbimet që do të ofrohen me diçka tjetër ose duke ndryshuar në thelb llojin e koncesionit, duke qenë se në një situatë të tillë mund të supozohet një ndikim hipotetik mbi rezultatin. Për koncesionet që jepen për kryerjen e një veprimtarie të ndryshme nga ato që përmenden në shtojcën II, çdo rritje në vlerë, që nuk kërkon një procedurë të re prokurimi, nuk duhet të jetë më e lartë se 50% e vlerës së koncesionit fillestar. Kur bëhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim duhet të zbatohet për vlerën e secilit modifikim. Këto modifikime të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë si qëllim anashkalimin e kësaj direktive.
77. Në pajtim me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës, në rastin e zgjidhjes së kontratës së koncesionit për shkak të mangësive në realizimin e saj, ofertuesi i suksesshëm nuk duhet të zëvendësohet nga një operator tjetër ekonomik pa e rishpallur njoftimin e koncesionit. Megjithatë, ofertuesi i suksesshëm që zbaton koncesionin duhet të jetë në gjendje, në veçanti kur koncesioni i është dhënë një grupi operatorësh ekonomikë, që t'i nënshtrohet disa ndryshimeve strukturore gjatë zbatimit të koncesionit, si p.sh. riorganizime të brendshme, marrje në kontroll, shkrirje dhe blerje ose falimentim. Këto ndryshime strukturore nuk duhet të kërkojnë automatikisht procedura të reja prokurimi për koncesionin e zbatuar nga ai ofertues.
78. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore duhet të kenë mundësi që të parashikojnë modifikimet e një koncesioni me anë të klauzolave shqyrtuese ose opsionale, por këto klauzola nuk duhet t'u japin atyre liri veprimi të pakufizuar. Ndaj kjo direktivë duhet të përcaktojë masën deri në të cilën mund të parashikohen modifikimet në koncesionin fillestar. Kështu duhet të sqarohet se klauzolat shqyrtuese ose opsionale të hartuara me qartësi të mjaftueshme për shembull, mund të parashikojnë indeksimin e çmimit ose të garantojnë, për



shembull, që pajisjet e komunikimit që do të dorëzohen për një periudhë të caktuar kohore të vazhdojnë të jenë të përshtatshme dhe në rast të ndryshimit të protokolleve të komunikimit ose ndryshime të tjera teknologjike. Gjithashtu, me anë të klauzolave të qarta, duhet të parashikohen edhe përshtatjet e koncesionit, të cilat bëhen të nevojshme për shkak të vështirësive teknike që shfaqen gjatë shfrytëzimit ose mirëmbajtjes. Gjithashtu, duhet të kujtohet se koncesionet, për shembull, mund të përfshijnë mirëmbajtjen e zakonshme, si edhe të parashikojnë ndërhyrje të jashtëzakonshme për mirëmbajtje, të cilat mund të nevojiten për të garantuar vazhdimësinë e një shërbimi publik.

79. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore mund të përballen me situata ku nevojiten punë ose shërbime shtesë. Në këto raste, nëse kushtet e përcaktuara në këtë direktivë përmbushen, modifikimi i koncesionit fillestar pa një procedurë të re për dhënien e koncesionit duhet të konsiderohet si i justifikuar.
80. Ndonjëherë autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore përballen me situata që kërkojnë zgjidhjen e parakohshme të kontratës së koncesionit, për të qenë në pajtim me detyrimet e vendosura nga e drejta e Bashkimit Evropian në fushën e koncesioneve. Kështu që shtetet anëtare duhet të garantojnë që autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore të kenë mundësi, sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm, që të zgjidhin një kontratë koncesioni gjatë afatit të saj, nëse kjo kërkohet nga e drejta e Bashkimit Evropian.
81. Për të garantuar mbrojtje të përshtatshme gjyqësore për kandidatët dhe ofertuesit gjatë procedurave për dhënien e koncesionit dhe për të vënë në zbatim këtë direktivë dhe parimet e TFBE-së, Direktiva e Këshillit 89/665/KEE<sup>(16)</sup> dhe Direktiva e Këshillit 92/13/KEE<sup>(17)</sup> duhet të zbatohen edhe për koncesionet e shërbimeve dhe koncesionet e punëve që jepen nga autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore. Për sa më lart duhet të ndryshohen direktivat 89/665/KEE dhe 92/13/KEE.
82. Përpunimi i të dhënave personale sipas kësaj direktive duhet të rregullohet nga Direktiva 95/46/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit<sup>(18)</sup>.
83. Shteteve anëtare u kërkohen që të monitorojnë në mënyrë konsistente dhe sistematike zbatimin dhe funksionimin e rregullave për dhënien e kontratave të koncesionit, me qëllim garantimin e zbatimit efikas dhe të njëtrajtshëm të së drejtës së Bashkimit Evropian.
84. Komisioni duhet të shqyrtojë efektet ekonomike në tregun e brendshëm, në veçanti në lidhje me faktorë të tillë si dhënia e kontratave ndërkuftare, pjesëmarrja e SME-ve dhe kostot e transaksionit, që rezultojnë nga zbatimi i kufijve monetarë të përcaktuara në këtë direktivë dhe nga përjashtimi i përcaktuar në nenin 12, duke marrë në konsideratë strukturat specifike të sektorit të ujit. Komisioni duhet t'i raportojë për këtë Parlamentit Evropian dhe Këshillit, përpara datës 18 prill 2019. Në përputhje me nenin XXIV, paragrafi 7 të GPA-së, GPA-ja do të jetë objekt i negociatave të mëtejshme, tre vjet pas hyrjes së saj në fuqi dhe në mënyrë periodike pas kësaj date. Në këtë kontekst, përshtatshmëria e nivelit të kufijve monetarë

duhet të shqyrtohet në kontekstin e negociatave në zbatim të GPA-së duke pasur parasysh ndikimin e inflacionit dhe kostove të transaksionit. Komisioni, aty ku është e mundur dhe e përshtatshme, sugjeron një rritje të kufijve monetarë të zbatueshëm sipas GPA-së gjatë raundit tjetër të negociatave. Në rast të ndonjë ndryshimi në këto kufij monetarë, raporti që bën Komisioni duhet të ndiqet nga një propozim legjislativ, aty ku është e përshtatshme, që modifikon kufirin monetar të përcaktuar në këtë direktivë.

85. Me qëllim përshtatjen ndaj zhvillimeve të shpejta teknike, ekonomike dhe rregullatore, kompetenca për të miratuar akte në përputhje me nenin 290 të TFBE-së duhet t'i delegohet Komisionit në lidhje me rishikimin e listës së akteve të përcaktuara në shtojcën III, që rishikon procedurat teknike për llogaritjen e metodave që kanë të bëjnë me kufirin monetar, si edhe për të rishikuar në mënyrë periodike vetë pragun që ndryshon referencat ndaj nomenklaturës së FPP-së dhe që përshtat listën e akteve të përcaktuara në shtojcën X. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që Komisioni të kryejë konsultimet e nevojshme gjatë punës së tij përgatitore, duke përfshirë në nivel eksperti. Komisioni, gjatë përgatitjes dhe hartimit të akteve të deleguara, duhet të transmetojë njëkohësisht, në kohën dhe mënyrën e duhur të dokumenteve përkatëse të Parlamentit Evropian dhe Këshilli.
86. Me qëllim garantimin e kushteve të njëtrajtshme në lidhje me procedurat për hartimin dhe transmetimin e njoftimeve dhe për dërgimin dhe publikimin e të dhënave të përmendura në shtojcën V, VII, dhe VIII, kompetencat zbatuese duhet t'i akordohen Komisionit. Këto kompetenca duhet të ushtrohen në përputhje me Rregulloren nr. 182/2011 (BE) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(19)</sup>. Procedura këshillimore duhet të përdoret për miratimin e akteve zbatuese, të cilat nuk ndikojnë as mbi situatën financiare, as mbi natyrën dhe objektin e detyrimeve që lindin nga kjo direktivë. Përkundrazi, këto akte karakterizohen nga një qëllim i thjeshtë administrativ dhe shërbejnë për të lehtësuar zbatimin e kësaj direktive.
87. Meqë objektivi i kësaj direktive, përkatësisht koordinimi i ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të shteteve anëtare që zbatohen për disa procedura koncesioni, nuk mund të arrihet në masën e mjaftueshme nga shtetet anëtare dhe si rezultat, për arsye të shkallës dhe ndikimeve, mund të arrihet më mirë në nivel Bashkimi Evropian, Bashkimi Evropian mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritëtit siç përcaktohet në nenin 5 të TBE-së. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sipas përcaktimit në atë nen, kjo direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij objektivi.
88. Në përputhje me Deklaratën Politike të Përbashkët të Shteteve Anëtare dhe të Komisionit të 28 shtatorit 2011 për dokumentet shpjeguese, shtetet anëtare janë angazhuar të shoqërojnë, në rastet e justifikuar, njoftimin për masat e tyre të transpozimit me një ose më shumë dokumente ku shpjegohet marrëdhënia ndërmjet komponentëve të një direktive dhe pjesëve përkatëse të instrumentit kombëtar të transpozimit. Në lidhje me këtë direktivë, ligjvënësi e konsideron transmetimin e këtyre dokumenteve si të justifikuar,

MIRATOJNË KËTË DIREKTIVË:

TITULLI I: OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT, PARIMET DHE PËRKUFIZIME

KAPITULLI I: Fusha e zbatimit, parime të përgjithshme dhe përkufizime

SEKSIONI I: OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT, PARIME TË PËRGJITHSHME, PËRKUFIZIME DHE KUFIRI MONETAR

Neni 1: Objekti dhe fusha e zbatimit

Neni 2: Parimi i lirisë së administrimit nga autoritetet publike

Neni 3: Parimi i trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës

Neni 4: Liria për të përcaktuar shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik

Neni 5: Përkufizime

Neni 6: Autoritetet kontraktore

Neni 7: Subjektet kontraktore

Neni 8: Kufiri monetar dhe metodat për të llogaritur vlerën e parashikuar të koncesioneve

Neni 9: Rishikimi i kufirit monetar

SEKSIONI II: PËRJASHTIME

Neni 10: Përfashtime që zbatohen për koncesionet që jepen nga autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore

Neni 11: Përfashtime specifike në fushën e komunikimeve elektronike

Neni 12: Përfashtime specifike në fushën e ujit

Neni 13: Koncesionet që i jepen një sipërmarrjeje të lidhur

Neni 14: Koncesionet që u jepen sipërmarrjeve të përbashkëta ose një subjekti kontraktor që është pjesë e një sipërmarrjeje të përbashkët

Neni 15: Njoftimi i informacionit nga subjektet kontraktore

Neni 16: Përfashtimi i veprimtarive të ekspozuara drejtpërsëdrejti ndaj konkurrencës

Neni 17: Koncesionet ndërmjet subjekteve në sektorin publik

SEKSIONI III: DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 18: Kohëzgjatja e koncesionit

- Neni 19: Shërbimet sociale dhe shërbime të tjera specifike
- Neni 20: Kontratat e përziera
- Neni 21: Kontratat e prokurimit të përzier, që kanë të bëjnë me aspekte të mbrojtjes ose sigurisë
- Neni 22: Kontratat që mbulojnë si veprimtaritë e përmendura në shtojcën II ashtu edhe veprimtari të tjera
- Neni 23: Koncesionet që mbulojnë si veprimtaritë e përmendura në shtojcën II ashtu edhe veprimtaritë që kanë të bëjnë me aspekte të mbrojtjes ose sigurisë

#### SITUATA SPECIFIKE

#### SEKSIONI IV:

- Neni 24: Koncesionet e rezervuara
- Neni 25: Shërbime për kërkim-zhvillim
- KAPITULLI II: Parimet

- Neni 26: Operatorët ekonomikë
- Neni 27: Nomenklatura
- Neni 28: Konfidencialiteti
- Neni 29: Rregullat e zbatueshme për komunikimin
- TITULLI II: RREGULLAT PËR DHËNIEN E KONCESIONEVE: PARIME TË PËRGJITHSHME DHE GARANCITË PROCEDURALE

#### KAPITULLI I:

#### Parime të përgjithshme

- Neni 30: Parime të përgjithshme
- Neni 31: Njoftimet e kontratës së koncesionit
- Neni 32: Njoftimet për shpalljen e fituesit të kontratës së koncesionit
- Neni 33: Forma dhe mënyra e shpalljes së njoftimeve
- Neni 34: Disponueshmëria e dokumenteve të koncesionit në formë elektronike
- Neni 35: Lufta kundër korrupsionit dhe parandalimi i konflikteve të interesit

#### KAPITULLI II:

#### Garancitë procedurale

- Neni 36: Kërkesa teknike dhe funksionale

Neni 37:	Garancitë procedurale
Neni 38:	Përzgjedhja dhe shqyrtimi cilësor i kandidatëve
Neni 39:	Afatet kohore për pranimin e aplikimeve dhe ofertave për koncesionin
Neni 40:	Dhënia i informacionit kandidatëve dhe ofertuesve
Neni 41:	Kriteret për dhënien e koncesionit
TITULLI III:	RREGULLAT PËR REALIZIMIN E KONCESIONEVE
Neni 42:	Nënkontraktimi
Neni 43:	Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre
Neni 44:	Zgjidhja e kontratave të koncesionit
Neni 45:	Monitorimi dhe raportimi
TITULLI IV:	NDRYSHIMET E DIREKTIVAVE 89/665/KEE DHE 92/13/KEE
Neni 46:	Ndryshimet e Direktivës 89/665/KEE
Neni 47:	Ndryshimet e Direktivës 92/13/KEE
TITULLI V:	KOMPETENCAT E DELEGUARA, KOMPETENCAT ZBATUESE DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE
Neni 48:	Ushtrimi i delegimit
Neni 49:	Procedura urgjente
Neni 50:	Procedura e Komitetit
Neni 51:	Transpozimi
Neni 52:	Dispozita kalimtare
Neni 53:	Monitorimi dhe raportimi
Neni 54:	Hyrja në fuqi
Neni 55:	Marrësit
SHTOJCAT:	
SHTOJCA I:	LISTA E VEPRIMTARIVE TË PËRMENDURA NË PIKËN 7 TË NENIT 5

- SHTOJCA II: VEPRIMTARITË QË USHTROHEN NGA SUBJEKTET KONTRAKTORE, TË PËRMENDURA NË NENIN 7
- SHTOJCA III: LISTA E AKTEVE LIGJORE TË BASHKIMIT EVROPIAN, TË PËRMENDURA NË GERMËN B TË NENIT 7, PARAGRAFI 2
- SHTOJCA IV: SHËRBIMET E PËRMENDURA NË NENIN 19
- SHTOJCA V: INFORMACIONET QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË NJOFTIMET E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË PËRMENDURA NË NENIN 31
- SHTOJCA VI: INFORMACIONET QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË NJOFTIMET PARAPRAKE TË INFORMACIONIT, NË LIDHJE ME KONCESIONET PËR SHËRBIME SOCIALE DHE SHËRBIME TË TJERA SPECIFIKE, TË PËRMENDURA NË NENIN 31, PARAGRAFI 3
- SHTOJCA VII: INFORMACIONET QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË NJOFTIMET PËR SHPALLJEN E FITUESIT TË KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË PËRMENDURA NË NENIN 32
- SHTOJCA VIII: INFORMACIONET QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË NJOFTIMET PËR SHPALLJEN E FITUESIT TË KONTRATËS SË KONCESIONIT, NË LIDHJE ME KONCESIONET PËR SHËRBIME SOCIALE DHE SHËRBIME TË TJERA SPECIFIKE, TË PËRMENDURA NË NENIN 32
- SHTOJCA IX: HOLLËSITË PËR SHPALLJEN
- SHTOJCA X: LISTA E KONVENTAVE NDËRKOMBËTARE SOCIALE DHE MJEDISORE, TË PËRMENDURA NË NENIN 30, PARAGRAFI 3
- SHTOJCA XI: INFORMACIONI QË DUHET TË PËRFSHIHET NË NJOFTIMET E MODIFIKIMEVE TË KONTRATËS SË KONCESIONIT GJATË AFATIT TË SAJ, SIPAS NENIT 43

**TITULLI I**  
**OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT, PARIMET DHE PËRKUFIZIMET**  
**KAPITULLI I**

**Fusha e zbatimit, parime të përgjithshme dhe përkufizime**  
**Seksioni I**

**Objekti, fusha e zbatimit, parime të përgjithshme, përkufizime dhe kufiri monetar**

Neni 1

**Objekti dhe fusha e zbatimit**

1. Kjo direktivë përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore të koncesionit, vlera e të cilit parashikohet të mos jetë më e vogël sesa kufiri monetar i përcaktuar në nenin 8.
2. Kjo direktivë zbatohet për dhënien e koncesioneve të punëve ose shërbimeve operatorëve ekonomikë, nga:
  - a) Autoritetet kontraktore; ose
  - b) Subjektet kontraktore, nëse punët ose shërbimet kanë si qëllim ushtrimin e njëres prej veprimtarive të përmendura në shtojcën II.
3. Zbatimi i kësaj direktive i nënshtrohet nenin 346 të TFBE-së.
4. Marrëveshjet, vendimet ose instrumente të tjera ligjore që organizojnë transferimin e kompetencave dhe përgjegjësiive për zbatimin e detyrave publike ndërmjet autoriteteve kontraktore ose subjekteve kontraktore ose grupimeve të autoriteteve kontraktore ose subjekteve kontraktore dhe të cilat nuk parashikojnë dhënien e shpërblimit për realizimin e kontratës konsiderohen se janë çështje e organizimit të brendshëm të shtetit anëtar në fjalë dhe si të tilla nuk preken në asnjë mënyrë nga kjo direktivë.

Neni 2

**Parimi i lirisë së administrimit nga autoritetet publike**

1. Kjo direktivë njeh parimin e lirisë së administrimit nga autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale, në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe të drejtën e Bashkimit Evropian. Këto autoritete janë të lira të vendosin për mënyrën më të mirë për të menaxhuar kryerjen e punëve ose ofrimin e shërbimeve, për të garantuar në veçanti një nivel të lartë cilësie, sigurie dhe kosto-efektiviteti, trajtim të barabartë dhe promovimin e qasjes universale dhe të të drejtave të përdoruesit në shërbimet publike.

Këto autoritete mund të zgjedhin të kryejnë detyrat e tyre me interes publik me burimet e veta ose në bashkëpunim me autoritete të tjera, ose t'ia delegojnë ato operatorëve ekonomikë.

2. Kjo direktivë nuk ndikon në sistemin e shteteve anëtare për pronësinë. Në veçanti ajo nuk kërkon privatizimin e ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbime për publikun.

### Neni 3

#### **Parimi i trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës**

1. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore i trajtojnë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe veprojnë me transparencë dhe në mënyrë proporcionale.

Hartimi i procedurës për dhënien e koncesionit, duke përfshirë parashikimin e vlerës, nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të kësaj direktive ose për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar ose punë, furnizime ose shërbime të caktuara.

2. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore synojnë të garantojnë transparencën e procedurës së prokurimit dhe të zbatimit të kontratës, ndërkohë që veprojnë në pajtim me nenin 28.

### Neni 4

#### **Liria për të përcaktuar shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik**

1. Kjo direktivë nuk prek lirinë e shteteve anëtare për të përcaktuar, në pajtim me të drejtën e Bashkimit Evropian, se çfarë ata konsiderojnë si shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik, si duhet të organizohen dhe të financohen këto shërbime në përputhje me rregullat për ndihmë nga shteti dhe cilave detyrime specifike duhet t'u nënshtrohen ato. Po ashtu, kjo direktivë nuk ndikon në mënyrën sesi shtetet anëtare organizojnë sistemin e tyre të sigurimeve shoqërore.

2. Shërbimet joekonomike me interes të përgjithshëm nuk përfshihen në fushën e zbatimit të kësaj direktive.

### Neni 5

#### **Përkufizime**

Për qëllime të kësaj direktive përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. "koncesione" janë koncesionet e punëve ose shërbimeve, të përkufizuara përkatësisht në germa a dhe b:

a) "koncesion i punëve" është një kontratë me interes financiar, e lidhur me shkrim, me anë të së cilës një ose më shumë autoritete kontraktore ose subjekte kontraktore ia besojnë kryerjen e punëve një ose më shumë operatorëve ekonomikë, ku shpërblimi për punën që duhet të kryhet përbëhet vetëm nga e drejta për të shfrytëzuar veprat që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën;



- b) "koncesion i shërbimeve" është një kontratë me interes financiar, e lidhur me shkrim, me anë të së cilës një ose më shumë autoritete kontraktore ose subjekte kontraktore ia besojnë ofrimin dhe menaxhimin e shërbimeve, të ndryshme nga kryerja e punëve, që përmenden në germën a, një ose më shumë operatorëve ekonomikë, ku shpërblimi për shërbimet që do të sigurohen përbëhet vetëm nga e drejta për të shfrytëzuar shërbimet që janë objekt i kontratës ose nga kjo e drejtë së bashku me pagesën.

Dhënia e koncesionit të punëve ose shërbimeve përfshin transferimin të koncesionari të një rreziku operacional për shfrytëzimin e atyre punëve ose shërbimeve, që përfshin rrezikun e ofertës ose të kërkesës, ose të dyja bashkë. Koncesionari konsiderohet se ka marrë përsipër rrezikun operacional kur, në zbatim të kushteve operationale normale, nuk është garantuar kthimi i investimeve të bëra ose mbulimi i kostove që kanë rezultuar nga shfrytëzimi i punëve ose shërbimeve që janë objekt i koncesionit. Pjesa e rrezikut që i transferohet koncesionarit duhet të përfshijë ekspozimin real ndaj luhatjeve të tregut, në mënyrë të tillë që çdo humbje e mundshme e përlogaritur që pëson koncesionari të mos jetë thjesht nominale ose e papërfillshme;

2. "operator ekonomik" është çdo person fizik, juridik apo ent publik, ose një grup i këtyre personave ose subjekteve, duke përfshirë organizime të përkohshme të sipërmarrjeve, që ofrojnë në treg realizimin e një ose disa punëve, furnizimin me mallra ose shërbime;
3. "kandidat" është një operator ekonomik që ka kërkuar një ftesë ose është ftuar të marrë pjesë në procedurën për dhënien e koncesionit;
4. "ofertues" është një operator ekonomik që ka paraqitur një ofertë;
5. "koncesionar" është një operator ekonomik që është shpallur fitues i koncesionit;
6. "E shkruar" ose "me shkrim" është çdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen më pas, duke përfshirë informacionet që transmetohen ose ruhen nëpërmjet mjeteve elektronike;
7. "realizimi i punëve" është realizimi, ose projektimi dhe realizimi, i një pune ose i disa punëve që lidhen me një nga veprimtaritë e përmendura në shtojcën I ose realizimi me anë të çdo mjeti i një pune që përkon me kërkesat e specifikuara nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor që ushtron një ndikim vendimtar në llojin ose projektimin e punës;
8. "punë" është rezultati i ndërtimit ose veprave civile inxhinierike, të marra së bashku, i cili është i mjaftueshëm në vetvete për të përmbushur një funksion ekonomik ose teknik;
9. "Mjete elektronike" janë pajisjet elektronike për përpunimin dhe ruajtjen (duke përfshirë përpunimin digjital) e të dhënave që transmetohen, jepen dhe merren përmes kablllove, radios, mjeteve optike ose çdo mjeti tjetër elektromagnetik;

10. "e drejtë ekskluzive" është një e drejtë që jepet nga një autoritet kompetent i shtetit anëtar në zbatim të çdo ligji, rregulloreje ose dispozite administrative të publikuar, që është në pajtim me traktatet, objekti i të cilëve është të kufizojë ushtrimin e një veprimtarie vetëm për një operator ekonomik dhe që ndikon në mënyrë të ndjeshme në aftësinë e operatorëve të tjerë ekonomikë për ta kryer këtë veprimtari;
11. "e drejtë e veçantë" është një e drejtë që jepet nga një autoritet kompetent i shtetit anëtar në zbatim të çdo ligji, rregulloreje ose dispozite administrative të publikuar që është në pajtim me traktatet, objekti i të cilëve është të kufizojë ushtrimin e një veprimtarie për dy ose më shumë operatorë ekonomikë dhe që ndikon në mënyrë të ndjeshme në aftësinë e operatorëve të tjerë ekonomikë për ta kryer këtë veprimtari;
12. "dokument koncesioni" është çdo dokument i prodhuar ose i përmendur nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor për të përshkruar ose përcaktuar elementet e koncesionit ose të procedurës, duke përfshirë njoftimin e kontratës së koncesionit, kërkesat teknike dhe funksionale, kushtet e propozuara të koncesionit, formatet për prezantimin e dokumenteve nga kandidatët dhe ofertuesit, informacionin për detyrimet e përgjithshme të zbatueshme dhe çdo dokument shtesë;
13. "novacion" është implementimi i një produkti, shërbimi ose procesi të ri ose të përmirësuar ndjeshëm, duke përfshirë por pa u kufizuar me proceset e prodhimit, ndërtimit ose strukturimit të një metode të re tregtimi ose një metode të re organizative në praktikat e punës, organizimin e vendit të punës ose marrëdhëniet me jashtë, ndër të tjera, me qëllim për të ndihmuar në zgjidhjen e sfidave të shoqërisë ose në mbështetje të strategjisë Evropa 2020.

## Neni 6

### **Autoritetet kontraktore**

1. Për qëllime të kësaj direktive "autoritete kontraktore" janë autoritete shtetërore, rajonale ose lokale, organe që rregullohen nga e drejta publike ose organizata të formuara nga një ose disa nga këto autoritete apo nga një ose disa nga këto organe publike, përveç atyre autoriteteve, organeve ose organizatave që kryejnë një nga veprimtaritë e përmendura në shtojcën II dhe japin një koncesion për kryerjen e njëres prej këtyre veprimtarive.
2. "Autoritete rajonale" përfshijnë të gjitha autoritetet e njësive administrative të radhitura në listën joshteruese të NUTS 1 dhe 2, siç përmenden në Rregulloren (KE) nr. 1059/2003 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(20)</sup>.
3. "Autoritete lokale" përfshijnë të gjitha autoritetet e njësive administrative që përfshihen në NUTS 3 dhe të gjitha njësitë administrative më të vogla, që përmenden në Rregulloren (KE) nr. 1059/2003.
4. "Organe që rregullohen nga e drejta publike" janë organet që kanë të gjitha karakteristikat e mëposhtme:

- a) janë krijuar për qëllimin specifik të përmbushjes së nevojave në interesin e përgjithshëm, që nuk kanë karakter industrial ose tregtar;
- b) kanë personalitet juridik; dhe
- c) financohen, kryesisht, nga shteti ose autoritetet lokale ose rajonale, ose organe të tjera që rregullohen nga e drejta publike; ose i nënshtrohet mbikëqyrjes administrative të këtyre organeve ose autoriteteve; ose kanë një bord administrativ, drejtues ose mbikëqyrës, më shumë se gjysma e anëtarëve të të cilit emërohen nga shteti, autoritetet rajonale ose lokale ose nga organe të tjera që rregullohen nga e drejta publike.

## Neni 7

### **Subjektet kontraktore**

1. Për qëllime të kësaj direktive "subjekte kontraktore" janë subjekte të cilët kryejnë një nga veprimtaritë e përmendura në shtojcën II dhe japin koncesione për ndjekjen e njëjës prej këtyre veprimtarive dhe që janë një nga subjektet e mëposhtme:
  - a) Autoritete shtetërore, rajonale ose lokale, organe që rregullohen nga e drejta publike ose organizata të formuara nga një ose më shumë autoritete të tilla ose një ose më shumë organe të tilla që rregullohen nga e drejta publike;
  - b) sipërmarrjet publike, sipas përkufizimit që u jepet në paragrafin 4 të këtij neni;
  - c) subjektet e ndryshme nga ato që përmenden në germën a dhe b të këtij paragrafi, por që ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbi bazën e të drejtave të veçanta ose ekskluzive, të dhëna për ushtrimin e njëjës prej veprimtarive, të përmendura në shtojcën II.
2. Subjektet, të cilave u janë dhënë të drejta të veçanta ose ekskluzive, me anë të një procedure ku është garantuar publiciteti i përshtatshëm dhe ku dhënia e këtyre të drejtave është bazuar mbi kriteret objektive, nuk përbëjnë "subjekte kontraktore" sipas kuptimit të germës c të paragrafit 1. Këto procedura përfshijnë:
  - a) procedurat e prokurimit me një ftesë paraprake për konkurrim, në pajtim me Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(21)</sup> dhe me Direktivën 2014/25/BE, Direktivën 2009/81/KE ose me këtë direktivë;
  - b) procedurat në zbatim të akteve të tjera ligjore të Bashkimit Evropian të radhitura në shtojcën II, të cilat garantojnë transparencë paraprake të përshtatshme për dhënien e autorizimeve mbi bazën e kriterëve objektive.
3. Komisioni merr kompetencat për të miratuar aktet e deleguara në përputhje me nenin 48, në lidhje me ndryshimet në listën e akteve ligjore të Bashkimit Evropian të përcaktuar në shtojcën III,

kur është e nevojshme, për shkak të shfuqizimit ose ndryshimit të atyre akteve, ose për shkak të miratimit të akteve të reja.

4. "Sipërmarrje publike" është çdo sipërmarrje, mbi të cilën autoritetet kontraktore mund të ushtrojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një ndikim dominues, për shkak të pronësisë që kanë mbi të, pjesëmarrjes së tyre financiare në të ose nëpërmjet rregullave që i rregullojnë atë.

Ndikim dominues nga ana e autoriteteve kontraktore konsiderohet secili nga rastet e mëposhtme, ku autoritetet kontraktore, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë:

- a) zotërojnë shumicën e kapitalit të nënshkruar të sipërmarrjes,
- b) kontrollojnë shumicën e votave që lidhen me aksionet e emetuara nga sipërmarrja;
- c) mund të emërojnë më shumë se gjysmën e organeve administrative, menaxheriale ose mbikëqyrëse të sipërmarrjes.

## Neni 8

### **Kufiri monetar dhe metodat për të llogaritur vlerën e parashikuar të koncesioneve**

1. Kjo direktivë zbatohet për koncesionet vlera e të cilëve është e barabartë me ose më e madhe se 5 186 000 euro.

2. Vlera e një koncesioni është xhiroja e përgjithshme e koncesionarit, pa TVSH, e gjeneruar përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, e llogaritur nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor në lidhje me punët dhe shërbimet, që janë objekt i koncesionit, si edhe me furnizimet plotësuese për këto punë dhe shërbime.

Ky vlerësim është i vlefshëm në momentin kur dërgohet njoftimi i kontratës së koncesionit, ose, për rastet kur ky njoftim nuk është dhënë, në momentin kur autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor nis procedurën për dhënien e koncesionit, për shembull duke kontaktuar operatorët ekonomikë në lidhje me koncesionet.

Për qëllimin e paragrafit 1, nëse vlera e koncesionit në kohën e dhënies së tij është mbi 20% më e lartë se vlera e tij e parashikuar, parashikimi i vlefshëm është vlera e koncesionit në kohën e dhënies së tij.

3. Vlera e parashikuar e koncesionit llogaritet duke përdorur një metodë objektive të specifikuar në dokumentet e koncesionit. Gjatë llogaritjes së vlerës së koncesionit, autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore, aty ku është e zbatueshme, marrin në konsideratë veçanërisht:

- a) vlerën e çdo forme opsioni dhe çdo shtyrjeje të kohëzgjatjes së koncesionit;
- b) të ardhurat nga pagesa e tarifave dhe gjobave nga përdoruesit e punëve ose shërbimeve, të ndryshme nga ato që mblidhen në emër të autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor;

- c) pagesat ose çdo avantazh financiar të çfarëdo lloj forme, të bëra nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor ose ndonjë autoritet tjetër publik për koncesionarin, duke përfshirë shpërblimin për pajtueshmëri me detyrimin për një shërbim publik dhe subvencionet për investim publik;
  - d) vlera e granteve ose çdo avantazh tjetër financiar, i çfarëdo lloj forme, nga palë të treta për realizimin e koncesionit;
  - e) të ardhurat nga shitjet e çdo aseti, që është pjesë e koncesionit;
  - f) vlera e të gjitha furnizimeve dhe shërbimeve që vihen në dispozicion të koncesionarit nga autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore, me kusht që ato të nevojiten për kryerjen e punëve ose për ofrimin e shërbimeve;
  - g) çdo çmim ose pagesë për kandidatët ose ofertuesit.
4. Përzgjedhja e metodës së përdorur për përllogaritjen e vlerës së koncesionit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të kësaj direktive. Koncesioni nuk duhet të ndahet me qëllim shmangien nga fusha e zbatimit e kësaj direktive, përveçse kur kjo justifikohet nga arsye objektive.
5. Kur një punë ose shërbim i propozuar mund të rezultojë në prokurimin e disa koncesioneve në formën e loteve të veçanta, duhet të merret parasysh vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve.
6. Kur vlera e agreguar e loteve është e barabartë ose e tejkalon kufirin monetar të përcaktuar këtë nen, atëherë kjo direktivë zbatohet për prokurimin e secilit lot.

## Neni 9

### **Rishikimi i kufirit monetar**

1. Çdo vit duke nisur nga data 30 qershor 2013, Komisioni verifikon nëse kufiri monetar i përcaktuar në nenin 8, paragrafi 1 përkon me kufirin monetar të përcaktuar në Marrëveshjen për Prokurimin Qeveritar ("GPA") të Organizatës Botërore të Tregtisë për koncesionet e punëve dhe, aty ku është e nevojshme, e rishikon këtë kufi monetar në përputhje me këtë nen.

Në përputhje me metodën e llogaritjes të përcaktuar në GPA, Komisioni llogarit vlerën e kufirit monetar mbi bazën e vlerës ditore mesatare të euros, në lidhje me të drejtat e veçanta të tërheqjes (SDR) përgjatë një periudhe prej 24 muajsh që përfundon më datën 31 gusht e i paraprin rishikimit që nis nga data 1 janar. Ndaj vlera e kufirit monetar të rishikuar, aty ku është e nevojshme, do të rumbullakoset në mijë euro për të garantuar që kufiri monetar në fuqi, i parashikuar nga GPA-ja, i shprehur në SDR, të respektohet.

2. Çdo dy vjet që nga data 1 janar 2014, Komisioni do të përcaktojë vlerat, në monedhat kombëtare të shteteve anëtare, monedha e të cilëve nuk është euro, e kufirit monetar të përmendur në nenin 8, paragrafi 1, të rishikuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Në përputhje me metodën e llogaritjes të përcaktuar në GPA, përcaktimi i këtyre vlerave bazohet në vlerat ditore mesatare të atyre monedhave, të cilat korrespondojnë me kufirin monetar të zbatueshëm të shprehur në euro, përgjatë 24 muajve që përfundojnë më datën 31 gusht që paraprin rishikimin, i cili hyn në fuqi nga data 1 janar.

3. Komisioni shpall kufirin monetar të rishikuar, që përmendet në paragrafin 1, vlerën e tij përkatëse në monedhën vendase, që përmendet në nënparagrafin e parë të paragrafit 2, vlerën e përcaktuar në përputhje me nënparagrafin e dytë të paragrafit 2, në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*, në fillim të muajit nëntor që pason rishikimin e tyre.

4. Komisioni ka autoritetin që të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 48 për të përshtatur metodologjinë e përcaktuar në nënparagrafin e dytë të paragrafit 1 të këtij neni me çdo ndryshim në metodologjinë e parashikuar në GPA, për rishikimin e kufirit monetar të përmendur në nenin 8, paragrafi 1 dhe për përcaktimin e vlerave përkatëse në monedhat vendase të shteteve anëtare, monedha e të cilëve nuk është euro, siç përmendet në paragrafin 2 të këtij neni.

Komisioni gjithashtu ka autoritetin të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 48 për të rishikuar kufirin monetar të përmendur në nenin 8, paragrafi 1 sipas paragrafit 1 të këtij neni.

5. Aty ku është e nevojshme që ky kufi monetar të rishikohet dhe kufizimet kohore pengojnë përdorimin e procedurës së përcaktuar në nenin 48 dhe kur kërkohet për arsye emergjence, procedura e parashikuar në nenin 49 zbatohet për aktet e deleguara, të miratuara sipas nënparagrafit të dytë të paragrafit 4 të këtij neni.

## **Seksioni II Përfundim**

### **Neni 10**

#### **Përfundim që zbatohen për koncesionet që jepen nga autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore**

1. Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet e shërbimeve që i jepen një autoriteti kontraktor ose një subjekti kontraktor siç përmendet në germën a të nenit 7, paragrafi 1 ose një organizate të këtyre autoriteteve ose subjekteve, mbi bazën e një të drejte ekskluzive.

Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet e shërbimeve që i jepen një operatori ekonomik, mbi bazën e një të drejte ekskluzive, e cila është dhënë në përputhje me TFBE-në dhe aktet ligjore të Bashkimit Evropian, që përcaktojnë rregullat e përbashkëta për hyrjen në treg, të cilat zbatohen për veprimtaritë e përmendura në shtojcën II.

2. Duke deroguar nga nënparagrafi i dytë i paragrafit 1 të këtij neni, ku legjislacioni sektorial i Bashkimit Evropian, që përmendet në atë nënparagraf, nuk parashikon detyrime për transparencën specifike për sektorin, zbatohet neni 32.

Kur një shtet anëtar i jep një operatori ekonomik një të drejtë ekskluzive për ushtrimin e një prej veprimtarive të përmendura në shtojcën II, ai informon Komisionin për këtë brenda një muaji pas dhënies së asaj të drejte ekskluzive.

3. Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet e shërbimeve të transportit ajror që bazohen në dhënien e një të drejte për ushtrim veprimtarie, sipas kuptimit të Rregullores (KE) nr. 1008/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(22)</sup> ose për koncesionet për shërbimet e transportit publik të pasagjerëve, sipas kuptimit të Rregullores (KE) nr. 1370/2007.

4. Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesione të cilat autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor është i detyruar të japë ose të organizojë në përputhje me procedura të ndryshme nga ato që përcaktohen në këtë direktivë, të cilat përcaktohen nga një prej instrumenteve të mëposhtme:

- a) një instrument ligjor që krijon detyrime sipas të drejtës ndërkombëtare, si një marrëveshjeje ndërkombëtare të lidhur në përputhje me TFBE-në, midis një shteti anëtar dhe një ose më shumë vendeve të treta dhe nënndarje të tyre, që mbulojnë punët, furnizimet ose shërbimet që janë krijuar për zbatimin ose shfrytëzimin e përbashkët të një projekti nga shtetet nënshkruese;
- b) një organizatë ndërkombëtare.

Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesione të cilat autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor i jep në përputhje me rregullat e prokurimit të parashikuara nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, kur koncesionet në fjalë financohen plotësisht nga ajo organizatë ose ai institucion. Në rastin e koncesioneve, shumica e të cilëve bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar, palët bien dakord për procedurat e zbatueshme të prokurimit.

Shtetet anëtare i komunikojmë të gjithë instrumentet ligjore, të përmendur në germën a të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi, Komisionit, i cili mund të konsultohet me Komitetin Këshillimor për Prokurimet Publike që përmendet në nenin 50.

Ky paragraf nuk zbatohet për prokurimet në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, siç përmenden në Direktivën 2009/81/KE.

5. Kjo direktivë nuk zbatohet për prokurimet në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, siç përmenden në Direktivën 2009/81/KE, të cilat rregullohen nga:

- a) rregulla procedurale specifike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare ose marrëveshjeje të lidhur midis një ose më shumë shteteve anëtare dhe një ose më shumë shteteve të treta;
- b) rregulla procedurale specifike, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare ose marrëveshjes për stacionimin e trupave dhe për angazhimet e një shteti anëtar ose një vendi të tretë;
- c) rregulla procedurale specifike të organizatës ndërkombëtare, që bën blerje për qëllime të vetat, ose koncesione që duhet të jepen nga një shtet anëtar në përputhje me këto rregulla.

6. Kjo direktivë nuk zbatohet për dhënien e koncesioneve në fushat e mbrojtjes dhe sigurisë, siç përmenden në Direktivën 2009/81/KE, me përjashtim të sa më poshtë:

- a) koncesionet për të cilat zbatimi i kësaj direktive do të detyronte një shtet anëtar që të jepte informacione, publikimin e të cilave ai e konsideron se bie ndesh me interesat thelbësore të

sigurisë së tij; ose kur prokurimi dhe zbatimi i koncesionit deklarohen se janë sekret ose duhet të shoqërohen nga masa të veçanta sigurie në përputhje me ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative në fuqi në një shtet anëtar, me kusht që shteti anëtar të ketë përcaktuar se këto interesa thelbësore nuk mund të garantohen nga masa më pak shtrënguese, siç janë ato që përmenden në paragrafin 7;

- b) koncesionet që jepen në kuadër të një programi bashkëpunimi, që përmendet në germën c të nenit 13 të Direktivës 2009/81/KE;
- c) koncesionet që jepen nga një qeveri për një qeveri tjetër, në lidhje me punët dhe shërbimet që lidhen drejtpërsëdrejti me pajisjet ushtarake ose pajisje sensitive, ose punët dhe shërbimet që janë specifikisht për qëllime ushtarake, ose punë sensitive dhe shërbime sensitive;
- d) koncesione që i jepen një vendi të tretë, të kryera kur forcat janë të dislokuara jashtë territorit të Bashkimit Evropian, kur nevojat operationale bëjnë të detyrueshme lidhjen e tyre me operatorë ekonomikë të vendosur në zonën e operationeve; dhe
- e) koncesionet që përjashtohen nga zbatimi i kësaj direktive për arsye të tjera.

7. Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet që nuk përjashtohen në zbatim të paragrafit 6, nëse mbrojtja e interesave thelbësore të sigurisë së një shteti anëtar nuk mund të garantohet nga masa më pak shtrënguese, për shembull, duke vendosur kërkesa që synojnë mbrojtjen e natyrës konfidenciale të informacionit, që autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor vë në dispozicion gjatë procedurës për dhënien e koncesionit, siç parashikohet nga kjo direktivë.

8. Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet e shërbimeve:

- a) blerjen ose marrjen me qira, me çfarëdo mjeti financiar, të tokës, ndërtesave ekzistuese ose pronave të tjera të paluajtshme, ose për të drejtat mbi to;
- b) blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e materialit të programit të synuar për shërbime të medias audiovizive ose shërbime të medias radiofonike që jepen nga ofruesit e shërbimit të medias audiovizive ose medias radiofonike ose koncesionet për kohën e transmetimit ose ofrimin e programit, që u jepen ofruesve të shërbimit të medias audiovizive ose radiofonike. Për qëllimet e kësaj pike, "shërbime të medias audiovizive" dhe "ofrues të shërbimit mediatik" kanë përkatësisht të njëjtin kuptim si në germen a dhe d të nenit 1, paragrafi 1 të Direktivës 2010/13/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(23)</sup>. "Program" ka të njëjtin kuptim si në germën b të nenit 1 paragrafi 1 të asaj direktive, por gjithashtu përfshin programet radiofonike dhe materialet e programeve radiofonike. Gjithashtu, për qëllimet e kësaj dispozite, "material për programin" ka të njëjtin kuptim si "program";
- c) shërbime arbitrazhi dhe pajtimi;
- d) një nga shërbimet ligjore të mëposhtme:



- i) përfaqësimi ligjor i një klienti nga një avokat, sipas kuptimit të nenit 1 të Direktivës së Këshillit 77/249/KEE <sup>(24)</sup> në:
- seancë arbitrazhi ose pajtim që mbahet në një shtet anëtar, në një shtet të tretë ose përpara një organi ndërkombëtar arbitrazhi ose pajtimi, ose
  - procedime gjyqësore përpara gjykatave, trupave gjykues ose autoriteteve publike të një shteti anëtar ose një vendi të tretë ose përpara gjykatave, trupave gjykues ose institucioneve ndërkombëtare;
- ii) konsulenca ligjore që jepet në përgatitje të njërit prej procedimeve të përmendur në pikën i) të kësaj pike ose kur ka një tregues të qartë dhe shumë mundësi që çështja me të cilën lidhet konsulenca të bëhet objekti i këtyre procedimeve, me kusht që konsulenca të jepet nga një avokat sipas kuptimit të nenit 1 të direktivës 77/249/KEE;
- iii) shërbime për noterizim dhe njehsim dokumentesh me origjinalin që duhet të ofrohen nga noterët;
- iv) shërbime ligjore që ofrohen nga administratorë ose kujdestarë të emëruar ose shërbime të tjera ligjore, ofruesit e të cilave emërohen nga një gjykatë ose trup gjykues në shtetin anëtar në fjalë ose emërohen me ligj për të kryer detyra specifike nën mbikëqyrjen e këtyre trupave gjykues ose gjykatave;
- v) shërbime të tjera ligjore të cilat në shtetin anëtar në fjalë lidhen, qoftë edhe rastësisht, me ushtrimin e autoritetit zyrtar;
- e) shërbime financiare në lidhje me lëshimin, shitjen, blerjen ose transferimin e letrave me vlerë ose instrumente të tjera financiare, sipas kuptimit të Direktivës 2004/39/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit <sup>(25)</sup>, shërbime të bankës qendrore dhe operacionet që kryhen me Instrumentin Evropian të Stabilitetit Financiar dhe Mekanizmin Evropian të Stabilitetit;
- f) kreditë, të lidhura ose jo me emetimin, shitjen, blerjen ose transferimin e letrave me vlerë ose instrumenteve të tjera financiare.
- g) shërbime të mbrojtjes, të mbrojtjes civile dhe të parandalimit të rrezikut që ofrohen nga organizata ose shoqata jofitimprurëse dhe që mbulohen nga kodet e FPP-së. 75250000-3, 75251000-0, 75251100-1, 75251110-4, 75251120-7, 75252000-7, 75222000-8, 98113100-9 dhe 85143000-3, përveç shërbimeve të transportit të pacientit me ambulancë;
- h) shërbime të fushatës politike, që mbulohen nga kodet e FPP-së 79341400-0, 92111230-3 dhe 92111240-6, kur jepen nga një parti politike në kontekstin e një fushate zgjedhore.
9. Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet e shërbimeve për shërbime lotarie, që mbulohen nga kodi i FPP-së 92351100-7, që jepen nga një shtet anëtar për një operator ekonomik mbi bazën

e një të drejte ekskluzive. Për qëllime të këtij paragrafi, koncepti i së drejtës ekskluzive nuk mbulon të drejtat ekskluzive që përmenden në nenin 7, paragrafi 2.

Dhënia e kësaj të drejte ekskluzive i nënshtrohet botimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

10. Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet që jepen nga subjektet kontraktore për ndjekjen e veprimtarive të tyre në një vend të tretë, në kushte që nuk përfshijnë përdorimin fizik të një rrjeti ose zone gjeografike brenda Bashkimit Evropian.

#### Neni 11

##### **Përjashtime specifike në fushën e komunikimeve elektronike**

Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesione që kanë si qëllim kryesor lejimin e autoriteteve kontraktore që të ofrojnë ose të shfrytëzojnë rrjetet publike të komunikimit ose që t'i ofrojnë publikut një ose më shumë shërbime të komunikimeve elektronike.

Për qëllimet e këtij neni "rrjet i komunikimeve publike" dhe "shërbim i komunikimeve elektronike" kanë të njëjtin kuptim si në Direktivën 2002/21/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(26)</sup>.

#### Neni 12

##### **Përjashtime specifike në fushën e ujit**

1. Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet që jepen për:

- a) ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut shërbime për prodhimin, transportin a shpërndarjen e ujit të pijshëm;
- b) furnizimin me ujë të pijshëm të këtyre rrjeteve.

2. Kjo direktivë nuk zbatohet as për koncesionet që kanë njërin ose të dy objektet e mëposhtme, kur ato kanë lidhje me veprimtarinë e përmendur në paragrafin 1:

- a) projekte të inxhinierisë hidraulike, ujitjes ose drenazhimit të tokës me kusht që vëllimi i ujit që do të përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të përbëjë më shumë se 20% të vëllimit të përgjithshëm të ujit të vënë në dispozicion nga këto projekte ose nga infrastruktura ujitëse ose drenazhuese; ose
- b) asgjësimin ose trajtimin e ujërave të zeza.

#### Neni 13

##### **Koncesionet që i jepen një sipërmarrjeje të lidhur**

1. Për qëllimet e këtij neni "sipërmarrje e lidhur" është një sipërmarrje, llogaritë vjetore të së cilës janë të konsoliduara me ato të subjektit kontraktor, në përputhje me kërkesat e Direktivës 2013/34/BE.

2. Në rastin e subjekteve që nuk i nënshtrohen Direktivës 2013/34/BE "sipërmarrje e lidhur" është çdo sipërmarrje:

- a) mbi të cilën subjekti kontraktor mund të ushtrojë, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, ndikimit dominues;
- b) e cila mund të ushtrojë një ndikim dominues mbi subjektin kontraktor; ose
- c) e cila në bashkëpunim me subjektin kontraktor, i nënshtrohet ndikimit dominues të një sipërmarrjeje tjetër si rrjedhojë e pronësisë, pjesëmarrjes financiare ose e rregullave që e rregullojnë atë.

Për qëllimet e këtij paragrafi, "ndikim dominues" ka të njëjtin kuptim si në nënparagrafin e dytë të nenit 7, paragrafi 4.

3. Pavarësisht nenit 17 dhe nëse përmbushen kushtet e paragrafit 4 të këtij neni, kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet që jepen:

- a) nga një subjekt kontraktor për një sipërmarrje të lidhur, ose
- b) nga një sipërmarrje e përbashkët, e krijuar ekskluzivisht nga disa subjekte kontraktore, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të përmendura në shtojcën II, për një sipërmarrje që është e lidhur me një prej këtyre subjekteve kontraktore.

4. Paragrafi 3 zbatohet për:

- a) koncesionet e shërbimeve, nëse të paktën 80% e xhiros mesatare të sipërmarrjes së lidhur gjatë tre viteve të fundit, duke marrë në konsideratë të gjithë shërbimet e ofruara nga ajo sipërmarrje, vjen si rezultat i ofrimit të shërbimeve për subjektin kontraktor ose sipërmarrje të tjera me të cilat ajo është e lidhur;
- b) koncesionet e punëve, nëse të paktën 80% e xhiros mesatare të sipërmarrjes së lidhur, gjatë tre viteve të fundit, duke marrë në konsideratë të gjithë punët e ofruara nga ajo sipërmarrje, vjen si rezultat i ofrimit të punëve për subjektin kontraktor ose sipërmarrje të tjera me të cilat ajo ka lidhje;

5. Kur, për shkak të datës në të cilën është krijuar ose ka nisur veprimtarinë një sipërmarrje e lidhur, xhiroja nuk është e disponueshëm për tre vitet e fundit, mjafton që kjo sipërmarrje të tregojë se xhiroja e përmendur në germa a ose b të paragrafit 4 është e besueshme, sidomos nëpërmjet parashikimeve të bëra për të ardhmen e biznesit.

6. Në rastin kur një sipërmarrje e lidhur e subjektit kontraktor, me të cilin ato formojnë një grup ekonomik, ofron shërbime ose punë të njëjta ose të ngjashme, përqindjet, që përmenden në

paragrafin 4, llogariten duke pasur parasysh xhiron totale të krijuar përkatësisht nga ofrimi i shërbimeve ose punëve nga këto sipërmarrje të lidhura.

#### Neni 14

##### **Koncesionet që u jepen sipërmarrjeve të përbashkëta ose një subjekti kontraktor që është pjesë e një sipërmarrjeje të përbashkët**

Pavarësisht nenit 17 dhe nëse ndërmarrja e përbashkët është krijuar me qëllim për të kryer veprimtarinë në fjalë përgjatë një periudhe prej të paktën tre vjetësh dhe nëse instrumenti mbi të cilin krijohet ndërmarrja e përbashkët parashikon që subjektet kontraktore, që e përbëjnë atë, të jenë pjesë e saj të paktën për të njëjtën periudhë, kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet e dhëna nga një prej organeve të mëposhtme:

- a) nga një sipërmarrje e përbashkët, e krijuar ekskluzivisht nga disa subjekte kontraktore, me qëllim kryerjen e veprimtarive të përmendura në shtojcën II, për njërin prej këtyre subjekteve kontraktore; ose
- b) nga një subjekt kontraktor për një ndërmarrje të përbashkët, pjesë e së cilës ai është.

#### Neni 15

##### **Njoftimi i informacionit nga subjektet kontraktore**

Subjektet kontraktore informojnë Komisionin, nëse u kërkohet, për informacionet e mëposhtme në lidhje me zbatimin e nenit 13, paragrafi 2 dhe 3 dhe nenit 14:

- a) emrat e sipërmarrjeve ose ndërmarrjeve të përbashkëta në fjalë;
- b) natyrën dhe vlerën e koncesioneve të përfshira;
- c) provat që mund të konsiderohen të nevojshme nga Komisioni për të vërtetuar që marrëdhënia midis sipërmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët të cilës i janë dhënë kontratat dhe subjektit kontraktor i plotëson kërkesat e nenit 13 ose nenit 14.

#### Neni 16

##### **Përfshirja e veprimtarive të ekspozuara drejtpërsëdrejti ndaj konkurrencës**

Kjo direktivë nuk zbatohet për koncesionet që jepen nga subjektet kontraktore për rastet kur, për shtetin anëtar në të cilin do të zbatohen këto koncesione, në zbatim të nenit 35 të Direktivës 2014/25/BE, është përcaktuar që veprimtaria është ekspozuar drejtpërsëdrejti ndaj konkurrencës në përputhje me nenin 34 të asaj direktive.

#### Neni 17

## **Koncesionet ndërmjet subjekteve në sektorin publik**

1. Një koncesion i dhënë nga një autoritet kontraktor ose nga një subjekt kontraktor, siç përmendet në germën a të nenit 7, paragrafi 1 për një person juridik dhe që rregullohet nga e drejta private ose publike nuk përfshihet në fushën e zbatimit të kësaj direktive, kur janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) autoriteti kontraktor ose subjekt kontraktor ushtron mbi personin juridik në fjalë një kontroll që është i ngjashëm me atë që ai ushtron mbi departamentet e veta;
- b) më shumë se 80% e veprimtarive të personit juridik të kontrolluar kryhen për zbatimin e detyrave që i janë besuar atij nga autoriteti kontraktor ose subjekt kontraktor kontrollues ose nga persona juridikë të tjerë që kontrollohen nga ai autoritet kontraktor ose subjekt kontraktor; dhe
- c) nuk ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë me kapital privat në personin juridik të kontrolluar, me përjashtim të formave jokontrolluese dhe joblokuese të pjesëmarrjes në kapitalin privat, siç kërkohet nga dispozitat ligjore të brendshme, në përputhje me traktatet, të cilët nuk ushtrojnë një ndikim vendimtar mbi personin juridik të kontrolluar.

Autoriteti kontraktor ose subjekt kontraktor, i përmendur në germën a të nenit 7, paragrafi 1, konsiderohet se ushtron mbi një person juridik një kontroll të ngjashëm me atë që ai ushtron mbi departamentet e tij, sipas kuptimit të germës a të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi, në rastet kur ai ushtron një ndikim vendimtar si në objektivat strategjike edhe në vendimet e rëndësishme të personit juridik të kontrolluar. Ky kontroll mund të ushtrohet edhe nga një person juridik tjetër, i cili në vetvete kontrollohet në të njëjtën mënyrë nga një autoritet kontraktor ose subjekt kontraktor.

2. Paragrafi 1 gjithashtu zbatohet për rastet kur një person juridik i kontrolluar, i cili është një autoritet kontraktor ose një subjekt kontraktor, siç përmendet në germën a të nenit 7, paragrafi 1, jep një koncesion për autoritetin kontraktor ose subjektin kontraktor kontrollues, ose për një person juridik tjetër që kontrollohet nga i njëjti autoritet kontraktor ose subjekt kontraktor, nëse nuk ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë me kapital privat në personin juridik të cilit i jepet koncesioni, me përjashtim të formave jokontrolluese dhe joblokuese të pjesëmarrjes me kapital privat që kërkohen nga dispozitat e legjislacionit të brendshëm, në pajtim me traktatet, të cilët nuk ushtrojnë një ndikim vendimtar në personin juridik të kontrolluar.

3. Një autoritet kontraktor ose një subjekt kontraktor, i përmendur në germën a të nenit 7, paragrafi 1, që nuk ushtron kontroll, sipas kuptimit të paragrafit 1 të këtij neni, mbi një person juridik që rregullohet nga e drejta private ose publike, gjithsesi, mund të japë një koncesion për këtë person juridik, pa zbatuar këtë direktivë, kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) autoriteti kontraktor ose subjekt kontraktor, i përmendur në germën a të nenit 7, paragrafi 1, së bashku me autoritete kontraktore ose subjekte kontraktore të tjera, ushtrojnë mbi atë person juridik një kontroll të ngjashëm me atë që ushtrojnë mbi departamentet e tyre;

- b) më shumë se 80% e veprimtarive të atij personit juridik kryhen për zbatimin e detyrave që i janë besuar atij nga autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore kontrolluese ose nga persona juridikë të tjerë, që kontrollohen nga ato autoritete kontraktore ose subjekte kontraktore; dhe
- c) nuk ka pjesëmarrje të drejtpërdrejtë me kapital privat në personin juridik të kontrolluar, me përjashtim të formave jokontrolluese dhe joblokuese të pjesëmarrjes në kapitalin privat, siç kërkohet nga dispozitat ligjore të brendshme, në përputhje me traktatet, të cilët nuk ushtrojnë një ndikim vendimtar mbi personin juridik të kontrolluar.

Për qëllimet e gurmës a të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi, autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore, të përmendura në gurmën a të nenit 7, paragrafi 1, ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi një person juridik, në rastet kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i) organet vendimmarrëse të personit juridik të kontrolluar përbëhen nga përfaqësues nga të gjitha autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore pjesëmarrëse. Përfaqësuesit individualë mund të përfaqësojnë të gjitha autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore pjesëmarrëse ose disa prej tyre;
- ii) këto autoritete kontraktore ose subjekte kontraktore janë në gjendje që bashkërisht të ushtrojnë një ndikim vendimtar mbi objektivat strategjike dhe vendimet e rëndësishme të personit juridik të kontrolluar; dhe
- iii) personi juridik i kontrolluar nuk kërkon të përmbushë asnjë interes që bie ndesh me interesat e autoriteteve kontraktore ose subjekteve kontraktore.

4. Një kontratë e lidhur ekskluzivisht ndërmjet dy ose më shumë autoriteteve kontraktore ose subjekteve kontraktore, të përmendura në gurmën a të nenit 7, paragrafi 1, nuk përfshihet në fushën e zbatimit të kësaj direktive, kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) kontrata vendos ose zbaton një bashkëpunim ndërmjet autoriteteve kontraktore ose subjekteve kontraktore pjesëmarrëse, me qëllim që të garantojë që shërbimet publike që ato duhet të ofrojnë, të ofrohen me qëllimin për të arritur objektivat e përbashkëta që ata kanë;
- b) zbatimi i këtij bashkëpunimi rregullohet vetëm nëpërmjet faktorëve që lidhen me interesin publik; dhe
- c) autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore pjesëmarrëse kryejnë në tregun e hapur më pak se 20% të veprimtarive që lidhen me bashkëpunimin;

5. Për përcaktimin e përqindjes së veprimtarive të përmendura në gurmën b të nënparagrafit të parë të paragrafit 1, gurmën b të nënparagrafit të parë të paragrafit 3 dhe gurmën c të paragrafit 4, merret në konsideratë xhiroja totale mesatare ose një veprimtari alternative e përshtatshme, që bazohet në masa të tilla si kostot që mbulojnë nga personi juridik, autoriteti kontraktor ose subjekti

kontraktor përkatës, të përmendura në germën a të nenit 7, paragrafi 1 në lidhje me shërbimet, furnizimet dhe punët për tre vitet që paraprijnë dhënien e koncesionit.

Kur, për shkak të datës në të cilën personi juridik, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor përkatës është krijuar ose ka filluar veprimtarinë ose për shkak të një riorganizimi të veprimtarive të tij, xhiroja ose një masë e bazuar mbi një veprimtari alternative, siç janë kostot, nuk janë të disponueshme për tre vitet e fundit ose nuk janë më relevante, mjafton që të tregohet se matja e veprimtarisë është e besueshme, në veçanti nëpërmjet projekteve të biznesit.

### **Seksioni III**

#### **Dispozita të përgjithshme**

##### **Neni 18**

#### **Kohëzgjatja e koncesionit**

1. Kohëzgjatja e koncesioneve është e kufizuar. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor përcaktojnë kohëzgjatjen mbi bazën e punëve ose shërbimeve të kërkuara.

2. Për koncesionet që zgjasin më shumë se pesë vjet, kohëzgjatja maksimale e koncesionit nuk tejkalon periudhën kohore brenda së cilës një koncesionar pritët që të realizojë kthimin e arsyeshëm të investimit të bërë për shfrytëzimin e punëve ose shërbimeve, së bashku me kthimin e kapitalit të investuar, duke marrë në konsideratë investimet e nevojshme për arritjen e objektivave kontraktuale specifike.

Investimet e marra në konsideratë për qëllimet e llogaritjes, përfshijnë investimet fillestare dhe investimet gjatë kohëzgjatjes së koncesionit.

##### **Neni 19**

#### **Shërbimet sociale dhe shërbime të tjera specifike**

Koncesionet për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, që radhiten në shtojcën IV dhe që përfshihen në fushën e zbatimit të kësaj direktive, u nënshtrohen vetëm detyrimeve që rrjedhin nga neni 31, paragrafi 3 dhe nenet 32, 46 dhe 47.

##### **Neni 20**

#### **Kontratat e përziera**

1. Koncesionet që kanë si objekt të tyre punët dhe shërbimet, jepen në përputhje me dispozitat e zbatueshme sipas llojit të koncesionit, që karakterizon objektin kryesor të kontratës në fjalë.

Në rastin e koncesioneve të përziera që përbëhen pjesërisht nga shërbime sociale dhe nga shërbime të tjera specifike, që radhiten në shtojcën IV dhe pjesërisht nga shërbime të tjera, objekti kryesor përcaktohet mbi bazën e atij shërbimi që ka vlerën më të lartë, të përlllogaritur.

2. Kur pjesë të ndryshme të një kontrate të caktuar janë objektivisht të ndashme, zbatohen paragrafët 3 dhe 4. Kur pjesë të ndryshme të një kontrate të caktuar janë objektivisht të pandashme, zbatohet paragrafi 5.

Kur një pjesë e një kontrate të caktuar mbulohet nga neni 346, TFBE-ja ose Direktiva 2009/81/KE, zbatohet neni 21 i kësaj direktive.

Në rastin e kontratave të parashikuara për të mbuluar disa veprimtari, kur njëra prej tyre i nënshtrohet ose shtojcës II të kësaj direktive ose Direktivës 2014/25/BE, dispozitat e zbatueshme përcaktohen në përputhje me nenin 22 të kësaj direktive dhe nenin 6 të Direktivës 2014/25/BE, përkatësisht.

3. Në rastin e kontratave që kanë si objekt elemente që mbulohen nga kjo direktivë, si edhe elemente të tjera, autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore mund të zgjedhin të japin kontrata të veçanta për pjesë të veçanta. Kur autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore zgjedhin të japin kontrata të veçanta për pjesë të veçanta, vendimi se cili regjim juridik zbatohet për secilën nga këto kontrata të veçanta, merret mbi bazën e karakteristikave të pjesës së veçantë përkatëse.

Kur autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, përveçse kur parashikohet ndryshe në paragrafin 4 të këtij neni ose në nenin 21, kjo direktivë zbatohet për kryerjen e kontratës së përzier, pavarësisht vlerës së pjesëve që përndryshe do t'i nënshtroheshin një regjimi juridik të ndryshëm dhe pavarësisht regjimit juridik, të cilit këto pjesë do t'i nënshtroheshin në kushte të tjera.

4. Në rastin e kontratave të përziera, që përmbajnë elemente të koncesioneve, si edhe elemente të kontratave publike, që mbulohen nga Direktiva 2014/24/BE ose kontratave që mbulohen nga Direktiva 2014/25/BE, kontrata e përzier prokurohet në përputhje me Direktivën 2014/24/BE ose Direktivën 2014/25/BE, përkatësisht.

5. Kur pjesë të ndryshme të një kontrate të caktuar janë objektivisht të pandashme, regjimi juridik i zbatueshëm përcaktohet mbi bazën e objektit kryesor të asaj kontrate.

Në rastin kur këto kontrata përfshijnë elemente të një koncesioni shërbimesh dhe elemente të një kontrate furnizimesh, objekti kryesor përcaktohet mbi bazën e atij shërbimi ose furnizimi, përkatësisht, që ka vlerën më të lartë, të përlloritur.

## Neni 21

### **Kontratat e prokurimit të përzier, që kanë të bëjnë me aspekte të mbrojtjes ose sigurisë**

1. Në rastin e kontratave të përziera, që kanë si objekt të tyre elemente të një koncesioni që mbulohet nga kjo direktivë dhe elemente prokurimi ose elemente të tjera që mbulohen nga neni 346 i TFBE-së ose Direktiva 2009/81/KE, zbatohet ky nen.

Në rastin e kontratave të parashikuara për të mbuluar disa veprimtari, kur njëra prej tyre i nënshtrohet ose shtojcës II të kësaj direktive ose Direktivës 2014/25/BE, dhe tjetra mbulohet nga



neni 346 i TFBE-së ose Direktiva 2009/81/KE, dispozitat e zbatueshme përcaktohen në përputhje me nenin 23 të kësaj direktive dhe nenin 26 të Direktivës 2014/25/BE, përkatësisht.

2. Kur pjesë të ndryshme të një kontrate të caktuar janë objektivisht të ndashme, autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore mund të zgjedhin të japin kontrata të veçanta për pjesë të veçanta ose të japin një kontratë të vetme.

Kur autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore zgjedhin të japin kontrata të veçanta për pjesë të veçanta, vendimi se cili regjim juridik zbatohet për secilën nga këto kontrata të veçanta, merret mbi bazën e karakteristikave të pjesës së veçantë përkatëse.

Kur autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, për të përcaktuar regjimin juridik të zbatueshëm, zbatohen kriteret e mëposhtme:

- a) kur një pjesë e një kontrate të caktuar mbulohet nga neni 346 i TFBE-së ose pjesë të ndryshme mbulohen përkatësisht nga neni 346 i TFBE-së dhe Direktiva 2009/81/BE, kontrata mund të jepet pa zbatuar këtë direktivë, me kusht që dhënia e një kontrate të vetme të justifikohet me arsye objektive;
- b) kur një pjesë e një kontrate të caktuar mbulohet nga direktiva 2009/81/KE, kontrata mund të jepet në përputhje me këtë direktivë ose në përputhje me direktivën 2009/81/KE, me kusht që prokurimi i një kontrate të vetme të justifikohet me arsye objektive.

Megjithatë, vendimi për të dhënë një kontratë të vetme nuk mund të merret me qëllimin për të përjashtuar kontratat nga zbatimi i kësaj direktive ose i Direktivës 2009/81/KE.

3. Kur pjesë të ndryshe të një kontrate të caktuar janë objektivisht të pandashme, kontrata mund të jepet pa zbatuar këtë direktivë, kur ajo përfshin elemente për të cilat zbatohet neni 346 i TFBE-së. Në të kundërt, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor mund të zgjedhë të japë një kontratë në përputhje me këtë direktivë ose në përputhje me Direktivën 2009/81/KE.

## Neni 22

### **Kontratat që mbulojnë si veprimtaritë e përmendura në shtojcën II ashtu edhe veprimtari të tjera**

1. Duke deroguar nga neni 20, në rastin e kontratave të parashikuara për të mbuluar disa veprimtari, subjektet kontraktore mund të zgjedhin të japin kontrata të veçanta për qëllimet e secilës veprimtari të veçantë ose të japin një kontratë të vetme. Kur subjektet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të veçantë, vendimi për rregullat që zbatohen për secilën nga këto kontrata të veçanta merret mbi bazën e karakteristikave të veprimtarisë së veçantë përkatëse.

Pavarësisht nenit 20, kur subjektet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, zbatohen paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni. Megjithatë, nëse njëra prej veprimtarive për të cilat është përgatitur kontrata, mbulohet nga neni 346 i TFBE-së ose nga Direktiva 2009/81/KE, atëherë zbatohet neni 23 i kësaj direktive.

Zgjedhja midis dhënies së një kontrate të vetme dhe dhënies së disa kontratave të veçanta nuk duhet të bëhet me qëllimin për ta përjashtuar kontratën ose kontratat nga fusha e zbatimit të kësaj Direktive, ose, aty ku është e zbatueshme, nga fusha e zbatimit të Direktivës 2014/24/BE ose 2014/25/BE.

2. Një kontratë, që synon të mbulojë disa veprimtari të ndryshme, është objekt i rregullave të zbatueshme për veprimtarinë kryesore të synuar.

3. Në rastin e kontratave për të cilat është objektivisht e pamundur të përcaktohet se cilën veprimtari kryesore mbulon kontrata, atëherë rregullat e zbatueshme përcaktohen në përputhje me sa më poshtë:

- a) koncesioni jepet në përputhje me dispozitat e kësaj direktive që zbatohen për koncesionet e dhëna nga autoritetet kontraktore, nëse një nga veprimtaritë për të cilat synohet kontrata, i nënshtrohet dispozitave të kësaj direktive, që zbatohen për koncesionet që jepen nga autoritetet kontraktore dhe tjetra i nënshtrohet dispozitave të kësaj direktive, që zbatohen për koncesionet që jepen nga subjektet kontraktore;
- b) kontrata jepet në përputhje me Direktivën 2014/24/BE, nëse njëra prej veprimtarive, për të cilat është përgatitur kontrata, është objekt i kësaj direktive dhe veprimtaria tjetër është objekt i Direktivës 2014/24/BE;
- c) kontrata jepet në përputhje me këtë direktivë, nëse njëra nga veprimtaritë për të cilat është përgatitur kontrata, është objekt i kësaj direktive dhe tjetra nuk është objekt as i kësaj direktive dhe as i Direktivave 2014/24/BE apo 2014/25/BE.

## Neni 23

### **Koncesionet që mbulojnë si veprimtaritë e përmendura në shtojcën II ashtu edhe veprimtaritë që kanë të bëjnë me aspekte të mbrojtjes ose sigurisë**

1. Për kontratat që synojnë të mbulojnë disa veprimtari, subjektet kontraktore mund të zgjedhin të japin disa kontrata të veçanta për qëllimet e secilës veprimtari të veçantë ose të japin një kontratë të vetme. Kur subjektet kontraktore zgjedhin të japin kontrata të veçanta për pjesë të veçanta, vendimi se cili regjim juridik zbatohet për secilën nga këto kontrata të veçanta merret mbi bazën e karakteristikave të veprimtarisë së veçantë në fjalë.

Pavarësisht nenit 21, kur subjektet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, zbatohet paragrafi 2 i këtij neni.

Megjithatë, zgjedhja midis dhënies së një kontrate të vetme dhe dhënies së disa kontratave të veçanta nuk duhet të bëhet me qëllimin për ta përjashtuar kontratën ose kontratat nga fusha e zbatimit të kësaj Direktive, ose Direktivës 2009/81/KE.

2. Në rastin e kontratave që synohen të mbulojnë një veprimtari që i nënshtrohet kësaj direktive dhe një veprimtari tjetër e cila:

- a) mbulohet nga neni 346 i TFBE-së; ose
- b) i nënshtrohet Direktivës 2009/81/KE,

subjekti kontraktor mund:

- i) të japë një kontratë pa zbatuar këtë direktivë, në rastet e përcaktuara në germën a; ose
- ii) të japë një kontratë në përputhje me këtë direktivë ose në përputhje me Direktivën 2009/81/KE, në rastet e përcaktuara në germën b. Nënparagrafi i parë i këtij paragrafi nuk cenon kufijtë monetarë dhe përjashtimet e parashikuara në Direktivën 2009/81/KE.

Kontratat e përmendura në germën b, të cilat përfshijnë edhe prokurimin ose elemente të tjera që mbulohen nga neni 346 i TFBE-së, mund të jepen pa zbatuar këtë direktivë.

Megjithatë, për zbatimin e këtij paragrafi vendoset kushti që dhënia e një kontrate të vetme të justifikohet me arsye objektive dhe vendimi për të dhënë një kontratë të vetme të mos merret me qëllimin për të përjashtuar kontratat nga zbatimi i kësaj direktive.

#### **Seksioni IV Situata specifike**

##### Neni 24

#### **Koncesionet e rezervuara**

Shtetet anëtare mund të rezervojnë të drejtën për të marrë pjesë në procedurat e dhënies së koncesionit për organizatat që punësojnë persona me aftësi të kufizuar dhe operatorët ekonomikë, qëllimi kryesor i të cilëve është integrimi social dhe profesional i personave me aftësi të kufizuar dhe personave në nevojë ose mund të parashikojnë që këto koncesione të zbatohen në kontekstin e programeve për punësimin e personave me aftësi të kufizuara me kusht që të paktën 30% e këtyre organizatave, operatorëve ekonomikë ose programeve të jenë punonjës me aftësi të kufizuar ose punonjës në nevojë. Njoftimi i kontratës së koncesionit ose njoftimi i informacionit paraprak, në rastin e koncesioneve të shërbimeve të përkufizuara në nenin 19, duhet t'i referohet këtij neni.

##### Neni 25

#### **Shërbime për kërkim-zhvillim**

Kjo direktivë zbatohet vetëm për koncesionet e shërbimit për kërkim-zhvillim, që mbulohen nga kodet e FPP-së 73000000-2 deri në 73120000-9, 73300000-5, 73420000-2 dhe 73430000-5, nëse përmbushen të dy kushtet e mëposhtme:

- a) përfitimet i kreditohen ekskluzivisht autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor, për t'u përdorur prej tij për punët e veta; dhe
- b) shërbimi i ofruar paguhet plotësisht nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor.

## KAPITULLI II

### Parimet

#### Neni 26

#### Operatorët ekonomikë

1. Operatorët ekonomikë, të cilët sipas legjislacionit të shtetit anëtar në të cilin janë themeluar, gëzojnë të drejtën të ofrojnë shërbimet përkatëse, nuk duhet të refuzohen vetëm për shkak se u kërkohet të jenë persona fizikë ose juridikë sipas legjislacionit të shtetit anëtar në të cilin është dhënë kontrata.

Personave juridikë mund t'u kërkohet të cilësojnë në ofertë ose në aplikim, emrat dhe kualifikimet profesionale përkatëse të personelit përgjegjës për realizimin e kontratës në fjalë.

2. Grupet e operatorëve ekonomikë, duke përfshirë organizimet e përkohshme, mund të marrin pjesë në procedurat për dhënien e koncesionit. Autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore nuk u kërkohen atyre që të kenë një formë të veçantë ligjore për të dorëzuar ofertën ose kërkesën për pjesëmarrje.

Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore mund të sqarojnë, në dokumentet e koncesionit, mënyrën se si grupet e operatorëve ekonomikë plotësojnë kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësitë teknike dhe profesionale, që përmenden në nenin 38, me kusht që kjo të justifikohet nga arsye objektive dhe të jetë proporcionale. Shtetet anëtare mund të përcaktojnë kushte standarde për mënyrën se si grupet e operatorëve ekonomikë duhet t'i plotësojnë këto kërkesa. Çdo kusht për realizimin e një koncesioni nga këto grupe të operatorëve ekonomikë që është i ndryshëm nga ato që janë vendosur për pjesëmarrësit individualë gjithashtu justifikohet me arsye objektive dhe është proporcional.

3. Pavarësisht paragrafit 1 dhe 2, autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike pasi të marrin kontratën, nëse ky ndryshim është i nevojshëm për zbatimin e kënaqshëm të kontratës.

#### Neni 27

#### Nomenklatura

1. Çdo referencë për nomenklatura, në kontekstin e dhënies së koncesioneve, bëhet duke përdorur "Fjalorin e Përbashkët të Prokurimeve" (FPP), të miratuar nga Rregullorja (KE) nr. 2195/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit <sup>(27)</sup>.

2. Komisionit i jepen kompetenca për miratimin e akteve të deleguara, në përputhje me nenin 48, për të përshtatur kodet e FPP-së që përmenden në këtë direktivë, kur ndryshimet në nomenklaturën e FPP-së duhet të pasqyrohen në këtë direktivë dhe kur nuk nënkuptojnë modifikim të fushës së zbatimit të kësaj direktive.

## Neni 28

### **Konfidencialiteti**

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë direktivë ose në legjislacionin e brendshëm të cilit i nënshtrohet autoriteti kontraktor, në veçanti legjislacioni që lidhet me aksesimin e informacionit dhe pa cenuar detyrimet që lidhen me publikimin e kontratave të koncesionit që janë dhënë dhe me informimin e kandidatëve dhe ofertuesve që përcaktohet në nenet 32 dhe 40, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor nuk bën publike informacionet e dërguara nga operatorët ekonomikë, të cilët këta të fundit i kanë përcaktuar si konfidencialë, duke përfshirë, por pa u kufizuar me, sekrete teknike ose tregtare dhe aspekte konfidenciale të ofertave.

Ky nen nuk pengon publikimin e pjesëve jokonfidenciale të kontratave të lidhura, duke përfshirë çdo ndryshim të mëvonshëm.

2. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor mund të përcaktojë kërkesa për operatorët ekonomikë, të cilat kanë si qëllim të mbrojnë natyrën konfidenciale të informacionit, që ai vë në dispozicion gjatë procedurës për dhënien e koncesionit.

## Neni 29

### **Rregullat e zbatueshme për komunikimin**

1. Përveçse kur përdorimi i mjeteve elektronike është i detyrueshëm sipas nenit 33, paragrafi 2 dhe nenit 34, shtetet anëtare ose autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore mund të zgjedhin një ose më shumë prej mënyrave të mëposhtme të komunikimit, për të gjitha komunikimet dhe shkëmbimet e informacionit:

- a) mjete elektronike;
- b) postë ose faks;
- c) komunikim verbal, duke përfshirë telefonin, për biseda që nuk përfshijnë elemente thelbësore të procedurës për dhënien e koncesionit dhe me kusht që përmbajtja e komunikimit verbal të dokumentohet në masën e mjaftueshme me anë të një mjeti të qëndrueshëm;
- d) dorëzim dorazi, i vërtetuar nga konfirmimi i marrjes.

Shtetet anëtare mund ta bëjnë të detyrueshëm përdorimin e mjeteve elektronike të komunikimit për koncesionet, duke shkuar përtej detyrimeve të përcaktuara në nenin 33, paragrafi 2 dhe në nenin 34.

2. Mjetet e përzgjedhura të komunikimit duhet të jenë gjerësisht të disponueshme dhe jodiskriminuese dhe nuk duhet të kufizojnë aksesin e operatorëve ekonomikë në procedurën për dhënien e koncesionit. Mjetet dhe pajisjet që duhen përdorur për komunikimin nëpërmjet mjeteve elektronike, si edhe karakteristikat e tyre teknike duhet të jenë ndërvepruese me produktet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit që përdoren gjerësisht.

Në të gjitha komunikime, shkëmbimet dhe ruajtjet e informacionit autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore garantojnë që të ruhet integriteti i të dhënave dhe konfidencialiteti i aplikimeve dhe ofertave. Ata shqyrtojnë përmbajtjen e aplikimeve dhe ofertave, vetëm pasi të ketë përfunduar afati kohor për dorëzimin e tyre.

**TITULLI II**  
**RREGULLAT PËR DHËNIEN E KONCESIONEVE:**  
**PARIME TË PËRGJITHSHME DHE GARANCITË PROCEDURALE**

**KAPITULLI I**  
**Parime të përgjithshme**

Neni 30

**Parime të përgjithshme**

1. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor është i lirë të organizojë procedurën që çon në zgjedhjen e koncesionarit, në pajtim me këtë direktivë.
2. Planifikimi i procedurës për dhënie e koncesionit, bëhet duke respektuar parimet e përcaktuara në nenin 3. Në veçanti, gjatë procedurës për dhënie e koncesionit, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor nuk duhet t'i bëjë të ditura informacionet në mënyrë diskriminuese, që mund t'u sjellë avantazhe disa ofertuesve mbi të tjerët.
3. Shtetet anëtare marrin masat e përshtatshme për të garantuar që në zbatimin e kontratave të koncesionit, operatorët ekonomikë të veprojnë në pajtim me detyrimet e zbatueshme në fushat e legjislacionit mjedisor, social dhe të punës i përcaktuar nga drejta e Bashkimit Evropian, legjislacioni i brendshëm, kontratat kolektive ose nga dispozitat e legjislacionit ndërkombëtar mjedisor, social dhe të punës, që paraqiten në shtojcën X.
4. Komisioni ka autoritetin të miratojë akte të deleguara në përputhje me nenin 48 për të ndryshuar listën në shtojcën X, kur është e nevojshme, për të shtuar marrëveshje ndërkombëtare të reja që janë ratifikuar nga të gjithë shtetet anëtare ose kur marrëveshjet ndërkombëtare ekzistuese që përmenden nuk janë më të ratifikuara nga të gjithë shtetet anëtare, ose kanë ndryshuar në kushte të tjera, për shembull në lidhje me fushën e zbatimit, përmbajtjen ose emërtimin e tyre.

Neni 31

**Njoftimet e kontratës së koncesionit**

1. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore që dëshirojnë të japin një koncesion, bëjnë të njohur qëllimin e tyre me anë të njoftimit të kontratës së koncesionit.
2. Njoftimet e kontratës së koncesionit përmbajnë informacionin e përmendur në shtojcën V dhe, sipas rastit, çdo informacion tjetër të konsideruar të dobishëm nga autoriteti ose subjekti kontraktor, në përputhje me formatin e formularëve standardë.

3. Autoritete kontraktore dhe subjektet kontraktore që dëshirojnë të japin një koncesion për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike, të paraqitura në shtojcën IV, bëjnë të ditur qëllimin e tyre për dhënien e planifikuar të koncesionit nëpërmjet shpalljes së njoftimit paraprak të informacionit. Këto njoftime përfshijnë informacionin e përcaktuar në shtojcën VI.

4. Duke deroguar nga paragrafi 1, autoriteteve kontraktore ose subjekteve kontraktore nuk u kërkohet që të shpallin njoftim të kontratës së koncesionit, kur punët ose shërbimet mund të furnizohen vetëm nga një operator ekonomik i veçantë, për një prej arsyeve të mëposhtme:

- a) qëllimi i koncesionit është krijimi ose blerja e një vepre arti ose performance artistike unike;
- b) mungesa e konkurrencës për arsye teknike;
- c) ekzistenca e një të drejte ekskluzive;
- d) mbrojtja e të drejtave të pronësinë intelektuale dhe e të drejtave ekskluzive, të ndryshme nga ato që përcaktohen në pikën 10 të nenit 5.

Përjashtimet e përcaktuara në geramat b, c dhe d të nënparagrafit të parë, zbatohen vetëm kur nuk ekziston asnjë alternativë ose zëvendësim i arsyeshëm dhe mungesa e konkurrencës nuk vjen si rezultat i ngushtimit artificial të parametrave për dhënien e koncesionit.

5. Duke deroguar nga paragrafi 1, autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor nuk i kërkohet që të shpallë një njoftim të ri të kontratës së koncesionit, kur në përgjigje të një procedure paraprake të koncesionit nuk është dorëzuar asnjë aplikim apo ofertë, ose nuk ka pasur asnjë ofertë apo aplikim të përshtatshëm, me kusht që të mos ketë ndryshime thelbësore të kushteve fillestare të kontratës dhe Komisionit t'i dërgohet një raport, me kërkesë të tij;

Për qëllimet e nënparagrafit të parë, një ofertë konsiderohet si e papërshtatshme kur ajo nuk ka lidhje me koncesionin dhe duket qartë që nuk mund të plotësojë, pa pësuar ndryshime thelbësore, nevojat dhe kërkesat e autoritetit kontraktor ose të subjektit kontraktor, të specifikuar në dokumentet e koncesionit.

Për qëllimet e nënparagrafit të parë, një aplikim konsiderohet si i papërshtatshëm:

- a) kur aplikanti në fjalë përjashtohet ose mund të përjashtohet sipas nenit 38, paragrafi 5 deri në 9 ose nuk përmbush kriteret e përzgjedhjes, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor, sipas nenit 38, paragrafi 1;
- b) kur aplikimet përmbajnë oferta që nuk janë të përshtatshme, sipas kuptimit të nënparagrafit të dytë.

1. Jo më vonë se 48 ditë pas dhënies së një koncesioni, autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore dërgojnë, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 33, njoftimin për shpalljen e fituesit të kontratës së koncesionit, ku jepen rezultatet e procedurës për dhënien e koncesionit. Megjithatë, për shërbimet sociale dhe shërbimet e tjera specifike të paraqitura në shtojcën XV, këto njoftime mund të grupohen për çdo tre muaj. Në këto raste, ata dërgojnë njoftimet e grupuara brenda 48 orëve nga përfundimi i çdo tremujori.
2. Njoftimet për shpalljen e fituesit të kontratës së koncesionit përfshijnë informacionin e përcaktuar në shtojcën VII, ose në lidhje me koncesionet për shërbime sociale dhe shërbime të tjera specifike që paraqiten në shtojcën IV, informacionin e përcaktuar në shtojcën VIII, dhe shpallen në përputhje me nenin 33.

### Neni 33

#### **Forma dhe mënyra e shpalljes së njoftimeve**

1. Njoftimet e kontratës së koncesionit, njoftimet për shpalljen e fituesit të kontratës së koncesionit dhe njoftimi i përmendur në nënparagrafin e dytë të nenit 43, paragrafi 1, përfshijnë informacionin e përcaktuar në shtojcat V, VII dhe VIII dhe në formatin e formularëve standardë, duke përfshirë formularët standardë për korrigjimet.

Komisioni përcakton këto formularë standard, me anë të akteve zbatuese. Këto akte zbatuese, miratohen në përputhje me procedurën këshillimore, që përmendet në nenin 50.

2. Njoftimet e përmendura në paragrafin 1 hartohen dhe më pas transmetohen, nëpërmjet mjeteve elektronike, në Zyrën e Publikimeve të Bashkimit Evropian dhe shpallen në përputhje me shtojcën IX. Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian i dërgon autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor, konfirmimin e marrjes së njoftimit dhe të shpalljes së informacionit të dërguar, duke treguar datën e shpalljes që shërben si provë për shpalljen. Njoftimet shpallen jo më vonë se pesë ditë pasi dërgohen. Kostot e shpalljes së njoftimeve nga Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian merren përsipër nga Bashkimi Evropian.

3. Njoftimet e kontratës së koncesionit shpallen të plota në një ose më shumë gjuhë zyrtare të institucioneve të Bashkimit Evropian, sipas zgjedhjes së autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor. Versioni i asaj gjuhe ose versionet e atyre gjuhëve përbëjnë tekstin e vetëm ose tekstet e vetme origjinale. Përmbledhja e elementëve të rëndësishme të secilit njoftim shpallet në gjuhët e tjera zyrtare të institucioneve të Bashkimit Evropian.

4. Njoftimet e kontratës së koncesionit dhe njoftimet për shpalljen e fituesit të kontratës së koncesionit nuk shpallen në nivel kombëtar, përpara shpalljes nga Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, përveçse kur shpallja në nivel Bashkimi Evropian nuk bëhet 48 orë pasi Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian konfirmon marrjen e njoftimit nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor, siç përmendet në paragrafin 2. Njoftimet e kontratës së koncesionit dhe njoftimet për shpalljen e fituesit të kontratës së koncesionit, që shpallen në nivel kombëtar, nuk përfshijnë asnjë informacion tjetër përveç informacionit të përfshirë në njoftimet që i janë dërguar



Zyrës së Publikimeve të Bashkimit Evropian, por tregojnë datën e dërgimit të njoftimit në Zyrën e Publikimeve të Bashkimit Evropian.

#### Neni 34

##### **Disponueshmëria e dokumenteve të koncesionit në formë elektronike**

1. Nëpërmjet mjeteve elektronike, autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore ofrojnë liri shikimi të pakufizuar, të plotë, të drejtpërdrejtë dhe pa pagesë të dokumenteve të koncesionit, duke nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës së koncesionit, ose, kur njoftimi i kontratës së koncesionit nuk përfshin ftesën për dorëzimin e ofertave, nga data e dërgimit të ftesës për dorëzimin e ofertave. Teksti i njoftimit të kontratës së koncesionit ose i këtyre ftesave specifikon adresën e internetit ku mund të gjenden dokumentet e koncesionit.
2. Kur, në rrethana të justifikuara, për shkak të sigurisë së veçantë ose arsyeve teknike ose kur natyra veçanërisht sensitive e informacionit tregtar kërkon një nivel shumë të lartë mbrojtjeje, nuk mund të ofrohet liri shikimi e pakufizuar, e plotë dhe e drejtpërdrejtë pa pagesë, nëpërmjet mjeteve elektronike, e disa dokumenteve koncesioni, autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore tregojnë në njoftim ose në ftesën për dorëzimin e ofertës se këto dokumente koncesioni do të transmetohen nëpërmjet mjete të ndryshme nga mjetet elektronike dhe se afati kohor për pranimin e ofertave do të zgjatet.
3. Nëse kjo kërkohet brenda afatit të caktuar, autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore ose departamentet përkatëse u ofrojnë të gjithë aplikantëve ose ofertuesve që marrin pjesë në procedurën për dhënien e koncesionit, informacione shtesë që lidhen me dokumentet e koncesionit, jo më vonë se gjashtë ditë përpara afatit të përcaktuar për pranimin e ofertave.

#### Neni 35

##### **Lufta kundër korrupsionit dhe parandalimi i konflikteve të interesit**

Shtetet anëtare u kërkojnë autoriteteve kontraktore dhe subjekteve kontraktore të marrin masat e përshtatshme për të luftuar mashtrimin, favorizimin dhe korrupsionin dhe për të parandaluar, identifikuar dhe zgjidhur me efikasitet konfliktet e interesit që lindin gjatë kryerjes së procedurave për dhënien e koncesionit, për të shmangur çdo shtrembërim të konkurrencës dhe për të garantuar transparencën e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e barabartë të të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve.

Koncepti i konfliktit të interesit mbulon të paktën çdo situatë ku anëtarë të personelit të autoritetit ose subjektit kontraktor që janë të përfshirë në kryerjen e procedurës për dhënien e koncesionit ose që mund të ndikojnë në rezultatin e asaj procedure kanë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes financiar, ekonomik ose ndonjë interes tjetër personal që mendohet se mund të komprometojë paanësinë dhe pavarësinë e tyre në kontekstin e procedurës për dhënien e koncesionit.

Në lidhje me konfliktet e interesit, masat e miratuara nuk shkojnë përtej asaj çka është e domosdoshme për të parandaluar një konflikt të mundshëm interesi ose për të eliminuar një konflikt interesi që është identifikuar.

## **KAPITULLI II**

### **Garancitë procedurale**

#### Neni 36

#### **Kërkesa teknike dhe funksionale**

1. Kërkesat teknike dhe funksionale përcaktojnë karakteristikat që kërkohen nga punët ose shërbimet, që janë objekt i koncesionit. Ato përcaktohen në dokumentet e koncesionit.

Këto karakteristika mund t'i referohen edhe procesit specifik të prodhimit ose ofrimit të punëve ose shërbimeve të kërkuara, me kusht që ato të kenë lidhje me objektin e kontratës dhe të jenë proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Karakteristikat mund të përfshijnë, për shembull, nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, projektin për të gjitha kërkesat (duke përfshirë aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e pajtueshmërisë, performancën, sigurinë ose dimensionet, terminologjinë, simbolet, testimin dhe metodat e testimit, markimin dhe etiketimin ose udhëzuesit e përdoruesit.

2. Në specifikimet teknike ose në kërkesat funksionale nuk duhet të përmendet, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik, apo asnjë markë tregtare, patentë, lloj ose prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose e barasvlershme"

3. Një autoritet kontraktor ose një subjekt kontraktor nuk duhet të refuzojë një ofertë me arsyen se punët ose shërbimet e tenderuara nuk përputhen me kërkesat teknike dhe funksionale të cilat ajo është mbështetur, nëse ofertuesi vërteton në ofertën e tij, me anë të çdo mjeti të përshtatshëm, që zgjidhjet që ai propozon plotësojnë në mënyrë të barasvlershme kërkesat teknike dhe funksionale.

#### Neni 37

#### **Garancitë procedurale**

1. Koncesionet jepen mbi bazën e kritereve të prokurimit që përcaktohen nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor në përputhje me nenin 41, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) oferta përputhet me kërkesat minimale që përcaktohen, aty ku është e zbatueshme, nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor;
- b) oferta pajtohet me kushtet për pjesëmarrjen, që përmenden në nenin 38, paragrafi 1; dhe

c) oferta nuk është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit, në përputhje me nenin 38, paragrafët 4 deri në 7, dhe në zbatim të nenit 38, paragrafi 9.

Kërkesat minimale, që përmenden në germën a, përmbajnë kushtet dhe karakteristikat (në veçanti ato teknike, fizike, funksionale dhe ligjore) që çdo ofertë duhet të përmbushë ose të ketë.

2. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor jep:

a) një përshkrim të koncesionit dhe të kushteve për pjesëmarrjen, në njoftimin e kontratës së koncesionit;

b) një përshkrim të kriterëve të prokurimit dhe, kur është e zbatueshme, kërkesat minimale që duhet të plotësohen, në njoftimin e kontratës së koncesionit, në ftesën për dorëzimin e ofertës ose në dokumentet e tjera të koncesionit.

3. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve ose ofertuesve në një nivel të përshtatshëm, me kusht që kjo të bëhet në mënyrë transparente dhe mbi bazën e kriterëve objektive. Numri i kandidatëve ose ofertuesve që ftohen duhet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar një konkurrencë të drejtë.

4. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor u komunikojnë të gjithë pjesëmarrësve, përshkrimin e organizimit të parashikuar të procedurës dhe një afat indikativ për përfundimin e procedurës. Çdo modifikim u komunikohet të gjithë pjesëmarrësve dhe, kur modifikimi ka lidhje me elementë të shprehur në njoftimin e kontratës së koncesionit, shpallet për të gjithë operatorët ekonomikë.

5. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor garanton regjistrimin e përshtatshëm të fazave të procedurës, me anë të mjeteve që ai i gjykon si të përshtatshme, në përputhje me nenin 28, paragrafi 1.

6. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor mund të zhvillojë negociata me kandidatët dhe ofertuesit. Objekti i koncesionit, kriteret e prokurimit dhe kërkesat minimale nuk ndryshojnë gjatë zhvillimit të negociatave.

## Neni 38

### **Përzgjedhja dhe shqyrtimi cilësor i kandidatëve**

1. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore verifikojnë kushtet për pjesëmarrjen, lidhur me aftësinë profesionale dhe teknike dhe gjendjen financiare dhe ekonomike të kandidatëve ose ofertuesve, mbi bazën e vetëdeklarimeve, referencës ose referencave që duhet të dorëzohen si provë, në përputhje me kërkesat e specifikuara në njoftimin e kontratës së koncesionit, që duhet të jenë jodiskriminuese dhe përpjesëtimore me objektin e koncesionit. Kushtet për pjesëmarrjen duhet të kenë lidhje dhe të jenë përpjesëtimore me nevojën për të garantuar aftësinë e koncesionarit për të realizuar koncesionin, duke marrë në konsideratë objektin e koncesionit dhe qëllimin për të garantuar konkurrencë të drejtë.

2. Me qëllim përmbushjen e kushteve për pjesëmarrjen, që përcaktohen në paragrafin 1, një operator ekonomik, kur është e përshtatshme dhe për një koncesion të veçantë, mund të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës ligjore të lidhjeve që ai ka me këtë subjekt. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor se ai do të ketë në dispozicion, gjatë gjithë periudhës së koncesionit, burimet e nevojshme, për shembull, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të atyre subjekteve, për këtë qëllim. Në lidhje me gjendjen financiare, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor mund të kërkojë që operatorit ekonomik dhe ato subjekte të mbajnë përgjegjësi të përbashkët për zbatimin e kontratës.

3. Sipas të njëjtave kushte, grupi i operatorëve ekonomikë siç përmendet në nenin 26 mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera.

4. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore, që përmenden në germën a të nenit 7, paragrafi 1, përjashtojnë një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurën për dhënien e koncesionit, kur ato dalin në përfundimin se operatorit ekonomik ka qenë i dënuar me një vendim të formës së prerë për një nga arsyet e mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në organizatë kriminale, siç përcaktohet në nenin 2 të Vendimit Kuadër të Këshillit 2008/841/DPB <sup>(28)</sup>;
- b) korrupsioni, siç përkufizohet në nenin 3 të Konventës për luftën kundër korrupsionit, ku janë përfshirë zyrtarë të Komuniteteve Evropiane ose zyrtarë të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian <sup>(29)</sup> dhe në nenin 2, paragrafi 1 të Vendimit Kuadër të Këshillit 2003/568/DPB <sup>(30)</sup>, si dhe korrupsioni siç përkufizohet në legjislacionin e brendshëm të autoritetit ose subjektit kontraktor ose të operatorit ekonomik;
- c) mashtrimi, sipas kuptimit të nenit 1 të Konventës për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Evropiane <sup>(31)</sup>;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, siç përcaktohet përkatësisht në nenet 1 dhe 3 të Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/475/ÇBD <sup>(32)</sup> ose nxitje, ndihmë ose mbështetje për kryerjen e veprave penale, siç përmenden në nenin 4 të këtij vendimi kuadër;
- e) pastrim parash ose financim i terrorizmit, siç përcaktohet në nenin 1 të Direktivës 2005/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(33)</sup>;
- f) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore, siç përcaktohet në nenin 2 të Direktivës 2011/36/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(34)</sup>;

Detyrimi për të përjashtuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij operatori ekonomik ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda atij operatori ekonomik.

Subjektet kontraktore, të ndryshme nga ato që përmenden në germën a të nenit 7, paragrafi 1, mund të përjashtojnë një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurën për dhënien e koncesionit,

kur ato kanë dijeni se operatori ekonomik ka qenë i dënuar me një vendim të formës së prerë për një nga arsyet e paraqitura në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi.

5. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore, siç përmenden në germën a të nenit 7 paragrafi 1, përjashtojnë një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurën për dhënien e koncesionit kur ata kanë dijeni se operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij që lidhen me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe kjo është vendosur nga një vendim gjyqësor ose administrativ i formës së prerë, në përputhje me dispozitat ligjore të vendit ku ky vendim është dhënë ose me dispozitat ligjore të shtetit anëtar të autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor.

Gjithashtu, autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore, siç përmenden në germën a të nenit 7, paragrafi 1, mund të përjashtojnë ose mund t'u kërkohet nga shtetet anëtare që të përjashtojnë nga pjesëmarrja në procedurën për dhënien e koncesionit një operator ekonomik, kur autoriteti ose subjekti kontraktor mund të vërtetojnë me çdo mjet të përshtatshëm se operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Ky paragraf nuk gjen më zbatim kur operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamat vonesë ose gjobë.

6. Shtetet anëtare mund të parashikojnë një shmangie nga përjashtimi i detyrueshëm që parashikohet në paragrafët 4 dhe 5, mbi baza përjashtimore, për arsye madhore që lidhen me interesin e publikut, si shëndeti publik ose mbrojtja e mjedisit.

Shtetet anëtare gjithashtu mund të parashikojnë një shmangie nga përjashtimi detyrues që parashikohet në paragrafin 5, kur përjashtimi do të ishte qartësisht jopërpjestimor, në veçanti kur nuk janë paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore ose kur operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore në një kohë të tillë kur ai nuk ka pasur mundësi të marrë masat që parashikohen në nënparagrafin e tretë të paragrafit 5, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e aplikimit të tij.

7. Autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore mund të përjashtojnë ose shtetet anëtare mund t'u kërkojnë atyre të përjashtojnë nga pjesëmarrja në procedurën për dhënien e koncesionit çdo operator ekonomik, nëse përmbushet një nga kushtet e mëposhtme:

- a) kur mund të vërtetohet me anë të çdo mjeti të përshtatshëm një shkelje e detyrimeve të zbatueshme, që përmenden në nenin 30, paragrafi 3;
- b) kur operatori ekonomik ka shpallur falimentimit ose i është nënshtruar procedurave të likuidimit ose mbylljes së aktivitetit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator i përkohshëm ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një

procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit dhe rregulloreve të brendshme; megjithatë, autoriteti kontraktor dhe subjekti kontraktor mund të vendosin të mos e përjashtojnë, ose shtetet anëtare mund t'u kërkojnë atyre të mos e përjashtojnë një operator ekonomik që ndodhet në një nga situatat e mësipërme kur ai ka dalë në përfundimin se operatori ekonomik në fjalë do të jetë në gjendje ta realizojë koncesionin, duke marrë në konsideratë rregullat e brendshme të zbatueshme dhe masat për vazhdimin e biznesit në rastin e situatave të tilla;

- c) kur autoriteti kontraktor mund të vërtetojë me çdo mjet të përshtatshëm se operatori ekonomik është fajtor për një shkelje të rëndë profesionale që vë në pikëpyetje integritetin e tij;
- d) kur konflikti i interesit, sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 35, nuk mund të korrigjohet siç duhet me anë të një mase më pak shtrënguese;
- e) kur autoriteti kontraktor ka tregues të mjaftueshëm për të dalë në përfundimin se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;
- f) kur operatori ekonomik ka treguar mangësi të mëdha ose të përsëritura në zbatimin e kërkesave thelbësore gjatë realizimit të një koncesioni të mëparshëm ose një kontrate të mëparshme me një autoritet kontraktor ose një subjekt kontraktor, sipas përkufizimit në këtë direktivë ose në Direktivën 2014/25/BE, që kanë çuar në zgjidhjen e parakohshme të kontratës së mëparshme, në sanksione për dëmet ose sanksione të tjera të ngjashme;
- g) kur operatori ekonomik është shpallur fajtor për deklaratat të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për përjashtim ose për plotësimin e kritereve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet e kërkuara në mbështetje të këtij informacioni;
- h) kur operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor, për të marrë informacion konfidencial që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën për dhënien e koncesionit ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose shpalljen e fituesit;
- i) në rastin e koncesioneve në fushat e mbrojtjes dhe të sigurisë që përmenden në Direktivën 2009/81/KE, kur është vërtetuar, bazuar mbi çdo provë, duke përfshirë burimet e mbrojtura të të dhënave, se operatori ekonomik nuk ka besueshmërinë e nevojshme për të përjashtuar rreziqet ndaj sigurisë së shtetit anëtar.

8. Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore, të përmendura në germën a të nenit 7, paragrafi 1, në çdo kohë gjatë procedurës përjashtojnë një operator ekonomik, kur operatori ekonomik në fjalë, duke marrë në konsideratë veprat e kryera ose të pakryera qoftë përpara ose gjatë procedurës, ndodhet në një nga situatat e përmendura në paragrafin 4 të këtij neni dhe në nënparagrafin e parë të paragrafit 5 të këtij neni.

Në çdo kohë gjatë procedurës autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore mund të përjashtojnë, ose shtetet anëtare mund t'u kërkojnë atyre të përjashtojnë një operator ekonomik kur rezulton se operatori ekonomik në fjalë, duke marrë në konsideratë veprat e kryera ose të pakryera qoftë përpara ose gjatë procedurës, gjendet në një nga situatat e përmendura në nënparagrafin e parë të paragrafit 5 dhe në paragrafin 7.

9. Çdo operator ekonomik që gjendet në një nga situatat e përmendura në paragrafët 4 dhe 7, mund të japë prova për të treguar se masat e marra nga operatori ekonomik janë të mjaftueshme për të vërtetuar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së arsyeve përkatëse për përjashtim. Nëse këto prova konsiderohen si të mjaftueshme, operatori ekonomik në fjalë nuk përjashtohet nga procedura.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik vërteton se ka paguar ose ka marrë përsipër të paguajë kompensimin në lidhje me çdo dëm të shkaktuar nga vepra penale ose shkelja, ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke bashkëpunuar në mënyrë aktive me autoritetet hetuese dhe ka marrë masa konkrete teknike, organizative dhe në lidhje me personelin, që janë të përshtatshme për të parandaluar vepra penale ose shkelje të tjera. Masat e marra nga operatorët ekonomikë, vlerësohen duke marrë në konsideratë shkallën dhe rrethanat e veçanta të veprës penale ose shkeljes. Kur masat konsiderohen se janë të pamjaftueshme, operatori ekonomik në fjalë merr një deklaratë me arsyet për këtë vendim.

Operatori ekonomik që përjashtohet, me anë të një vendimi të formës së prerë, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit ose për dhënien e koncesionit, nuk ka të drejtë të shfrytëzojë mundësinë që i jep ky paragraf, gjatë periudhës së përjashtimit që rezulton nga ky vendim, në shtetet anëtare ku vendimi ka fuqi ligjore.

10. Shtetet anëtare specifikojnë me ligj, rregullore ose dispozitë administrative dhe duke marrë në konsideratë të drejtën e Bashkimit Evropian, kushtet zbatuese të këtij neni. Ato, në veçanti, përcaktojnë periudhën maksimale të përjashtimit, nëse operatori ekonomik nuk ndërmer asnjë nga masat e specifikuar në paragrafin 9, për të vërtetuar besueshmërinë e tij. Kur periudha e përjashtimit nuk është përcaktuar me vendim të formës së prerë, ajo periudhë nuk duhet të tejkalojë pesë vjet nga data e dënimit me vendim të formës së prerë, për rastet e përmendura në paragrafin 4 dhe tre vjet nga data e ngjarjes përkatëse, për rastet e përmendura në paragrafin 7.

## Neni 39

### **Afatet kohore për pranimin e aplikimeve dhe ofertave për koncesionin**

1. Në përcaktimin e afateve kohore për marrjen e aplikimeve ose të ofertave, autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore marrin veçanërisht parasysh kompleksitetin e koncesionit dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave ose aplikimeve, pa cenuar afatet minimale të përcaktuara nga ky nen.

2. Për rastet kur aplikimet ose ofertat mund të bëhen vetëm pas një vizite në terren ose pas një inspektimi të paparalajmëruar të dokumenteve mbështetëse të dokumentacionit për dhënien e

koncesionit, afatet për pranimin e aplikimeve për koncesion ose për pranimin e ofertave, përcaktohen në mënyrë të tillë që të gjithë operatorët ekonomikë në fjalë të jenë në dijeni për të gjitha informacionet që nevojiten për të përgatitur aplikimet ose ofertat dhe, për çdo rast, duhet të jenë më të gjata se kufijtë kohorë minimalë të përcaktuar në paragrafët 3 dhe 4.

3. Afati minimal për pranimin e aplikimeve, pavarësisht nëse ato përfshijnë oferta për koncesionin, është 30 ditë që nga data në të cilën është dërguar njoftimi i kontratës së koncesionit.

4. Kur procedura kryhet në faza të njëpasnjëshme, afati minimal për pranimin e ofertave fillestare është 22 ditë nga data e dërgimit të ftesës për ofertë.

5. Afati për pranimin e ofertave mund të ulet me pesë ditë kur autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor pranon që ofertat të dorëzohen me anë të mjeteve elektronike, në përputhje me nenin 29.

#### Neni 40

##### **Dhënia i informacionit kandidatëve dhe ofertuesve**

1. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor informon, sa më shpejt të jetë e mundur, çdo kandidat dhe ofertues për vendimet e marra në lidhje me një koncesion, duke përfshirë emrin e ofertuesit të suksesshëm, arsyet e çdo vendimi për refuzimin e aplikimit ose ofertës së tij dhe arsyet për çdo vendim për të mos dhënë një kontratë për të cilën është shpallur njoftimi i kontratës së koncesionit, ose për të rifilluar procedurën.

Gjithashtu, me kërkesën nga pala e përfshirë, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor njofton, sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe për çdo rast brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës me shkrim, të gjithë ofertuesit që kanë dorëzuar një ofertë të pranueshme për karakteristikat dhe avantazhet relative të ofertës së përzgjedhur.

2. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor mund të vendosë të mos publikojnë disa informacione që përmenden në paragrafin 1, të cilat lidhen me kontratën, kur publikimi i këtij informacioni do të pengonte zbatimin e ligjit, do të binte ndesh me interesin publik, do të cenonte interesat tregtare legjitime të operatorëve ekonomikë, qofshin ata publikë ose privat, ose do mund të cenonte konkurrencën e ndershme ndërmjet këtyre operatorëve.

#### Neni 41

##### **Kriteret për dhënien e koncesionit**

1. Koncesionet jepen mbi bazën e kriterëve objektive, që janë në pajtim me parimet e përcaktuara në nenin 3 dhe që garantojnë që ofertat të shqyrtohen në kushtet e konkurrencës efikase për të identifikuar një avantazh ekonomik të përgjithshëm për autoritetin kontraktor ose subjektin kontraktor.



2. Kriteret e prokurimit janë të lidhura me objektin e koncesionit dhe nuk i akordojnë autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato mund të përfshijnë, ndër të tjera, kriteret mjedisore, sociale ose që lidhen me inovacionin.

Këto kriteret shoqërohen nga kërkesa që lejojnë verifikimin efikas të informacionit të dhënë nga ofertuesit.

Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor verifikon nëse ofertat përmbushin siç duhet kriteret e prokurimit.

3. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor paraqet kriteret sipas rendit të rëndësisë në zbritje.

Pavarësisht nënparagrafit të parë, kur autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor merr një ofertë që propozon një zgjidhje novatore me një nivel përjashtimor të performancës funksionale, që nuk mund të parashikohet nga një autoritet ose subjekt kontraktor i kujdesshëm, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor, në raste përjashtimore, mund të modifikojë rendin e kriterëve për dhënien e koncesionit, duke marrë në konsideratë atë zgjidhje novatore. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor informon të gjithë ofertuesit për modifikimin e rendit të rëndësisë dhe nxjerr një ftesë të re për dorëzimin e ofertave, sipas afateve minimale të përmendura në nenin 39, paragrafi 4. Kur kriteret e prokurimit janë shpallur, në momentin e shpalljes së njoftimit të kontratës së koncesionit, autoriteti ose subjekti kontraktor shpall një njoftim të ri të kontratës së koncesionit, sipas afateve minimale të përmendura në nenin 39, paragrafi 3.

Modifikimi i rendit nuk duhet të sjellë diskriminim.

### **TITULLI III**

## **RREGULLAT PËR REALIZIMIN E KONCESIONEVE**

Neni 42

### **Nënkontraktimi**

1. Respektimi i detyrimeve të përmendura në nenin 30, paragrafi 3 nga nënkontraktorët, garantohet nëpërmjet veprimit të përshtatshëm nga autoritetet kombëtare kompetente, që veprojnë brenda fushës së përgjegjësisë dhe kompetencës së tyre.

2. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor në dokumentet e koncesionit mund të kërkojë ose një shtet anëtar mund t'u kërkojë atyre që t'i kërkojnë ofertuesit ose aplikantit që të tregojë në ofertën e tij çdo përqindje të koncesionit që ai mund të synojë të nënkontrakttojë te palë të treta dhe çdo nënkontraktor të propozuar. Ky paragraf nuk prek përgjegjësitë e koncesionarit kryesor.

3. Në rastin e koncesioneve të punëve dhe lidhur me shërbimet që do të ofrohen në mjedisin që mbikëqyret nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor pas dhënies së koncesionit dhe maksimumi kur fillon realizimi i koncesionit, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor i kërkon koncesionarit që t'i tregojë autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor emrin, të dhënat e kontaktit dhe përfaqësuesit ligjorë të nënkontraktorëve të tij, të përfshirë në këto punë ose

shërbime, nëse ato dihen deri në atë momenti. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor i kërkon koncesionarit që ta njoftojë atë për çdo ndryshim në këtë informacion gjatë realizimit të koncesionit, si edhe në informacionin e kërkuar për ndonjë nënkontraktor të ri, që ai përfshin në vijim në këto punë ose shërbime.

Pavarësisht nënparagrafit të parë, shtetet anëtare mund t'ia vendosin direkt koncesionarit detyrimin për të dorëzuar informacionin e kërkuar.

Nënparagrafi i parë dhe ai i dytë nuk zbatohen për furnizuesit.

Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore mund të zgjerojnë ose atyre mund t'u kërkohej nga shtetet anëtare që të zgjerojnë detyrimet që parashikohen në nënparagrafin e parë, për shembull edhe për:

- a) koncesionet e shërbimeve të ndryshme nga ato që lidhen me shërbimet që duhet të ofrohen në mjediset që mbikëqyren nga autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor ose për furnizuesit e përfshirë në koncesionet e punëve ose shërbimeve;
  - b) nënkontraktorët e nënkontraktorëve të koncesionarit ose dhe për hallka të tjera të zinxhirit të nënkontraktimit.
4. Me qëllim shmangien e shkeljeve të detyrimeve, të përmendura në nenin 30, paragrafi 3, mund të merren masa të përshtatshme, si për shembull:
- a) Kur legjislacioni i brendshëm i një shteti anëtar parashikon një mekanizëm të përgjegjësive së përbashkët ndërmjet nënkontraktorëve dhe koncesionarit, shtetet anëtare në fjalë duhet të garantojnë zbatimin e rregullave përkatëse në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 30, paragrafi 3.
  - b) Autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore mund të verifikojnë ose atyre mund t'u kërkohej nga shtetet anëtare që të verifikojnë nëse ka arsye për përjashtimin e nënkontraktorëve, në zbatim të nenit 38, paragrafi 4 deri në 10. Në këto raste, autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik që të zëvendësojë një nënkontraktor për të cilin verifikimi ka treguar se ekzistojnë arsye detyruese për përjashtim. Autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor mund të kërkojë ose atij mund t'i kërkohej nga një shtet anëtar që t'i kërkojë një operatori ekonomik zëvendësimin e një nënkontraktori, për të cilin verifikimi ka treguar se ekzistojnë arsye jodetyruese për përjashtim.
5. Shtetet anëtare mund të parashikojnë rregulla më shtrënguese për përgjegjësinë, sipas legjislacionit të brendshëm.
6. Shtetet anëtare që kanë zgjedhur të parashikojnë masa sipas paragrafit 1 dhe 3, me ligj, rregullore ose dispozita administrative dhe duke pasur parasysh të drejtën e Bashkimit Evropian, specifikojnë kushtet zbatuese për këto masa. Duke vepruar kështu, shtetet anëtare mund të kufizojnë zbatueshmërinë e tyre, për shembull, për disa lloje kontratash, disa kategori të

autoriteteve kontraktore, subjekteve kontraktore ose operatorëve ekonomikë ose për shuma të caktuara.

#### Neni 43

### **Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre**

1. Koncesionet mund të modifikohen pa zhvilluar një procedurë të re për dhënien e koncesionit, në përputhje me këtë direktivë për secilin nga rastet e mëposhtme:

- a) kur modifikimet, pavarësisht vlerës së tyre monetare, janë parashikuar në dokumentet fillestare të koncesionit nëpërmjet klauzolave të qarta, të sakta dhe të caktuara për rishikimin, që mund të përfshijnë klauzola për rishikimin e vlerës ose opsione. Në këto klauzola deklarohet objekti dhe natyra e modifikimeve ose opsioneve të mundshme, si edhe kushtet në të cilat ato mund të përdoren. Ato nuk parashikojnë modifikime ose opsione, që do të ndryshonin natyrën e përgjithshme të koncesionit;
- b) për punë ose shërbime shtesë nga koncesionari fillestar që janë bërë të nevojshme dhe që nuk ishin përfshirë në koncesionin fillestar, kur ndryshimi i koncesionarit:
  - i) nuk mund të bëhet për arsye ekonomike ose teknike, siç janë kërkesat për zëvendësimin dhe ndërveprueshmërinë me pajisjet, shërbimet ose instalimet ekzistuese të prokuruar në zbatim të koncesionit fillestar; dhe
  - ii) do të shkaktonte vështirësi të konsiderueshme ose duplikim të konsiderueshëm të kostove për autoritetin kontraktor ose subjektin kontraktor.

Megjithatë, në rastin e koncesioneve që jepen nga autoriteti kontraktor, me qëllim kryerjen e një aktiviteti të ndryshëm nga ato që përmenden në shtojcën II, çdo shtim i vlerës nuk duhet të tejkalojë 50% të vlerës së koncesionit fillestar. Kur bëhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim zbatohet për vlerën e secilit modifikim. Këto modifikime të njëpasnjëshme nuk kanë si qëllim anashkalimin e kësaj direktive;

- c) kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:
  - i) nevoja për modifikim ka lindur nga rrethana, të cilat nuk mund të parashikoheshin nga një autoritet ose subjekt kontraktor i kujdesshëm;
  - ii) modifikimi nuk ndryshon natyrën e përgjithshme të koncesionit;
  - iii) në rastin e koncesioneve që jepen nga autoriteti kontraktor, me qëllim kryerjen e një aktiviteti të ndryshëm nga ato që përmenden në shtojcën II, çdo shtim i vlerës nuk tejkalon 50% të vlerës së koncesionit fillestar. Kur bëhen disa modifikime të njëpasnjëshme, ky kufizim zbatohet për vlerën e secilit modifikim. Këto modifikime të njëpasnjëshme nuk kanë si qëllim anashkalimin e kësaj direktive;

d) kur një koncesionar i ri zëvendëson koncesionarin, të cilit autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor i kishte dhënë koncesionin fillimisht, si pasojë e:

i) një klauzole rishikimi të caktuar ose opsioni, në përputhje me germën a;

ii) zëvendësimin universal ose të pjesshëm të pozicionit të koncesionarit fillestar, në vijim të ristrukturimit të korporatës, duke përfshirë marrjen nën kontroll, shkrirjen, blerjen ose falimentimin, me një operator tjetër ekonomik që përmbush kriteret për përzgjedhjen cilësore që është vendosur në fillim, me kusht që kjo të mos përfshijë modifikime të tjera thelbësore të kontratës dhe të mos ketë si qëllim shmangien nga zbatimi i kësaj direktive; ose

iii) në rastin kur vetë autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor merr përsipër detyrimet e koncesionarit kryesor përkundrejt nënkontraktorëve të tij, kur kjo mundësi parashikohet në zbatim të legjisllacionit të brendshëm;

e) kur modifikimet, pavarësisht vlerës së tyre, nuk janë thelbësore, sipas kuptimit të paragrafit 4. Pasi autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore modifikojnë një koncesion, në rastet e përcaktuara në germën b dhe c të këtij paragrafi, shpallin një njoftim për këtë qëllim në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*. Ky njoftim përmban informacionin e përcaktuar në shtojcën XI dhe shpallet në përputhje me nenin 33.

2. Gjithashtu, dhe pa qenë nevoja për të verifikuar nëse përmbushen ose jo kushtet e përcaktuara në germën a deri në d të paragrafit 4, koncesionet po ashtu mund të modifikohen pa qenë nevoja për një procedurë të re për dhënien e koncesionit, në përputhje me këtë direktivë, kur vlera e modifikimit nuk tejkalon asnjërën nga vlerat e mëposhtme:

i) kufirin monetar të përcaktuar në nenin 8; dhe

ii) 10% të vlerës së koncesionit fillestar.

Megjithatë, modifikimi nuk mund të ndryshojë natyrën e përgjithshme të koncesionit. Kur bëhen disa ndryshime të njëpasnjëshme, vlera shqyrtohet mbi bazën e vlerës kumulative neto të modifikimeve të njëpasnjëshme.

3. Për qëllimin e llogaritjes së vlerës së përmendur në paragrafin 2 dhe gjerat b dhe c të paragrafit 1, vlera e përditësuar është vlera referencë, kur kontrata e koncesionit përfshin një klauzolë indeksimi. Nëse kontrata e koncesionit nuk përfshin një klauzolë indeksimi, vlera e përditësuar llogaritet duke marrë në konsideratë inflacionin mesatar në shtetin anëtar të autoritetit kontraktor ose të subjektit kontraktor.

4. Një modifikim i kontratës së koncesionit gjatë afatit të saj, konsiderohet se është thelbësor, sipas kuptimit që i jepet në germën e të paragrafit 1, kur ai e bën karakterin e koncesionit në thelb të ndryshëm nga ai i koncesionit të dhënë fillimisht. Gjithsesi, pa cenuar paragrafët 1 dhe 2,

modifikimi konsiderohet si thelbësor kur përmbushet një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme:

- a) modifikimi paraqet kushte, të cilat, nëse do të kishin qenë të përfshira në procedurën fillestare për dhënien e koncesionit, do të kishin lejuar pranimin e aplikantëve të ndryshëm nga ata që u përzgjedhën fillimisht ose pranimin e një oferte të ndryshme nga ajo që u pranua fillimisht ose do të kishin tërhequr pjesëmarrës shtesë në procedurën për dhënien e koncesionit;
  - b) modifikimi ndryshon balancën ekonomike të kontratës së koncesionit në favor të koncesionarit, në një mënyrë që nuk ishte parashikuar në kontratën fillestare;
  - c) modifikimi zgjeron në mënyrë të konsiderueshme objektin e kontratës së koncesionit;
  - d) kur një koncesionar i ri zëvendëson atë të cilit autoriteti kontraktor ose subjekti kontraktor i kishte dhënë fillimisht koncesionin, për raste të ndryshme nga ato që parashikohen në germenin d të paragrafit 1.
5. Për modifikime e dispozitave të një kontrate koncesioni, gjatë afatit të saj, të ndryshme nga ato që parashikohen në paragrafin 1 dhe 2, nevojitet procedurë e re për dhënien e koncesionit, në përputhje me këtë direktivë.

#### Neni 44

### **Zgjidhja e kontratave të koncesionit**

Shtetet anëtare garantojnë që autoritetet kontraktore dhe subjektet kontraktore të kenë mundësi, sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm i zbatueshëm, që të zgjidhin një kontratë koncesioni gjatë afatit të saj, kur përmbushen një ose më shumë prej kushteve të mëposhtme:

- a) është bërë një modifikim i kontratës së koncesionit, i cili, në zbatim të nenit 43, do të kërkonte një procedurë të re për dhënien e koncesionit.
- b) në kohën e dhënies së koncesionit, koncesionari është gjendur në një prej situatave të përmendura në nenin 38, paragrafi 4 dhe për këtë arsye duhet të ishte përjashtuar nga procedura për dhënien e koncesionit.
- c) në një procedurë, në zbatim të nenit 258 të TFBE-së, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian zbulon se një shtet anëtar nuk ka përmbushur detyrimet e tij që rrjedhin nga traktatet, nga fakti që një autoritet kontraktor ose një subjekt kontraktor i atij shteti anëtar ka dhënë koncesionin në fjalë pa respektuar detyrimet e tij sipas traktateve dhe kësaj direktive.

#### Neni 45

### **Monitorimi dhe raportimi**

1. Për të garantuar zbatimin e saktë dhe efikas, shtetet anëtare garantojnë që të paktën detyrat e përcaktuara në këtë nen, të kryhen nga një ose më shumë autoritete ose struktura. Ata informojnë Komisionin për të gjitha autoritetet ose strukturat kompetente për këto detyra.

2. Shtetet anëtare sigurohen që të monitorohet zbatimi i rregullave për dhënien e kontratave të koncesionit. Kur autoritetet ose strukturat monitoruese identifikojnë shkelje specifike, si mashtrimi, korrupsioni, konflikti i interesit dhe parregullsi të tjera të rënda ose probleme sistematike, ata kanë autoritetin t'ia bëjnë komunikojnë këto shkelje ose probleme autoriteteve kombëtare të kontrollit, gjykatave ose trupave gjyquese ose autoriteteve ose strukturave të tjera të përshtatshme, siç p.sh. avokati i popullit, parlamentet kombëtare ose komitetet e tyre.

3. Rezultatet e veprimtarive të monitorimit, sipas paragrafit 2, vihen në dispozicion të publikut nëpërmjet mjeteve të përshtatshme të informimit.

Komisioni mund të kërkojë që shtetet anëtare t'i transmetojnë Komisionit, maksimumi çdo tre vjet, një raport monitorimi që mbulon një përmbledhje të shkaqeve më të shpeshta për zbatimin e pasaktë të rregullave për dhënien e kontratave të koncesionit, duke përfshirë probleme të mundshme strukturore ose të përsëritura në zbatimin e rregullave, si dhe shkaqet e mundshme të mashtrimit ose të sjelljeve të tjera të paligjshme.

4. Shtetet anëtare garantojnë që informacioni dhe udhëzimet për interpretimin dhe zbatimin e së drejtës së Bashkimit Evropian për dhënien e kontratave të koncesionit, të bëhet i disponueshëm pa pagesë, me qëllim që autoritetet dhe subjektet kontraktore dhe operatorët ekonomikë të ndihmohen për zbatimin e saktë të rregullave të Bashkimit Evropian.

## **TITULLI IV**

### **NDRYSHIMET E DIREKTIVAVE 89/665/KEE DHE 92/13/KEE**

Neni 46

#### **Ndryshimet e Direktivës 89/665/KEE**

Direktiva 89/665/KEE ndryshohet si më poshtë:

1. paragrafi 1 i nenit 1, zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"1. Kjo direktivë zbatohet për kontratat e përmendura në Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(35)</sup> përveçse kur këto kontrata përjashtohen në përputhje me nenet 7, 8, 9, 10, 11, 12, 15, 16, 17 dhe 37 të kësaj direktive.

Kjo direktivë zbatohet edhe për koncesionet që jepen nga autoritetet kontraktore, të përmendura në Direktivën 2014/23/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(36)</sup>, përveçse kur këto koncesione përjashtohen në përputhje me nenet 10, 11, 12, 17 dhe 25 të kësaj direktive.

Kontratat, sipas kuptimit që u jepet në këtë direktivë, përfshijnë kontratat publike, marrëveshjet kuadër, koncesionet për punë dhe shërbime dhe sistemet dinamike të blerjes.

Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të garantuar që vendimet e marra nga autoritetet kontraktore, në lidhje me kontratat që përfshihen në fushën e zbatimit të Direktivës 2014/24/BE ose Direktivës 2014/23/BE, të mund të shqyrtohen me efikasitet dhe sa më shpejt të jetë e mundur, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenet 2 deri në 2f të kësaj direktive, në rastet kur këto vendime kanë shkelur të drejtën e Bashkimit Evropian në fushën e prokurimit publik ose rregullat kombëtare që transpozojnë këtë të drejtë.

2. paragrafi 2 i nenit 2a, ndryshohet si më poshtë:

a) nënparagrafi i parë zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

Pas vendimit për dhënien e kontratës, të përfshirë në fushën e zbatimit të Direktivës 2014/24/BE ose Direktivës 2014/23/BE, kontrata nuk mund të lidhet pa mbaruar periudha prej të paktën 10 ditësh kalendarike, që fillon nga e nesërmja e datës në të cilën vendimi për dhënien e kontratës i dërgohet ofertuesve dhe kandidatëve të interesuar, nëse përdoret faksi ose mjetet elektronike, ose, nëse përdoren mjete të tjera komunikimi, pa mbaruar periudha prej të paktën 15 ditësh kalendarike, që fillon nga e nesërmja e datës në të cilën vendimi për dhënien e kontratës i dërgohet ofertuesve dhe kandidatëve të interesuar, ose pa mbaruar periudha prej të paktën 10 ditësh kalendarike, që fillon nga e nesërmja e datës së marrjes së vendimit për dhënien e kontratës.";

b) në nënparagrafin e katërt, ndarja e parë zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"— një përmbledhje e arsyeve përkatëse, të përcaktuara në nenin 55, paragrafi 2 të Direktivës 2014/24/BE, në zbatim të nenit 55, paragrafi 3 të asaj direktive, ose në nënparagrafin e dytë të nenit 40, paragrafi 1 të Direktivës 2014/23/BE, në zbatim të nenit 40, paragrafi 2 të po asaj direktive dhe";

3. Neni 2b ndryshohet si më poshtë:

a) në paragrafin e parë:

i) germa a zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"a) kur Direktiva 2014/24/BE, ose sipas rastit, Direktiva 2014/23/BE nuk kërkon shpalljen paraprake të njoftimit të kontratës në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*";

ii) germa c zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"c) në rastin e një kontrate që bazohet në një marrëveshje kuadër, siç parashikohet në nenin 33 të Direktivës 2014/24/BE dhe në rastin e një kontrate specifike që bazohet në një sistem dinamik blerjeje, siç parashikohet në nenin 34 të asaj direktive.";

b) në paragrafin e dytë ndarja e parë dhe e dytë zëvendësohen me tekstin e mëposhtëm:

"— ka shkelje të germës c të nenit 33, paragrafi 4 ose të nenit 34, paragrafi 6 të Direktivës 2014/24/BE, dhe

— vlera e kontratës parashikohet të jetë e barabartë me ose të tejkalojë kufijtë e paraqitur në nenin 4 të Direktivës 2014/24/BE.";

4. në nenin 2c, teksti "Direktiva 2004/18/KE" zëvendësohet me tekstin "Direktiva 2014/24/BE ose Direktiva 2014/23/BE";

5. Neni 2d ndryshohet si më poshtë:

a) në paragrafin 1:

i) germa a zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"a) kur autoriteti kontraktor ka dhënë një kontratë pa shpalljen paraprake të njoftimit të kontratës në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*, kur kjo nuk është e lejueshme në përputhje me Direktivën 2014/24/BE ose Direktivën 2014/23/BE";

ii) në germën b, teksti "Direktiva 2004/18/KE" zëvendësohet me tekstin "Direktiva 2014/24/BE ose Direktiva 2014/23/BE";

b) në paragrafin 4, ndarja e parë zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"\_\_ autoriteti kontraktor gjykon se dhënia e një kontrate pa shpalljen paraprake të njoftimit të kontratës në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian* është e lejueshme në përputhje me Direktivën 2014/24/BE ose Direktivën 2014/23/BE";

c) në paragrafin 5, ndarja e parë zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"— autoriteti kontraktor gjykon se dhënia e kontratës është në përputhje me germën c të nenit 33, paragrafi 4 ose me nenin 34, paragrafi 6 të Direktivës 2014/24/BE,";

6. në nenin 2f, paragrafi 1, germa a zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"a) përpara përfundimit të të paktën 30 ditëve kalendarike, që nisin nga e nesërmja e datës në të cilën:

— autoriteti kontraktor ka shpallur njoftimin për shpalljen e fituesit të kontratës, në përputhje me nenet 50 dhe 51 të Direktivës 2014/24/BE ose me nenet 31 dhe 32 të Direktivës 2014/23/BE, nëse ky njoftim përfshin justifikimin e vendimit të autoritetit kontraktor për të dhënë kontratën pa shpalljen paraprake të njoftimit të kontratës në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*, ose



— autoriteti kontraktor ka informuar ofertuesit dhe kandidatët e interesuar për lidhjen e kontratës, nëse ky informacion përmban një përmbledhje të arsyeve përkatëse që përcaktohen në nenin 55, paragrafi 2 të Direktivës 2014/24/BE, sipas dispozitave të nenit 55, paragrafi 3 të kësaj direktive ose në nënparagrafin e dytë të nenit 40, paragrafi 1 të Direktivës 2014/23/BE, sipas dispozitave të nenit 40, paragrafi 2 të kësaj direktive. Kjo zgjidhje zbatohet edhe për rastet e përmendura në germën c të paragrafit të parë të nenit 2b të kësaj direktive;

7. në nenin 3, paragrafi 1 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"1. Komisioni mund të përdorë procedurën e parashikuar në paragrafin 2 deri në 5 kur, përpara lidhjes së një kontrate, ai gjykon se gjatë procedurës së prokurimit, që është brenda objektit të Direktivës 2014/24/BE ose Direktivës 2014/23/BE, është kryer një shkelje e rëndë e së drejtës së Bashkimit Evropian në fushën e prokurimit publik.

Neni 47

### **Ndryshimet e Direktivës 92/13/KEE**

Direktiva 92/13/KEE ndryshohet si më poshtë:

1. paragrafi 1 i nenit 1, zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"1. Kjo direktivë zbatohet për kontratat e përmendura në Direktivën 2014/25/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(37)</sup>, përveçse kur këto kontrata përjashtohen në përputhje me nenet 18 deri në 24, 27 deri 30, 34 ose 55 të kësaj direktive.

Kontratat, sipas kuptimit të kësaj direktive, përfshijnë kontratat e furnizimit, të punëve dhe të shërbimit, koncesionet e punëve dhe shërbimeve, marrëveshjet kuadër dhe sistemet dinamike të blerjes.

Kjo direktivë gjithashtu zbatohet për koncesionet që jepen nga subjektet kontraktore, të përmendura në Direktivën 2014/23/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit <sup>(38)</sup>, përveçse kur këto kontrata përjashtohen në përputhje me nenet 10, 12, 13, 14, 16, 17 dhe 25 të asaj direktive.

Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme për të garantuar që, në lidhje me kontratat që përfshihen në fushën e zbatimit të Direktivës 2014/25/BE ose Direktivës 2014/23/BE, vendimet e marra nga subjektet kontraktore të mund të shqyrtohen me efikasitet, dhe në veçanti, sa më shpejt të jetë e mundur, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenet 2 deri në 2f të kësaj direktive, në rastet kur këto vendime kanë shkelur të drejtën e Bashkimit Evropian në fushën e prokurimit ose rregullat kombëtare që transpozojnë këtë të drejtë.

2. paragrafi 2 i nenit 2a, ndryshohet si më poshtë:

a) nënparagrafi i parë zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

Pas vendimit për dhënien e kontratës, të përfshirë në fushën e zbatimit të Direktivës 2014/25/BE ose Direktivës 2014/23/BE, kontrata nuk mund të lidhet pa mbaruar periudha prej të paktën 10 ditësh kalendarike, që fillon nga e nesërmja e datës në të cilën vendimi për dhënien e kontratës i dërgohet ofertuesve dhe kandidatëve të interesuar, nëse përdoret faksi ose mjetet elektronike, ose, nëse përdoren mjete të tjera komunikimi, pa mbaruar periudha prej të paktën 15 ditësh kalendarike, që fillon nga e nesërmja e datës në të cilën vendimi për dhënien e kontratës i dërgohet ofertuesve dhe kandidatëve të interesuar, ose pa mbaruar periudha prej të paktën 10 ditësh kalendarike, që fillon nga e nesërmja e datës së marrjes së vendimit për dhënien e kontratës.";

b) në nënparagrafin e katërt, ndarja e parë zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"— një përmbledhje e arsyeve përkatëse, të përcaktuara në nenin 75, paragrafi 2 të Direktivës 2014/25/BE, në zbatim të dispozitave të nenit 75, paragrafi 3 të asaj direktive, ose në nënparagrafin e dytë të nenit 40, paragrafi 1 të Direktivës 2014/23/BE, në zbatim të dispozitave të nenit 40, paragrafi 2 të po asaj direktive dhe";

3. Neni 2b ndryshohet si më poshtë:

a) në paragrafin e parë:

i) germa a zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"a) kur Direktiva 2014/25/BE, ose sipas rastit, Direktiva 2014/23/BE nuk kërkon shpalljen paraprake të njoftimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*";

ii) germa c zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"c) në rastin kontratave specifike të bazuara në një sistem dinamik blerjeje, siç parashikohet në nenin 52 të Direktivës 2014/25/BE.

b) në paragrafin e dytë ndarja e parë dhe e dytë zëvendësohen me tekstin e mëposhtëm:

"— ka shkelje të nenit 52, paragrafi 6 të Direktivës 2014/25/BE, dhe

— vlera e kontratës parashikohet të jetë e barabartë me ose të tejkalojë kufijtë e paraqitur në nenin 15 të Direktivës 2014/25/BE.";

4. në nenin 2c, teksti "Direktiva 2004/17/KE" zëvendësohet me tekstin "Direktiva 2014/25/BE ose Direktiva 2014/23/BE";

5. Neni 2d ndryshohet si më poshtë:

a) në paragrafin 1,

i) germa a zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"a) kur subjekti kontraktor ka dhënë një kontratë pa shpallje paraprake të njoftimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*, kur kjo nuk është e lejueshme në përputhje me Direktivën 2014/25/BE ose Direktivën 2014/23/BE";

ii) në germën b, teksti "Direktiva 2004/17/KE" zëvendësohet me tekstin "Direktiva 2014/25/BE ose Direktiva 2014/23/BE";

b) në paragrafin 4, ndarja e parë zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"\_\_ subjekti kontraktor konsideron se dhënia e një kontrate pa shpallje paraprake të njoftimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian* është e lejueshme në përputhje me Direktivën 2014/25/BE ose Direktivën 2014/23/BE";

c) në paragrafin 5, ndarja e parë zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"— autoriteti kontraktor konsideron se dhënia e kontratës është në përputhje me nenin 52 paragrafi 6 të Direktivës 2014/25/BE,";

6. në nenin 2f, paragrafi 1, germa a zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"a) përpara përfundimit të të paktën 30 ditëve kalendarike, që nisin nga e nesërmja e datës në të cilën:

\_\_ subjekti kontraktor ka shpallur njoftimin për shpalljen e fituesit të kontratës, në përputhje me nenet 70 dhe 71 të Direktivës 2014/25/BE ose me nenet 31 dhe 32 të Direktivës 2014/23/BE, nëse ky njoftim përfshin justifikimin e vendimit të subjektit kontraktor për të dhënë kontratën pa shpalljen paraprake të njoftimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*, ose

— subjekti kontraktor ka informuar ofertuesit dhe kandidatët e interesuar për lidhjen e kontratës, nëse ky informacion përmban një përmbledhje të arsyeve përkatëse, që përcaktohen në nenin 75, paragrafi 2 të Direktivës 2014/25/BE, në zbatim të dispozitave të nenit 75, paragrafi 3 të asaj direktive ose në nënparagrafin e dytë të nenit 40, paragrafi 1 të Direktivës 2014/23/BE, në zbatim të dispozitave të nenit 40, paragrafi 2 të asaj direktive. Kjo zgjidhje zbatohet edhe për rastet e përmendura në germën c të paragrafit të parë të nenit 2b të kësaj direktive;"

7. në nenin 8, paragrafi 1 zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

"1. Komisioni mund të kërkojë procedurën e përshkruar në pikat 2 deri në 5 kur, përpara lidhjes së një kontrate, ai gjykon se gjatë procedurës për dhënien e kontratës, që është brenda objektit të Direktivës 2014/25/BE ose Direktivës 2014/23/BE, ose në lidhje me nenin 26, paragrafi 1 të Direktivës 2014/25/BE në rastin e autoriteteve kontraktore për të cilat ajo

dispozitë gjen zbatim, është kryer një shkelje e rëndë e së drejtës së Bashkimit Evropian në fushën e prokurimit.

## **TITULLI V**

### **KOMPETENCAT E DELEGUARA, KOMPETENCAT ZBATUESE DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

Neni 48

#### **Ushtrimi i delegimit**

1. Komisionit i jepen kompetencat për të miratuar aktet e deleguara, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.
2. Kompetenca për të miratuar aktet e deleguara, të përmendura në nenin 7, paragrafi 3, nenin 9 paragrafi 4, nenin 27, paragrafi 2 dhe nenin 30, paragrafi 4, i jepet Komisionit për një periudhë kohore të përcaktuar, që nis më 17 prill 2014.
3. Delegimi i kompetencave, që përmenden në nenin 7, paragrafi 3, nenin 9, paragrafi 4, nenin 27, paragrafi 2 dhe nenin 30, paragrafi 4, mund të revokohet në çdo kohë nga Parlamenti Evropian ose nga Këshilli. Vendimi i revokimit i jep fund delegimit të kompetencave të specifikuara në atë vendim. Ai hyn në fuqi një ditë pas botimit të vendimit në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian* ose në një datë të mëvonshme që specifikohet në vendim. Ai nuk prek vlefshmërinë e ndonjë akti të deleguar të hyrë tashmë në fuqi.
4. Kur miraton një akt të deleguar, Komisioni njofton për këtë njëkohësisht Parlamentin Evropian dhe Këshillin.
5. Një akt i deleguar, i miratuar sipas nenit 7, paragrafi 3, nenit 9, paragrafi 4, nenit 27, paragrafi 2 dhe nenit, 30 paragrafi 4, hyn në fuqi vetëm nëse nuk është shprehur asnjë kundërshtim as nga Parlamenti Evropian as nga Këshilli, brenda një periudhe dymujore pasi Parlamenti Evropian ose Këshilli është njoftuar për këtë akt, ose nëse, përpara përfundimit të kësaj periudhe, Parlamenti Evropian dhe Këshilli kanë informuar Komisionin se nuk do të kundërshtojnë. Kjo periudhë shtyhet me dy muaj me nismën e Parlamentit Evropian ose të Këshillit.

Neni 49

#### **Procedura urgjente**

1. Aktet e deleguara, që miratohen sipas këtij neni, hyjnë në fuqi menjëherë dhe zbatohen për sa kohë që nuk shprehet asnjë kundërshtim në përputhje me paragrafin 2. Në njoftimin për aktin e deleguar, që i dërgohet Parlamentit Evropian dhe Këshillit, jepen arsyet për përdorimin e procedurës urgjente.
2. Parlamenti Evropian ose Këshilli mund të kundërshtojnë një akt të deleguar, në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 48, paragrafi 5. Në këtë rast, Komisioni shfuqizon aktin

menjëherë pasi njoftohet nga Parlamentit Evropian ose Këshilli rreth vendimit të tyre për ta kundërshtuar.

#### Neni 50

##### **Procedura e Komitetit**

1. Komisioni do të mbështetet nga Komiteti Këshillimor për Prokurim Publike, i krijuar me Vendimin e Këshillit 71/306/KEE <sup>(39)</sup>. Ky Komitet është një komitet sipas kuptimit të Rregullores (BE) nr. 182/2011.
2. Kur përmendet ky nen, gjen zbatim neni 4 i Rregullores (BE) nr. 182/2011.

#### Neni 51

##### **Transpozimi**

1. Shtetet anëtare miratojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat e nevojshme administrative për të siguruar përputhshmërinë me këtë direktivë, deri më 18 prill 2016. Ato i komunikojnë menjëherë Komisionit tekstin e këtyre dispozitave.

Shtetet anëtare, në miratimin e këtyre masave, i referohen direktivës ose i shoqërojnë ato me një referencë në rastin e botimit zyrtar të tyre. Shtetet anëtare përcaktojnë se si duhet të bëhet një referencë e tillë.

2. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e masave kryesore të legjislacionit të brendshëm që ato miratojnë në fushën që mbulon kjo direktivë.

#### Neni 52

##### **Dispozita kalimtare**

Referimet në germën a dhe b të nenit 1, paragrafi 3 të Direktivës 2004/17/KE dhe në nenin 1, paragrafi 3 dhe 4 dhe titullin III të Direktivës 2004/18/KE, do të konsiderohen si referime ndaj kësaj direktive.

#### Neni 53

##### **Monitorimi dhe raportimi**

Komisioni shqyrton efektet ekonomike në tregun e brendshëm, në veçanti në lidhje me faktorë të tillë si dhënia e kontratave ndërkufitare dhe kostot e transaksionit, që rezultojnë nga zbatimi i kufijve monetar të përcaktuar në nenin 8 dhe i raporton për këtë Parlamentit Evropian dhe Këshillit përpara datës 18 prill 2019. Përshtatshmëria e nivelit të kufijve monetarë shqyrtohet në kontekstin e negociatave, në zbatim të GPA-së, duke pasur parasysh ndikimin e inflacionit dhe kostove të transaksionit. Komisioni, aty ku është e mundur dhe e përshtatshme, sugjeron një rritje të kufijve monetarë, të zbatueshëm sipas GPA-së, gjatë raundit tjetër të negociatave.

Në rast të ndonjë ndryshimi të kufijve monetarë, të zbatueshëm sipas GPA-së, raporti, aty ku është e përshtatshme, duhet të ndiqet nga një propozim legjislativ që ndryshon kufijtë monetarë, të përcaktuar në këtë direktivë.

Komisioni shqyrton edhe efektet ekonomike në tregun e brendshëm të përjashtimeve të përcaktuara në nenin 12, duke marrë në konsideratë strukturat specifike të sektorit të ujit, dhe i raporton për këto Parlamentit Evropian dhe Këshillit përpara datës 18 prill 2019.

Komisioni rishikon funksionimin e kësaj direktive dhe i raporton Parlamentit Evropian dhe Këshillit përpara datës 18 prill 2021, si dhe çdo pesë vjet pas kësaj date, bazuar në informacionin e dorëzuar nga shtetet anëtare, në përputhje me nenin 45, paragrafi 3.

Komisioni bën publike rezultatet e shqyrtimit të kryer sipas paragrafit katër.

Neni 54

### **Hyrja në fuqi**

Kjo direktivë hyn në fuqi njëzetë ditë pas botimit të saj në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Kjo direktivë nuk zbatohet për dhënien e koncesioneve të tenderuara ose të dhëna përpara datës 17 prill 2014.

Neni 55

### **Marrësit**

Kjo direktivë u drejtohet shteteve anëtare.

Nënshkruar në Strasburg, më 26 shkurt 2014.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

M. SCHULZ

Për Këshillin

Presidenti

D. KOURKOULAS

---

<sup>(1)</sup> Gazeta Zyrtare C 191, 29.6.2012, f. 84.

<sup>(2)</sup> Gazeta Zyrtare C 391, 18.12.2012, f. 49.

<sup>(3)</sup> Qëndrimi i Parlamentit Evropian, datë 15 janar 2014, (ende i pabotuar në *Gazetën Zyrtare*) dhe vendimi i Këshillit, datë 11 shkurt 2014.

<sup>(4)</sup> Direktiva 2004/18/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 31 mars 2004, “Për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave publike për punë civile, kontratave publike të furnizimit dhe kontratave publike të shërbimit” (*Gazeta Zyrtare L 134*, 30.4.2004, f. 114).

<sup>(5)</sup> Direktiva 2006/123/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 12 dhjetor 2006, “Për shërbimet në tregun e brendshëm” (*Gazeta Zyrtare L 376*, 27.12.2006, f. 36).

<sup>(6)</sup> Direktiva 2009/73/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror” dhe për shfuqizimin e Direktivës 2003/55/KE (*Gazeta Zyrtare L 211*, 14.8.2009, f. 94).

(7) Direktiva 2009/72/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike” dhe për shfuqizimin e Direktivës 2003/54/KE (Gazeta Zyrtare L 211, 14.8.2009, f. 55).

(8) Direktiva 97/67/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 dhjetor 1997, “Për rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimeve postare në Komunitetin Evropian dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimit” (Gazeta Zyrtare L 15, 21.1.1998, f. 14).

(9) Direktiva 94/22/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 30 maj 1994, “Për kushtet për dhënien dhe përdorimin e autorizimeve për zbulimin, kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve” (Gazeta Zyrtare L 164, 30.6.1994 f. 3).

(10) Rregullorja (KE) nr. 1370/2007 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2007, “Për shërbimet publike të transportit të pasagjerëve, nëpërmjet transportit hekurudhor dhe rrugor” dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KEE) nr. 1191/69 dhe 1107/70 (Gazeta Zyrtare L 315, 3.12.2007, f. 1).

(11) Direktiva 2009/81/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të caktuara për punë, kontratave të furnizimit dhe kontratave të shërbimit nga autoritetet ose subjektet kontraktore, në fushat e mbrojtjes dhe të sigurisë” dhe që ndryshon Direktivën 2004/17/KE dhe Direktivën 2004/18/KE (Gazeta Zyrtare L 216, 20.8.2009, f. 76).

(12) Direktiva 2013/34/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, “Për pasqyrat financiare vjetore, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe raportet përkatëse të llojeve të caktuara të sipërmarrjeve”, që ndryshon Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon Direktivat e Këshillit 78/660/KEE dhe 83/349/KEE (Gazeta Zyrtare L 182, 29.6.2013, f. 19).

(13) Direktiva 2014/25/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimet postare” (shih faqen 243 të kësaj Gazete Zyrtare).

(14) Direktiva 2004/17/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 31 mars 2004, që koordinon procedurat e prokurimit për subjekte që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare (Gazeta Zyrtare L 134, 30.4.2004, f. 1).

(15) Direktiva 96/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 dhjetor 1996, “Për emërimin e punonjësve në kuadër të ofrimit të shërbimeve” (Gazeta Zyrtare L 18, 21.1.1997, f. 1).

(16) Direktiva e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989, “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me zbatimin e procedurave të shqyrtimit për dhënien e kontratave publike të furnizimeve dhe të punëve” (Gazeta Zyrtare L 395, 30.12.1989, f. 33).

(17) Direktiva e Këshillit 92/13/KEE, datë 25 shkurt 1992, “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e rregullave komunitare për procedurat e prokurimit të enteve që operojnë në sektorin e ujit, energjisë, transportit dhe telekomunikacioneve” (Gazeta Zyrtare L 76, 23.3.1992, p. 14).

(18) Direktiva 95/46/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 24 tetor 1995, “Për mbrojtjen e individëve lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” (Gazeta Zyrtare L 281, 23.11.1995, f. 31).

(19) Rregullorja nr. 182/2011 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 shkurt 2011, ku përcaktohen rregullat dhe parimet e përgjithshme për mekanizmat e kontrollit nga ana e shteteve anëtare të ushtrimit të kompetencave zbatuese nga Komisioni (Gazeta Zyrtare L 55, 28.2.2011, f. 13).

(20) Rregullorja (KE) nr. 1059/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 maj 2003, “Për krijimin e një klasifikimi të përbashkët të njësive territoriale për statistikat (NUTS)” (Gazeta Zyrtare L 154, 21.6.2003, f. 1).

(21) Direktiva 2014/24/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin publik” (shih faqen 65 të kësaj Gazete Zyrtare).

(22) Rregullorja (KE) nr. 1008/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e 24 shtator 2008, “Për rregullat e përbashkëta për operimin e shërbimeve ajrore në Komunitetin Evropian” (Gazeta Zyrtare L 293, 31.10.2008, f. 3).

(23) Direktiva 2010/13/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 10 mars 2010, “Për koordinimin e disa dispozitave të përcaktuara me ligj, rregullore ose akte administrative në shtetet anëtare lidhur me ofrimin e shërbimeve të medias audiovizive” (Direktiva për Shërbimet e Medias Audiovizive) (Gazeta Zyrtare L 95, 15.4.2010, f. 1).

(24) Direktiva e Këshillit 77/249/KEE, datë 22 mars 1977, “Për lehtësimin e ushtrimit efikas nga ana e avokatëve të lirisë për të ofruar shërbime” (Gazeta Zyrtare L 78, 26.3.1977, f. 17).

(25) Direktiva 2004/39/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 21 prill 2004, “Për tregjet e instrumenteve financiare”, që ndryshon Direktivat e Këshillit 85/611/KEE dhe 93/6/KEE dhe Direktivën 2000/12/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 93/22/KEE (Gazeta Zyrtare L 145, 30.4.2004, f. 1).

(<sup>26</sup>) Direktiva 2002/21/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 7 mars 2002, “Për një kuadër të përbashkët rregullator për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike” (Direktiva Kuadër) (Gazeta Zyrtare L 108, 24.4.2002, f. 33).

(<sup>27</sup>) Rregullorja (KE) nr. 2195/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 nëntorit 2002 për Fjalorin e Përbashkët të Prokurimeve (FPP) (Gazeta Zyrtare L 340, 16.12.2002, f. 1).

(<sup>28</sup>) Vendimi Kuadër i Këshillit 2008/841/ÇBD, datë 24 tetor 2008, “Për luftën kundër krimit të organizuar” (Gazeta Zyrtare L 300, 11.11.2008, f. 42).

(<sup>29</sup>) Gazeta Zyrtare C 195, 25.6.1997, f. 1.

(<sup>30</sup>) Vendimi Kuadër i Këshillit 2003/568/ÇBD, datë 22 korrik 2003, “Për luftën kundër korrupsionit në sektorin privat” (Gazeta Zyrtare L 192, 31.7.2003, f. 54).

(<sup>31</sup>) Gazeta Zyrtare C 316, 27.11.1995, f. 48.

(<sup>32</sup>) Vendimi Kuadër i Këshillit 2002/475/ÇBD, datë 13 qershor 2002, “Për luftën kundër terrorizmit” (Gazeta Zyrtare L 164, 22.6.2002, f. 3).

(<sup>33</sup>) Direktiva 2005/60/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 tetor 2005, “Për ndalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (Gazeta Zyrtare L 309, 25.11.2005, f. 15).

(<sup>34</sup>) Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 prill 2011, “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave prej tij”, dhe që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/ÇBD (Gazeta Zyrtare L 101, 15.4.2011, f. 1).

(<sup>35</sup>) Direktiva 2014/24/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin publik” (Gazeta Zyrtare L 94, 28.3.2014, f. 65).

(<sup>36</sup>) Direktiva 2014/23/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për dhënien e kontratës së koncesionit” (Gazeta Zyrtare L 94, 28.3.2014, f. 1).

(<sup>37</sup>) Direktiva 2014/25/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për prokurimin nga subjekte që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare” (Gazeta Zyrtare L 94, 28.3.2014, f. 243).

(<sup>38</sup>) Direktiva 2014/23/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Për dhënien e kontratës së koncesionit” (Gazeta Zyrtare L 94, 28.3.2014, f. 1).

(<sup>39</sup>) Vendimi i Këshillit 71/306/KEE, datë 26 korrik 1971, “Për ngritjen e Komitetit Këshillimor për Kontratat Publike për Punë” (Gazeta Zyrtare L 185, 16.8.1971, f. 15).

## SHTOJCA I

### LISTA E VEPRIMTARIVE TË PËRMENDURA NË PIKËN 7 TË NENIT 5 <sup>(1)</sup>

Rishikimi 1 i kodit NACE <sup>(2)</sup>					Kodi i FPP-së
SEKSIONI F			NDËRTIMI		
Ndarja	Grupi	Klasa	Objekti	Shënime	
45			Ndërtimi	Kjo ndarje përfshin: ndërtimin e ndërtesave dhe veprave të reja, restaurimin dhe riparime të zakonshme.	45000000
	45.1		Përgatitja e kantierit		45100000
		45.11	Shembja dhe trajtimi	Kjo klasë përfshin:	45110000



			<p>rrënojave, lëvizja dherave</p>	<p>e</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— shembjen e ndërtesave dhe strukturave të tjera,</li> <li>— pastrimin e kantierit të ndërtimit,</li> <li>— lëvizjen e dherave: gjurmimi, landfilli, nivelimi dhe gradimi i shesheve të ndërtimit, gjurmimi i hendekëve, zhvendosja e gurëve, shpërthimi, etj.,</li> <li>— përgatitjen e kantierit për shfrytëzim mineral,</li> <li>— zhvendosjen e mbingarkesave dhe zhvillimeve të tjera dhe përgatitjen e zonave dhe pronave minerare.</li> </ul> <p>Kjo klasë gjithashtu përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— ndërtimin e sistemit të kullimit të objektit,</li> <li>— kullimin e tokave bujqësore ose pyjore.</li> </ul>	
		45.12	<p>Shpimi provë dhe shpimi me sondë</p>	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— shpimin provë, shpimin provë me sondë dhe marrjen e mostrave kryesore për qëllime ndërtimi, gjeofizike, gjeologjike ose qëllime të ngjashme.</li> </ul> <p>Kjo klasë përjashton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— shpimin e puseve për prodhimin e naftës ose gazit, shih 11.20,</li> </ul>	45120000

				<ul style="list-style-type: none"> <li>— shpimin e puseve të ujit, shih 45.25,</li> <li>— gërmimin e puseve, shih 45.25,</li> <li>— kërkimin për fusha të naftës ose të gazit, studimin gjeofizik, gjeologjik dhe sizmik, shih 74.20.</li> </ul>	
	45.2		Ndërtim i ndërtesave të plota ose pjesëve të tyre; inxhinieri civile		45200000
		45.21	Ndërtimin e përgjithshëm të ndërtesave dhe veprave inxhinierike civile	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— ndërtimin e të gjitha llojeve të ndërtesave, ndërtimin e ndërtesave inxhinierike civile,</li> <li>— ura, duke përfshirë ato për autostrada të ngritura, viadukte, tunele dhe nënkalime,</li> <li>— tubacione të distancave të gjata, linja të komunikimit dhe të energjisë elektrike,</li> <li>— tubacione urbane, komunikimi urban dhe linja të energjisë elektrike,</li> <li>— vepra urbane ndihmëse,</li> <li>— montimi dhe ngritja e ndërtesave të parafabrikuara në vend.</li> </ul> <p>Kjo klasë përjashton:</p>	<p>45210000</p> <p>Përveç:</p> <p>– 45213316</p> <p>45220000</p> <p>45231000</p> <p>45232000</p>

				<ul style="list-style-type: none"> <li>— veprimtari shërbimi sipas rastit, për nxjerrjen e naftës dhe të gazit, shih 11.20,</li> <li>— ngritjen e ndërtesave të parafabrikuara të përfunduara nga pjesë të prodhuara vetë jo prej betoni, shih ndarjet 20, 26 dhe 28.</li> <li>— vepra ndërtimi, të ndryshme nga ndërtesat, për stadione, pishina, palestra, fusha tenisi, fusha golfi dhe instalime të tjera sportive, shih 45.23,</li> <li>— instalime të ndërtesës, shih 45.3,</li> <li>— përfundim ndërtese, shih 45.4,</li> <li>— veprimtari arkitekturore dhe inxhinierike, shih 74.20,</li> <li>— menaxhim projekti për ndërtim, shih 74.20.</li> </ul>	
		45.22	Ngritja e mbulimit të tarracës dhe e karabinasë	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— ngritjen e çatisë,</li> <li>— mbulimin me çati,</li> <li>— izolimin nga uji.</li> </ul>	45261000
		45.23	Ndërtimi i autostradave, rrugëve, aeroporteve dhe objekteve sportive.	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— ndërtimin e autostradave, rrugëve, rrugëve të tjera për automjete dhe këmbësorë,</li> <li>— ndërtimin e hekurudhave,</li> <li>— ndërtimin e pistave të aeroporteve,</li> </ul>	<p>45212212 dhe DA03 45230000 përveç: – 45231000 – 45232000 – 45234115</p>

				<ul style="list-style-type: none"> <li>— vepra ndërtimi, të ndryshme nga ndërtesat, për stadione, pishina, palestra, fusha tenisi, fusha golfi dhe instalime të tjera sportive,</li> <li>— vendosjen e sinjalistikës horizontale në rrugë dhe parqe makinash.</li> </ul> <p>Kjo klasë përjashton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— zhvendosjen paraprake të dherave, shih 45.11.</li> </ul>	
		45.24	Ndërtimi i projekteve të ujit	<p>Kjo klasë përfshin ndërtimin e:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— rrugëve ujore, limaneve dhe veprave lumore, porteve të jahteve, portave, etj.,</li> <li>— digave dhe pritave,</li> <li>— punëve të thellimit me dragë,</li> <li>— punëve të nënsipërfaqes.</li> </ul>	45240000
		45.25	Punë ndërtimi të tjera që përfshijnë zanate të veçanta	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— veprimtari ndërtimi të specializuara në një aspekt të përbashkët për lloje të ndryshme strukturash që kërkojnë aftësi ose pajisje të specializuara,</li> <li>— ndërtimin e themeleve, duke përfshirë vendosjen e shtyllave,</li> <li>— shpimin dhe ndërtimin e puseve të ujit, gjurmimin e puseve,</li> </ul>	45250000 45262000

				<ul style="list-style-type: none"> <li>— ngritjen e elementeve të çelikut, që nuk prodhohen vetë,</li> <li>— përkuqjen e çelikut,</li> <li>— shtrimin e tullave dhe vendosjen e gurëve,</li> <li>— ngritjen dhe çmontimin e skelave dhe platformave të punës, duke përfshirë marrjen me qira të skelave dhe platformës së punës.</li> <li>— ngritjen e oxhaqeve dhe furrave industriale.</li> </ul> <p>Kjo klasë përjashton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— marrjen me qira të skelave pa ngritje dhe çmontim, shih 71.32.</li> </ul>	
	45.3		Instalimet e ndërtesës		45300000
		45.31	Instalimi i rrjeteve dhe montimeve elektrike	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <p>instalimin në ndërtesa ose projekte të tjera ndërtimi të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— rrjeteve dhe montimeve elektrike,</li> <li>— sistemeve të telekomunikacionit,</li> <li>— sistemeve elektrike të ngrohjes,</li> <li>— antenave rezidenciale,</li> <li>— alarmeve të zjarrit,</li> </ul>	<p>45213316</p> <p>45310000</p> <p>Përveç:</p> <p>– 45316000</p>

				<ul style="list-style-type: none"> <li>— sistemeve të alarmit kundër vjedhjes,</li> <li>— ashensorëve dhe shkallëve lëvizëse,</li> <li>— rrufepritësve, etj.</li> </ul>	
		45.32	Veprimtari të punës izoluese	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— instalimin në ndërtesë ose projekte të tjera të ndërtimit, të izolimit termik, akustik ose kundër dridhjes.</li> </ul> <p>Kjo klasë përjashton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— izolimin kundër ujit, shih 45.22.</li> </ul>	45320000
		45.33	Punë hidraulike	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— instalimin në ndërtesa ose projekte të tjera ndërtimi të:</li> <li>— pajisjeve hidraulike dhe sanitare,</li> <li>— montimeve të gazit,</li> <li>— pajisjeve për ngrohje, ajrosje, ftohje ose ajër të kondicionuar,</li> <li>— sistemeve të spërkatësve kundër zjarrit.</li> </ul> <p>Kjo klasë përjashton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— instalimin e sistemeve elektrike të ngrohjes, shih 45.31.</li> </ul>	45330000
		45.34	Instalime të tjera të ndërtesës	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— instalimin e sistemeve të ndriçimit dhe sinjalizimit për</li> </ul>	45234115 45316000 45340000

				<p>rrugë, hekurudha, aeroporte dhe porte,</p> <p>— instalimin në ndërtesa ose projekte të tjera të ndërtimit, të montimeve dhe pajisjeve, të paspecifikuara diku tjetër.</p>	
	45.4		Përfundimi i ndërtesës		45400000
		45.41	Suvatimi	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <p>— vendosjen në ndërtesa ose projekte të tjera ndërtimi të suvatimit ose stukimit të brendshëm dhe të jashtëm, duke përfshirë veshjen me listela.</p>	45410000
		45.42	Instalime zdrukthëtarie	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <p>— instalimin e dyerve, dritareve, kornizave të dyerve dhe të dritareve që nuk prodhohen vetë, kuzhinat e montuara, shkallët, montimet e dyqaneve dhe të ngjashme me këto, prej druri ose prej materialeve të tjera,</p> <p>— kompletimin e ambienteve të brendshme si tavanet, mbulesa muresh prej druri, ndarje të lëvizshme, etj.</p> <p>Kjo klasë përjashton:</p> <p>— shtrimin e parketit dhe të mbulesave të tjera të dysHEMEVE prej druri, shih 45.43.</p>	45420000

		45.43	Mbulim dysHEMEJE dhe muri	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— shtrimin, vënien, varjen ose montimin në ndërtesa ose projekte të tjera ndërtimi, të:</li> <li>— mureve të qeramikës, betonit ose gurit të prerë ose pllakave të dyshemesë,</li> <li>— parketin dhe mbulesa të tjera të dyshemesë prej druri, mbulesat me qilima ose linoleum,</li> <li>— përfshirë ato prej gome ose plastike,</li> <li>— mbulesa dysHEMEJE ose muri prej teracoje, mermeri, graniti ose ardëze,</li> <li>— letër muri.</li> </ul>	45430000
		45.44	Lyerja dhe vendosja e xhamave	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— lyerjen e pjesëve të brendshme dhe të jashtme të ndërtesave,</li> <li>— lyerjen e strukturave inxhinierike civile,</li> <li>— instalimin e xhamave, pasqyrave, etj.</li> </ul> <p>Kjo klasë përjashton:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— instalimin e dritareve, shih 45.42.</li> </ul>	45440000
		45.45	Përfundime të tjera të ndërtimit	<p>Kjo klasë përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>— instalimin e pishinave private,</li> </ul>	45212212 dhe DA04 45450000



				<p>— pastrimin me avull, lëmim dhe veprimtari të ngjashme për pjesë të jashtme të ndërtesës,</p> <p>— punë të tjera për përfundimin e ndërtimit, të paklasifikuara diku tjetër.</p> <p>Kjo klasë përjashton:</p> <p>— pastrimin e brendshëm të ndërtesave dhe strukturave të tjera, shih 74.70.</p>	
	45.5		Marrja me qira e pajisjeve të ndërtimit ose shembjes me përdorues		45500000
		45.50	Marrja me qira e pajisjeve të ndërtimit ose shembjes me përdorues	<p>Kjo klasë përjashton:</p> <p>— marrjen me qira të makinerive të ndërtimit ose të shembjes pa përdorues, shih 71.32.</p>	45500000

(<sup>1</sup>) Në rast të ndonjë ndryshimi në interpretimin e FPP-së dhe kodit NACE, zbatohet nomenklatura e FPP-së.

(<sup>2</sup>) Rregullorja e Këshillit (KEE) nr. 3037/90, datë 9 tetor 1990, "Për klasifikimin statistikor të veprimtarive ekonomike në Komunitetin Evropian" (Gazeta Zyrtare L 293, 24.10.1990, f. 1).

## SHTOJCA II

### VEPRIMTARITË QË USHTROHEN NGA SUBJEKTET KONTRAKTORE, TË PËRMENDURA NË NENIN 7

Dispozitat e kësaj direktive, që rregullojnë koncesionet që jepen nga subjektet kontraktore, zbatohen për veprimtaritë e mëposhtme:

1. Në lidhje me gazin dhe ngrohjen:

- a) ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut shërbime për prodhimin, transportin a shpërndarjen e gazit ose ngrohjes;

b) furnizimin me gaz ose ngrohje në këto rrjete fikse

Furnizimi i gazit ose ngrohjes për rrjete fikse që ofrojnë shërbim për publikun, nga një subjekt kontraktor i përmendur në germa b dhe c të nenit 7, paragrafi 1, nuk konsiderohet si një nga veprimtaritë e përmendura në paragrafin 1, kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- i) prodhimi i gazit ose ngrohjes nga ai subjekt kontraktor është pasojë e pashmangshme e kryerjes së një veprimtarie, të ndryshme nga ato që përmende në këtë paragraf ose në paragrafët 2 dhe 3 të kësaj shtojce;
- ii) qëllimi i furnizimit të rrjetit publik është vetëm për të përdorur prodhimin për qëllime ekonomike dhe kur ai nuk tejkalon 20 % të xhiros mesatare të subjektit kontraktor për tre vitet e fundit, duke përfshirë vitin aktual.

Për qëllimet e kësaj direktive, "furnizim" përfshin gjenerimin/prodhimin, shitjen me shumicë dhe me pakicë të gazit. Megjithatë, prodhimi i gazit përmes nxjerrjes së tij, përfshihet në fushën e zbatimit të paragrafit 4 të kësaj shtojce.

## 2. Në lidhje me energjinë elektrike:

- a) ofrimin ose përdorimin e rrjeteve, që kanë për qëllim t'i ofrojnë publikut shërbime për prodhimin, transportin a shpërndarjen e energjisë elektrike;
- b) furnizimin e këtyre rrjeteve fikse me energji elektrike.

Për qëllimet e kësaj direktive, furnizimi i energjisë elektrike përfshin gjenerimin/prodhimin, shitjen me shumicë dhe me pakicë të energjisë elektrike.

Furnizimi i energjisë elektrike për rrjete që ofrojnë shërbim për publikun, nga një subjekt kontraktor i përmendur në germa b dhe c të nenit 7, paragrafi 1, nuk konsiderohet si një nga veprimtaritë e përmendura në paragrafin 1, kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) prodhimi i energjisë elektrike nga subjekti kontraktor bëhet sepse konsumi i saj është i nevojshëm për kryerjen e një veprimtarie, të ndryshme nga ato që përmenden në këtë paragraf ose në paragrafët 1 dhe 3 të kësaj shtojce;
- b) furnizimi i rrjetit publik varet vetëm nga konsumi vetjak i atij subjekti kontraktor dhe nuk tejkalon 30% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë nga subjekti kontraktor, mbi bazën e mesatares për tre vitet e fundit, duke përfshirë vitin aktual.

## 3. Veprimtaritë që lidhen me ofrimin ose shfrytëzimin e rrjeteve, që i ofrojnë publikut shërbime në fushën e transportit nëpërmjet hekurudhave, sistemeve automatike, tramvajit, trolejbusëve, autobusëve ose teleferikëve.

Në lidhje me shërbimet e transportit, një rrjet konsiderohet se ekziston atëherë kur shërbimi ofrohet sipas kushteve të punës të parashikuara nga një autoritet kompetent i një shteti anëtar, të tilla si kushtet për linjat e transportit dhe kapacitetin që ofrohet ose shpeshstinë e shërbimit.

4. Veprimtaritë që lidhen me shfrytëzimin e një zone gjeografike me qëllim vënien në dispozicion të një aeroporti, porti detar ose të brendshëm ose ambienteve të tjera të terminaleve për mjetet e transportit ajror, detar ose tokësor.

5. Veprimtaritë që lidhen me ofrimin e:

a) shërbimeve postare

b) shërbime të tjera të ndryshme nga ato postare, me kusht që shërbimet të ofrohen nga një subjekt, i cili ofron edhe shërbimet postare të përmendura në pikën ii) të nënparagrafit të dytë të këtij paragrafi dhe nëse kushtet e përcaktuara në nenin 34, paragrafi 1 të Direktivës 2014/25/BE nuk përmbushen në lidhje me shërbimet që përfshihen në pikën ii) të nënparagrafit të dytë.

Për qëllimin e kësaj direktive dhe pa cenuar Direktivën 97/67/KE:

i) "artikull postar" është një artikull i adresuar në formën përfundimtare, në të cilën do të transportohet, pavarësisht peshës. Përveç artikujve të korrespondencës, artikuj të tillë përfshijnë, për shembull, libra, katalogë, gazeta, botime periodike dhe pako postare që përmbajnë mall me ose pa vlerë tregtare, pavarësisht peshës;

ii) "shërbime postare" janë shërbimet që kanë të bëjnë me zhdoganimin, klasifikimin, përcaktimin e itinerareve dhe dorëzimin e artikujve postarë. Kjo përfshin shërbimet që klasifikohen dhe shërbimet që nuk klasifikohen si objekt i shërbimit universal të krijuar në përputhje me Direktivën 97/67/KE;

iii) "shërbime të tjera të ndryshme nga shërbimet postare" janë shërbimet që ofrohen në fushat e mëposhtme:

— shërbimet për menaxhimin e shërbimit postar (shërbimet përpara dhe pas dorëzimit, duke përfshirë shërbimet e menaxhimit të zyrës së postës),

— shërbime në lidhje me artikujt postarë që nuk përfshihen në germën a, si p.sh. postë e drejtpërdrejtë që nuk ka adresë.

6. Veprimtari që lidhen me shfrytëzimin e një zone gjeografike me qëllimin e:

a) nxjerrjes së naftës ose të gazit;

b) kërkimit ose nxjerrjes së qymyrit dhe lëndëve djegëse të ngurta.

---

### SHTOJCA III

#### LISTA E AKTEVE LIGJORE TË BASHKIMIT EVROPIAN, TË PËRMENDURA NË GERMËN B TË NENIT 7, PARAGRAFI 2

Të drejta që janë dhënë me anë të një procedure ku është garantuar publiciteti i përshtatshëm dhe ku dhënia e këtyre të drejtave është bazuar mbi kritere objektive, nuk përbëjnë "të drejta të veçanta ose ekskluzive" sipas kuptimit të kësaj direktive. Në vijim paraqiten procedurat që garantojnë transparencë paraprake të përshtatshme për të dhënë autorizime mbi bazën e akteve të tjera ligjore të Bashkimit Evropian, që nuk përbëjnë "të drejta të veçanta ose ekskluzive", sipas kuptimit të kësaj direktive:

- a) Dhënia e autorizimit për të përdorur instalime të gazit natyror, në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 4 të Direktivës 2009/73/KE;
- b) Autorizimi ose ftesa për të paraqitur një ofertë për ndërtimin e instalimeve të reja për prodhimin e energjisë elektrike, në përputhje me Direktivën 2009/72/KE;
- c) Në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenin 9 të Direktivës 97/67/KE, dhënia e autorizimeve në lidhje me një shërbim postar që nuk është ose nuk duhet të jetë i rezervuar;
- d) Një procedurë për dhënien e autorizimit për të vazhduar një veprimtari që lidhet me shfrytëzimin e hidrokarbureve në përputhje me Direktivën 94/22/KE;
- e) Kontratat publike të shërbimit sipas kuptimit të Rregullores (KE) nr. 1370/2007 për ofrimin e shërbimeve të transportit publik të pasagjerëve me autobus, tramvaj, hekurudhë ose metro, që janë dhënë mbi bazën e procedurës konkurruese të prokurimit në përputhje me nenin 5, paragrafi 3, me kusht që kohëzgjatja të jetë në përputhje me nenin 4, paragrafi 3 ose 4 të kësaj rregulloreje.

### SHTOJCA IV

#### SHËRBIMET E PËRMENDURA NË NENIN 19

Përshkrimi	Kodi i FPP-së
79611000-0; 75200000-8; 75231200-6; 75231240-8; 79622000-0 [Shërbime të furnizimit të personelit ndihmës në shtëpi]; 79624000-4 [Shërbime të furnizimit të personelit të infermierisë] dhe 79625000-1 [Shërbime të furnizimit të personelit mjekësor] nga 85000000-9 deri në 85323000-9; 85143000-3, 98133100-5, 98133000-4 dhe 98200000-5 dhe 98500000-8 [Njësi ekonomike familjare private me persona të	Shërbime shëndetësore, sociale dhe shërbime të lidhura me to

<p>punësuar] dhe 98513000-2 deri 98514000-9 [Shërbime të forcës punëtore për njësi ekonomike familjare, shërbime stafi nga agjencia për njësitë ekonomike familjare, shërbim stafi sekretarie për njësitë ekonomike familjare, staf i përkohshëm për njësitë ekonomike familjare, shërbime për ndihmë në shtëpi dhe shërbime shtëpiake],</p>	
<p>85321000-5 dhe 85322000-2, 75000000-6 [Shërbime në fushën e administratës, mbrojtjes dhe sigurimeve shoqërore], 75121000-0, 75122000-7, 75124000-1; nga 79995000-5 deri 79995200-7; nga 80000000-4 Shërbime formimi dhe trajnimi deri 80660000-8; nga 92000000-1 deri 92342200-2; nga 92360000-2 deri 92700000-8; 79950000-8 [Shërbime për organizim ekspozite, panairi dhe kongresi], 79951000-5 [Shërbime për organizim seminari], 79952000-2 [Shërbime aktivitetesh], 79952100-3 [Shërbime për organizim aktiviteti kulturor], 79953000-9 [Shërbime për organizim festivali], 79954000-6 [Shërbime për organizim feste], 79955000-3 [Shërbime për organizim të shfaqjeve të modës], 79956000-0 [Shërbime për organizim panairi dhe ekspozite]</p>	<p>Shërbime administrative, sociale, arsimore, shëndetësore dhe kulturore</p>
<p>75300000-9</p>	<p>Shërbime të sigurimeve shoqërore të detyrueshme <sup>(1)</sup></p>
<p>75310000-2, 75311000-9, 75312000-6, 75313000-3, 75313100-4, 75314000-0, 75320000-5, 75330000-8, 75340000-1</p>	<p>Shërbime përfitimi</p>
<p>98000000-3; 98120000-0; 98132000-7; 98133110-8 dhe 98130000-3</p>	<p>Shërbime të tjera komunitare, sociale dhe personale, duke përfshirë shërbimet e ofruara nga sindikatat, organizatat politike, shoqatat rinore dhe shërbime të tjera për anëtarë të organizatave.</p>
<p>98131000-0</p>	<p>Shërbime fetare</p>
<p>55100000-1 deri 55410000-7; 55521000-8 deri 55521200-0 [55521000-8 Shërbime katering për njësi ekonomike familjare private, 55521100-9</p>	<p>Shërbimet e hotelerisë dhe restoranteve</p>

<p>Shërbimet e ushqimit në kioska, 55521200-0 Shërbimi i shpërndarjes së ushqimit].</p> <p>55520000-1 Shërbime katering, 55522000-5 Shërbime katering për ndërmarrje transporti, 55523000-2 Shërbime katering për ndërmarrje të tjera ose institucione të tjera, 55524000-9 Shërbime katering në shkollë</p> <p>55510000-8 Shërbime në mensë, 55511000-5 Shërbime në mensë ose kafene të tjera me klientelë të kufizuar, 55512000-2 Shërbime të menaxhimit të mensës, 55523100-3 Shërbime të ushqimit në shkollë</p>	
<p>79100000-5 deri 79140000-7; 75231100-5;</p>	<p>Shërbime ligjore, deri në masën që nuk përjashtohen sipas nenit 10, paragrafi 8, germa d</p>
<p>75100000-7 deri 75120000-3; 75123000-4; 75125000-8 deri 75131000-3</p>	<p>Shërbime të tjera administrative dhe shërbime shtetërore</p>
<p>75200000-8 deri 75231000-4</p>	<p>Ofrimi i shërbimeve për komunitetin</p>
<p>75231210-9 deri 75231230-5; 75240000-0 deri 75252000-7; 794300000-7; 98113100-9</p>	<p>Shërbime që lidhen me burgun, sigurinë publike dhe shërbime shpëtimi, deri në masën që nuk përjashtohen sipas germës g të nenit 10, paragrafi 8</p>
<p>79700000-1 deri 79721000-4 [Shërbime hetimi dhe sigurie, shërbime sigurie, shërbime sinjalizimi-monitorimi, shërbime të ruajtjes, shërbime mbikëqyrjeje, shërbime të sistemeve gjurmuese, shërbime të gjurmimit të të arratisurit, shërbime patrulle, shërbime për lëshimin e kartave identifikuese, shërbime hetimi dhe shërbime të agjencive detektive]</p> <p>79722000-1[Shërbime grafologjie], 79723000-8 [Shërbime të analizimit të mbetjeve]</p>	<p>Shërbimet hetimore dhe të sigurisë</p>
<p>64000000-6 [Shërbime postare dhe të telekomunikacionit], 64100000-7 [Shërbime poste dhe dërgese], 64110000-0 [Shërbime postare], 64111000-7 [Shërbime postare të lidhura me gazetën dhe botimet periodike], 64112000-4 [Shërbimet postare për letrat], 64113000-1 [Shërbimet postare për pakot], 64114000-8 [Shërbimet në zyrat</p>	<p>Shërbimet postare</p>

postare], 64115000-5 [Dhënia me qira e kutisë postare], 64116000-2 [Shërbimet e postës restante], 64122000-7 [Shërbime të postës dhe korrierit brenda zyrës]	
50116510-9 [Shërbime për riveshje gome], 71550000-8 [Shërbime farkëtarie]	Shërbime të ndryshme
98900000-2 [Shërbime që ofrohen nga organizata dhe organe ekstra-territoriale] dhe 98910000-5 [Shërbime specifike për organizata dhe organe ndërkombëtare]	Shërbime ndërkombëtare

(<sup>1</sup>) Këto shërbime nuk mbulohen nga kjo direktivë kur ato organizohen si shërbime joekonomike me interes të përgjithshëm. Shtetet anëtare janë të lira të organizojnë ofrimin e shërbimeve shoqërore të detyrueshme ose të shërbimeve të tjera, si shërbimet me interes të përgjithshëm ose shërbimet joekonomike me interes të përgjithshëm.

## SHTOJCA V

### INFORMACIONET QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË NJOFTIMET E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË PËRMENDURA NË NENIN 31

1. Emri, numri i identifikimit (kur parashikohet nga legjislacioni i brendshëm), adresa, duke përfshirë kodin NUTS, numri i telefonit, numri i faksit, adresa e postës elektronike dhe faqja e internetit të autoritetit ose subjektit kontraktor, si dhe, e shërbimit nga ku mund të merren informacione shtesë.
2. Lloji i autoritetit ose subjektit kontraktor dhe veprimtaria kryesore që ushtron.
3. Nëse aplikimet duhet të përmbajnë oferta, adresa e postës elektronike ose faqja e internetit, në të cilën gjendjen dokumentet e koncesionit, për të cilat ka liri shikimi të pakufizuar, të plotë dhe të drejtpërdrejtë, pa pagesë. Kur nuk ofrohet liri shikimi e pakufizuar, e plotë, e drejtpërdrejtë dhe pa pagesë, në rastet që përmenden në nenin 34, paragrafi 2, atëherë tregohet mënyra se si mund të gjenden dokumentet e prokurimit.
4. Përshkrimi i koncesionit: natyra dhe volumi e punëve, natyra dhe gama e shërbimeve, rendi i madhësisë ose vlera treguese, dhe, kur është e mundur, kohëzgjatja e kontratës. Kur koncesioni ndahet në lote, ky informacion jepet për secilin lot. Përshkrimi i çdo opsioni, sipas rastit.
5. Kodet e FPP-së. Kur koncesioni ndahet në lote, ky informacion jepet për secilin lot.
6. Kodi NUTS për vendndodhjen kryesore të punëve në rastin e koncesioneve për punë ose kodi NUTS për vendin kryesor për koncesionet e ofrimit të shërbimit; kur koncesioni ndahet në lote, ky informacion jepet për secilin lot.

7. Kushtet për pjesëmarrje, duke përfshirë:
- a) sipas rastit, të tregohet nëse kontrata e koncesionit kufizohet në organizatat që punësojnë persona me aftësi të kufizuara ose nëse zbatimi i saj kufizohet në kuadrin e programeve të sigurisë në punë.
  - b) sipas rastit, të tregohet nëse ofrimi i shërbimit është e drejtë e rezervuar me ligj, rregullore ose dispozitë administrative për një profesion të veçantë; përmendet ligji, rregullorja ose dispozita administrative përkatëse;
  - c) një listë dhe përshkrim i shkurtër i kritereve të përzgjedhjes, kur është e zbatueshme; nivelet minimale të standardeve që mund të kërkohen; cilësimi i informacionit që kërkohet (vetë-deklarime, dokumentacion).
8. Afati kohor për dorëzimin e aplikimeve ose për pranimin e ofertave;
9. Kriteret që do të zbatohen për dhënien e koncesionit kur ato nuk tregohen në dokumentet e tjera të koncesionit.
10. Data e dërgimit të njoftimit.
11. Emri dhe adresa e organit përgjegjës për apelimin dhe, kur është e përshtatshme, për procedurat e ndërmjetësimit. Informacion i saktë në lidhje me afatin kohor për dorëzimin e apelimeve ose, nëse është e nevojshme, emri, adresa, numri i telefonit, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike të shërbimit nga ku mund të merret ky informacion.
12. Kushtet e veçanta të cilave u nënshtrohet zbatimi i kontratës së koncesionit, nëse ka.
13. Adresa ku do të dërgohen aplikimet ose ofertat.
14. Kur është e përshtatshme, tregohen kërkesat dhe rregullat që lidhen me përdorimin e mjeteve elektronike të komunikimit.
15. Informacion nëse koncesioni lidhet ose jo me një projekt dhe/ose program të financuar nga Bashkimi Evropian.
16. Për koncesionet për punë, tregohet nëse koncesioni mbulohet nga GPA-ja.

---

## SHTOJCA VI

### **INFORMACIONET QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË NJOFTIMET PARAPRAKE TË INFORMACIONIT, NË LIDHJE ME KONCESIONET PËR SHËRBIME SOCIALE DHE SHËRBIME TË TJERA SPECIFIKE, TË PËRMENDURA NË NENIN 31, PARAGRAFI 3**



1. Emri, numri i identifikimit (kur parashikohet nga legjislacioni i brendshëm), adresa, duke përfshirë kodin NUTS, numri i telefonit, numri i faksit, adresa e postës elektronike dhe faqja e internetit të autoritetit ose subjektit kontraktor, si dhe e shërbimit nga ku mund të merren informacione shtesë.
2. Kur është e përshtatshme, adresa e postës elektronike ose faqja e internetit ku mund të gjenden specifikimet dhe çdo dokument mbështetës.
3. Lloji i autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor dhe veprimtaria kryesore që ushtron.
4. Kodet e FPP-së; kur kontrata ndahet në lote, ky informacion jepet për secilin lot.
5. Kodi NUTS për vendin kryesor të lëvrimit ose realizimit të koncesioneve të shërbimit.
6. Përshkrimi i shërbimeve, rendi tregues i madhësisë ose vlera.
7. Kushtet për pjesëmarrje.
8. Kur është e zbatueshme, afatet kohore për të kontaktuar autoritetin kontraktor ose subjektin kontraktor në lidhje me pjesëmarrjen.
9. Kur është e zbatueshme, përshkrim i shkurtër i tipareve kryesore të procedurës së prokurimit që do të zbatohet.
10. Çdo informacion tjetër përkatës.

---

## **SHTOJCA VII**

### **INFORMACIONET QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË NJOFTIMET PËR SHPALLJEN E FITUESIT TË KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË PËRMENDURA NË NENIN 32**

1. Emri, numri i identifikimit (kur parashikohet nga legjislacioni i brendshëm), adresa, duke përfshirë kodin NUTS, dhe, kur është e përshtatshme, numri i telefonit, numri i faksit, adresa e postës elektronike dhe faqja e internetit të autoritetit ose subjektit kontraktor, si dhe e shërbimit nga ku mund të merren informacione shtesë.
2. Lloji i autoritetit ose subjektit kontraktor dhe veprimtaria kryesore që ushtron.
3. Kodet e FPP-së.
4. Kodi NUTS për vendndodhjen kryesore të punëve, në rastin e koncesioneve të punëve, ose kodi NUTS për vendin kryesor të zbatimit, në rastin e koncesioneve të shërbimit;

5. Përshkrimi i koncesionit: natyra dhe volumi i punëve, natyra dhe gama e shërbimeve, kohëzgjatja e kontratës. Kur koncesioni ndahet në lote, ky informacion jepet për secilin lot. Përshkrimi i çdo opsioni, sipas rastit.
6. Përshkrimi i procedurës së prokurimit që përdoret, në rastin e prokurimit pa shpallje paraprake, justifikimi.
7. Kriteret e përmendura në nenin 41, që u përdorën për dhënien e koncesionit ose koncesioneve.
8. Data e vendimit ose vendimeve për dhënien e koncesionit.
9. Numri i ofertave të marra në lidhje me çdo prokurim, duke përfshirë:
  - a) numrin e ofertave të marra nga operatorë ekonomikë, që janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme;
  - b) numrin e ofertave të marra nga jashtë;
  - c) numrin e ofertave të marra në mënyrë elektronike.
10. Për çdo prokurim, emrin, adresën, duke përfshirë kodin NUTS, dhe, aty ku është e përshtatshme, numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e postës elektronike dhe faqen e internetit të ofertuesve të suksesshëm, duke përfshirë:
  - a) informacionin nëse ofertuesi i suksesshëm është një ndërmarrje e vogël dhe e mesme;
  - b) informacionin nëse kontrata e koncesionit i është dhënë një konsorciumi.
11. Vlerën dhe kushtet kryesore financiare të koncesionit të dhënë, duke përfshirë:
  - a) çmimet e tarifave dhe gjobat, nëse ka;
  - b) shpërblimet dhe pagesat, nëse ka;
  - c) çdo detaj tjetër në lidhje me vlerën e koncesionit, siç përcaktohet në nenin 8, paragrafi 3.
12. Informacion nëse koncesioni ka lidhje ose jo me një projekt dhe/ose program të financuar nga fondet e Bashkimit Evropian.
13. Emri dhe adresa e organit përgjegjës për shqyrtimin dhe, kur është e përshtatshme, për procedurat e ndërmjetësimit. Informacion i saktë në lidhje me afatin për procedurat e shqyrtimit ose, nëse është e nevojshme, emri, adresa, numri i telefonit, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike të shërbimit nga ku mund të merret ky informacion.

14. Datat dhe referencat e botimeve të mëparshme në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian* që lidhen me koncesionet e shpallura në këtë njoftim.
15. Data e dërgimit të njoftimit.
16. Metoda që përdoret për të llogaritur vlerën e parashikuar të koncesionit, nëse nuk specifikohet në dokumentet e tjera të koncesionit në përputhje me nenin 8.
17. Çdo informacion tjetër përkatës.

---

### **SHTOJCA VIII**

#### **INFORMACIONET QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË NJOFTIMET PËR SHPALLJEN E FITUESIT TË KONTRATËS SË KONCESIONIT, NË LIDHJE ME KONCESIONET PËR SHËRBIME SOCIALE DHE SHËRBIME TË TJERA SPECIFIKE, TË PËRMENDURA NË NENIN 32**

1. Emri, numri i identifikimit (kur parashikohet nga legjislacioni i brendshëm), adresa, duke përfshirë kodin NUTS, dhe, kur është e përshtatshme, numri i telefonit, numri i faksit, adresa e postës elektronike dhe faqja e internetit të autoritetit ose subjektit kontraktor, si dhe e shërbimit nga ku mund të merren informacione shtesë.
2. Lloji i autoritetit ose subjektit kontraktor dhe veprimtaria kryesore që ushtron.
3. Kodet e FPP-së; kur kontrata ndahet në lote, ky informacion jepet për secilin lot.
4. Tregues përmbledhës për objektin e koncesionit.
5. Numri i ofertave të dorëzuara.
6. Vlera e ofertës së suksesshme, duke përfshirë tarifatat dhe çmimet.
7. Emri dhe adresa, duke përfshirë kodin NUTS, numri i telefonit, adresa e postës elektronike dhe faqja e internetit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm.
8. Çdo informacion tjetër përkatës.

---

### **SHTOJCA IX**

#### **HOLLËSITË PËR SHPALLJEN**

##### **1. Shpallja e njoftimeve**

Njoftimet e përmendura në nenet 31 dhe 32 dërgohen nga autoritetet kontraktore ose subjektet kontraktore në Zyren e Publikimeve të Bashkimit Evropian dhe shpallen në përputhje me rregullat e mëposhtme:

Njoftimet e përmendura në nenet 31 dhe 32 shpallen nga Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian i jep autoritetit kontraktor ose subjektit kontraktor konfirmimin e përmendur në nenin 33, paragrafi 2.

## **2. Formati dhe procedurat për dërgimin e njoftimeve në formë elektronike**

Formati dhe procedura për dërgimin e njoftimeve në formë elektronike, siç përcaktohen nga Komisioni, mund të gjenden në adresën e internetit "<http://simap.europa.eu>".

---

### **SHTOJCA X**

#### **LISTA E KONVENTAVE NDËRKOMBËTARE SOCIALE DHE MJEDISORE, TË PËRMENDURA NË NENIN 30, PARAGRAFI 3**

Konventa e ILO-s, numër 87 "Për lirinë e organizimit dhe mbrojtjen e së drejtës për t'u organizuar";

Konventa e ILO-s, numër 98 "Për të drejtën për t'u organizuar dhe negociatat kolektive";

Konventa e ILO-s, numër 29 "Për punën e detyruar";

Konventa e ILO-s, numër 105 "Për ndalimin e punës së detyruar";

Konventa e ILO-s, numër 138 "Për moshën minimale";

Konventa e ILO-s, numër 111 Për diskriminimin (punësimi dhe profesioni);

Konventa e ILO-s, numër 100 "Për shpërblimin e barabartë";

Konventa e ILO-s, numër 182 "Për format më të këqija të punës së fëmijëve";

Konventa e Vienës për mbrojtjen e shtresës së ozonit dhe Protokollin e Montrealit për substancat që hollojnë shtresën e ozonit;

Konventa e Bazelit për Kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre (Konventa e Bazelit);

Konventa e Stokholmit për Ndotësit organikë të qëndrueshëm (Konventa e Stokholmit për NOQ-të).

Konventa për Procedurën e njoftimit të pëlqimit paraprak për disa kimikate dhe produkte të rrezikshme për mbrojtjen e bimëve në tregtinë ndërkombëtare (UNEP/FAO) (Konventa PIC) dhe 3 protokollet e saj rajonale.

---

## SHTOJCA XI

### **INFORMACIONI QË DUHET TË PËRFSHIHET NË NJOFTIMET E MODIFIKIMEVE TË KONTRATËS SË KONCESIONIT GJATË AFATIT TË SAJ, SIPAS NENIT 43**

1. Emri, numri i identifikimit (kur parashikohet nga legjislacioni i brendshëm), adresa, duke përfshirë kodin NUTS, numri i telefonit, numri i faksit, adresa e postës elektronike dhe faqja e internetit të autoritetit ose subjektit kontraktor, si dhe e shërbimit nga ku mund të merren informacione shtesë.
2. Kodet e FPP-së.
3. Kodi NUTS për vendndodhjen kryesore të punëve, në rastin e koncesioneve të punëve ose kodi NUTS për vendin kryesor të zbatimit, në rastin e koncesioneve të shërbimit;
4. Përshkrimi i koncesionit përpara dhe pas modifikimit: natyra dhe sasia e punëve, natyra dhe sasia e shërbimeve.
5. Kur është e zbatueshme, modifikimi i vlerës së koncesionit, duke përfshirë rritjen e çmimeve ose tarifave, që shkaktohet nga modifikimi.
6. Përshkrimi i rrethanave që kanë çuar në nevojën për modifikim.
7. Data e vendimit për dhënien e koncesionit.
8. Kur është e zbatueshme, emri dhe adresa, duke përfshirë kodin NUTS, numri i telefonit, adresa e postës elektronike dhe faqja e internetit e operatorit ose operatorëve të rinj ekonomikë.
9. Informacion nëse koncesioni ka lidhje ose jo me një projekt dhe/ose program të financuar nga fondet e Bashkimit Evropian.
10. Emri dhe adresa e organit përgjegjës për shqyrtimin dhe, kur është e përshtatshme, për procedurat e ndërmjetësimit. Informacion i saktë në lidhje me afatin për procedurat e shqyrtimit ose, nëse është e nevojshme, emri, adresa, numri i telefonit, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike të shërbimit nga ku mund të merret ky informacion.
11. Datat dhe referencat e botimeve të mëparshme në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian*, që lidhen me kontratat për të cilat bëhet ky njoftim.
12. Data e dërgimit të njoftimit.

13. Çdo informacion tjetër përkatës.